

B5H-32

R2. 96

Rrugë  
dhe dritë në malësi

891.983-32

S

R2. 96 BIBLIOTEKA E RINISË

# RRUGË DHE DRITË NË MALESI

(Përbledhje reportazhesh, artikujsh dhe tregimesh mbi ndërtimin e rrugës së Malësisë së Madhe)

2203 5-6+2  
BIBLIOTEKA E SHTETIT  
BULGARI

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## NJË SIHARIQ I RI!

Një sihariq i ri! Partia i besoi rinisë një ak-sion tjetër të madh — ndërtimin e rrugës automobilistike të Malësisë së Madhe. Ky është një lajm gazmor për gjithë rininë tonë punëtore, fshatare, shkollore; për rininë e ushtrisë dhe për malësorët trima të krahinave të Veriut. Kjo është një shprehje tjetër e besimit të madh që ka partia ndaj brezit të ri, trashëgimtar i denjë i traditave të shkëlqyera të popullit dhe të rinisë sonë, në luftë e përpjekje për ndërtimin e lulëzimin e Shqipërisë së re. Ky lajm mbush me krenari e gëzim mbarë rininë për besimin e madh që tregon partia në forcën dhe gatishmërinë e brezit të ri. Brezi i ri falënderon thellësisht partinë për këtë besim, dhe e siguron se fjala e saj është trumpetë sulmi.

Kongresi V historik i Partisë na hapi horizonte të reja, na frymëzoi dhe, nën thirrjen e partisë, rinia u ngrit në këmbë. Mijëra vullnetarë u ngjitën e do t'u ngjiten kodrave e maleve për t'ë hapur taraca e për t'i bërë të begatshme. Qindra të rinj e të reja nga Shkodra, Elbasani, Vlorë e Tirana, pararoja e lavdishme e një ndër-

marrjeje të madhe, ju drejtuan kooperativave të reja malore për të punuar e jetuar një deri tri vjet së bashku me malësorët, për lulëzimin e krahinave të thella. Turni i parë i brigadave vullnetare ka 7 javë që nisi punën e po punon me vetëmohim për ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier. Pa mbaruar akoma turni i parë në aksionin e madh të hekurudhës, partia shpall aksionin e dytë të madh.

Me 1 prill në drejtim të Fushës së Myzeqesë, për më hekurudhën Rrogozhinë-Fier, niset turni i dytë me 5000 të rinj e të reja. Po me 1 prill, në drejtim të maleve të Veriut, për ndërtimin e rrugës automobilistike të Malësisë së Madhe, niset turni i parë me 1100 vullnetarë, e pas tij do të niset vargu i brigadave të tjera me 5200 vullnetarë e vullnetare.

Nderi për të hedhur kazmat e para në këtë aksion të madh u takon brigadave vullnetare nga Shkodra, Tropoja, Kukësi, Puka, Rrësheni, Burreli, Dibra, Lezha, Kruja dhe Durrësi, ku shumica e vullnetarëve do të jenë të reja.

Ndërtimi i kësaj vepre të re, ku do të derdhin djersën mijëra të rinj e të reja të terrenit dhe të ushtrisë, do të jetë një monument tjetër i heroizmit dhe i vetëmohimit të brezit të ri. Ndërtimi i rrugës automobilistike të Malësisë së Madhe, ashtu si rruga Kukës-Peshkopi, Rruga e Driftës, ndërtimi i hidrocentraleve dhe hekurudhavë, është një aksion me rëndësi të gjithanëshme. Ajo jo vetëm që do të shpjerë në këto zona të thella malore të vendit përparimin e atdheut tonë socialist, por do të ngrejë në një shkallë akoma

më të lartë traditat e shkëlqyera të punës e të heroizmit të brezit të ri, që nën udhëheqjen e partisë, marshon përpara në rrugën e fitoreve e sukseseve të pandalshme. Akteve të pavdekshme të guximit, trimërisë dhe heroizmit të vinteve të Luftës nacionalçirimtare, të viteve të rindërtimit dhe të ndërtimit të jetës së re, gatishmërisë dhe vrullit revolucionar që ka shpërthyer në mbarë rininë e vendit tonë, do t'i shtohen dhe akte të tjera të lavdishme për të vënë në jetë programin madhështor që aprovoi Kongresi V i Partisë. Atje, në bjeshkët e larta, do të kaliten e farkëtohen me frymën e lartë revolucionare mijëra e mijëra të rinj e të reja.

Aksioni i ndërtimit të rrugës automobilistike të Malësisë së Madhe do të bëhet, ashtu si dhe aksionet e tjera, një shkollë e madhe e jetës. Në punë e sipër, në luftë me vështirësitë e pengesat, vullnetarët e vullnetaret e aksionit të ri do të shtojnë edhe më tepër dashurinë për punën, për njerëzit e punës, do të forcojnë gjithnjë e më tepër ndjenjën e kolektivitetit dhe përpjekjet për të vënë mbi të gjitha interesat e atdheut e të popullit. Atje, në aksion, në praktikën revolucionare për ndërtimin e Shqipërisë së re, rinia do të skalisë e do të zhvillojë më tej tiparet e njeriut i vërtetë.

Së shpejti flamujt e brigadave vullnetare do të valëviten dhe në bjeshkët e shpatet e larta të Malësisë së Madhe, për të realizuar kështu një ëndërr shekullore të të gjitha fshatrave të kësaj zone të largët. Në Malësinë e Madhe, në këto ma-


le e shkrepa, ku bajraktarët e kanunit nuk sill-nin tjetër gjë përveç vuajtjeve e mjerimeve të padëgjuara, vullnetarët e rinisë, me porosinë e partisë, do të ndërtojnë rrugën e re, e cila do të çojë atje përparim e kulturë. Rruga e re automobilistike, së bashku me ndihmat e tjera të gjith-anshme që partia u jep krahinave malore, është një dhuratë e re e kujdesit të partisë e të qeverisë për zhvillimin e përparimin e shpejtë të fshatrave të malësisë.

Vendet nga do të kalojë kjo rrugë e gjatë në për malësi, janë dëshmitare të sa e sa ngjarjeve, përpjekjeve dhe luftës heroike të malësorëve përliri e drejtësi.

E pushtuar nga fryma revolucionare e vendimeve të Kongresit V të Partisë, rinia do ta kryejë me nder edhe këtë aksion të madh.

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

*22 mars 1967*



Shoku Kadri Azbiu duke prerë shirtilin e inaugurimit të rrugës së Malësisë së Madhe.

## **BJESHKEVE KU DO TE KALOJE RRUGA**

Ne udhëtojmë nëpër bjeshkët e Malësisë së Madhe. Rruga jonë ngjitet nëpër shkrepë e zbutur në lugina, herë buzë ujërave të kulluara, herë pranë majave të mbuluara me dëborë. Këto bje-shkë veriore i ka zgjuar këto ditë një gjësim i ri. Së bashku me erërat e pranverës, së bashku me lulet e para të pemëve që lulëzojnë buzë përrënje, këndeja ka ardhur dhe një sihariq i hareshëm: në Malësinë e Madhe do të çelet rruga e maqinës. Këtë vepër të madhe partia ja beson rinisë.

Duhet të futesh thellë në zemrën e malësorit të këtyre anëve që ta përshkruash këtë gjësim. Pranë shtëpisë së tij, pranë fshatit të tij, futur tutje gërxheve e pyjeve, do të shkojë maqina! Nëpër monopatet e thepisura nuk do të shihen më fshatarë që të zbresin në qytet duke udhëtuar ditë të tëra pas mushkës së tyre. Uturima e maqinës do të përzjehet me oshëtimën e lashtë të pyjeve, do të futet në jetën e fshatarëve për ta bërë atë nië të gjuar, më të lumtur. Gazeta do të vijë më shpejt, traktori do të futet thellë e më thellë maleve, do të

priten e do të përcillen më shumë miq. Kjo uturimë maqine do ta çojë me vrull të dhjetëfishuar drithën dhe begatinë në male. Kjo rrugë e re e malësisë do të jetë si një arter i fuqishëm, ku do të lëvrijë më me gjallëri gjaku i jetës sonë.

Ne ecim nëpër bjeshtët dhe kudo shohim njërez. Shtëpitë e fshatarëve janë të shpërndara, larg njëra-tjetrës, kurse njerëzit janë tok. Këto shtëpi të shpërndara kanë mbetur si një simbol i vjetër i ndarjes, i vëtmisë. Kleri dhe regjimet antipopulllore, për ta bërë të parrezikshme përveten e tyre pushkën e malësorit, e kthyen atë në pushkë gjakmarrësi, në pushkë armiqësie vëlla me vëlla. Dhe malësori ynë u nda me vëllanë e tij, e ngriti shtëpinë larg vëllait të tij. Prandaj dhe këto shtëpi janë larg njëra-tjetrës, të vetmuara e pranë gërxheve të thepisura. Por dritha e partisë i bashkoi njerëzit. Fshatarët që takoj rrugës më tregojnë se kanë hyrë në kooperativa bujqësore, se kanë nisur një jetë të re, që kurrë s'e ka parë malësia: jetën e përbashkët, jetën vëllazërore.

Shoh grupe njerëzish që punojnë, herë këtu e herë atje, për të ngritur sektorët e rrugës. Më 1 prill këndej do të vijnë të rintjtë dhe të rejat vullnetare. Ata duhet t'i gjejnë gati tendat, mençat, fjetoret dhe gjithshka duhet për ndërtimin e rrugës. Arrijmë në një sektor, buzë një përroi malor. Këtu punojnë kooperativistët e të rintjtë e ushtrisë. Ata ngrejnë kantierin. Fryn një erë e fortë dhe e ftohtë. Më bën përshtypje një malësore që punon shpejt e pa pushim. Gërmont me bel, hedh dheun tutje, gërmont përsëri...

- Si tē quajnë? — e pyes.
- Diella — më përgjigjet.
- Diella mezi pret t'i vijnë shoqet vullnetare ndërbyn në bisedë Dylberi.
- Po ti, do tē punosh këtu?  
Ajo qesh.
- Si jo — thotë. — E kena dhanë fjalën për aksion tash tre muej ma parë.
- Po shoqe tē tjera nga fshati a do tē vijnë?
- Nja pesëmbëdhetë. Tana vullnetare kena dalë. Jena anëtare rinie.
- Më 1 prill fillon puna — i them. — Këtu do tē vijnë nja shtatëqind tē reja.  
Diella buzëqesh.
- Dhe dhetë ditë, a?

Gëzimi me tē cilin i pret kjo vajzë shoqet vullnetare tē bën përshtypje. Me to do tē lidhet në miqësi, do tē mësojë kaq e kaq gjëra. Kurre s'ka parë Diella kaq shumë shoqe grumbull, shoqe tē ardhura nga vende tē ndryshme tē atdheut tonë.


Dhe si Diella gëzohen qindra e qindra vajza malësore. Kjo rrugë e re që do tē kalojë do tē sjellë tek ato miqësi tē reja, njerëz tē rinj. Pranë vullnetarëve këto vajza do tē mësojnë më shumë, do tē hedhin tutje zakonet prapanike, do tē bëhen më tē zonja pér punën dhe pér jetën. Mbrëmjeve, mbas pune, ato do tē mblichen në baraka dhe do tē dëgjojnë pér jetën e shoqeve tē tyre tē ardhura nga larg, gjithash tu do tē tregojnë dhe pér jetën e tyre këndejej në bjeshkë. Kështu do tē bëjnë si tē rintjtë si tē rriturit. Është një shkollë e madhe kjo rruga që

do të hyjë bjeshkëve të Veriut, është rrugë drite  
dhe begatje.

Ecim nëpër bjeshkët e Malësisë së Madhe  
dhe kudo shohim gëzim e gjallëri gjatë piketave,  
ku do të kalojë rruga. Malësorët dhe të rinjtë  
ushtarë pregatisin me nxitim kantieret e vull-  
netarëve. Kjo pranverë nis me ngjarjen e madhe,  
me ndërtimin e rrugës nga rinia.

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

*22 mars 1968*



Brugë e rini së gjarpëron nëpër faqet e maleve kreshnike.

## MBI KRESHTA MALESH NJË KËNGË, NJË KRISME, NJË RRUGË

Le të bjerë shi, maqinat çajnë drejt Malësi-së së Madhe. Ato mbartinë ndrrat e 1100 vullnetarëve, të ardhur nga rrethe të ndryshme. Nga Dibra janë për në rrugë të re 100 vajza. Dhe andej male ka. Dhe ato drejt malesh shkojnë. Duken më të ndrojtura, më të heshtura. Në qafë kanë lidhur shallet e vullnetarit.

Ato u nisën që andej në rrugë të re. Çudi, këto nuk këndojojnë gjatë rrugës. Unë i shoh të heshtura, duke kundruar viset që përshkojnë. Unë e di, ato kur të kthehen, mbas dy muajsh, do të kenë mësuar këngën e re, të lindur kësaj ane. Atë këngë e thuri një rapsod, emri i të cilit nuk dihet. Është një këngë e fuqishme, e bukur:

*«Shndriti dielli në Malësi  
Lum e lum për këtë parti....»*

Nga Kruja kanë ardhur 50 vajza dhe djem. Maqina e tyre është e vetmja që mban targën e rrethit, se të tjerat janë të Shkodrës. Shoferi i shi t'i çojë vullnetarët deri në vend. Dhe ai është i ri. Këtë maqinë e ka ngritur vetë,

se ajo prej kohësh ka qenë jashtë përdorimit. Tani ai çan me të, drejt rrugës së re. Ndër të tjerë aty lart është edhe Drita me të vëllanë, Shaqirin. Me t'u kthyer nga ky aksion ata do të shkojnë vullnetarë maleve: Shaqiri për dy vjet, e motra për një vit.

Vajzat e Tropojës i njoha një natë më parë, në mbrëmjen që u dha në shtëpinë e kulturës të qytetit të Shkodrës. Ato janë 40. Brigada e tyre mban emrin e dëshmorit Jaho Saliu. Dhe ai luftoi e ra maleve për rrugë të reja në jetë. Dhe këto vajza tani do të punojnë, për të hapur rrugë të reja Malësisë së Madhe. Luftë e punë kjojeta jonë...

Mbaroi një valle. Le të bisedojmë me SH.M. Dikur, në moshën 13-vjeçare ajo ishte vullnetare së bashku me 350 veta në hidrocentralin «Karl Marks».

- Vetëm 40 keni ardhur?
- 120 të tjerë, nxënës të gjimnazit dhe të rinjë fshatarë, u nisën për në hekurudhë.
- Ju keni zbritur nga bjeshkët?
- Jo, nga Bujani e Margegaj. Është menduar që në rrugën e re të punojmë së bashku me të rejat punëtore të NISH Cigares Shkodër. Që këtu u lidh kjo miqësi, që në mbrëmje. Atje, gjatë punës, ajo do të forcohet më tej e ndoshta dy shoqe vullnetare, të vendeve të ndryshme, të mjeshtërive të ndryshme, do të gdhendin në shkëmb emrat e veta.

Maqinat çajnë drejt Malësisë së Madhe. Uhë njihem me dy nga të 200 vullnetarët që u nisën nga rrethi i Shkodrës.

Tomi dhe Vitorja janë burrë e grua.

— Të dy maleve, në rrugë të re po shkojnë?

— Po, maleve, në rrugë të re, përsërit ai për ta forcuar mendimin tim. — Kemi zbritur nga Vuk-Palaj Kosturi.

Ata të dy ka një vit që krijuan familjen e re. Dhe ngjan sikur në këtë aksion do të farkëtohen koncepte të reja të kësaj jete. Zbriti nga malet një çift, për të marshuar në rrugë të re!

— Po ju të Burrelit nga vini?

— Nga Gjoni dhe Peshku i Martaneshit, nga Macukulli, Stojani, Gjocaj, etj. Nga 10 fshatra, gjithsej 50 vetë.

Pastaj bisedojmë me Xhelalin. Ai është i ri kooperativist. Edhe kooperativa e tij është e re. Ajo u ngrit me 23 nëntor të vitit 1966, ditën e 25-vjetorit të themelimit të Rinisë Komuniste, disa ditë mbas Kongresit V të Partisë. Dhe puna e këtij të riu filloj me hapjen e tokave të reja, andej zonës së Martaneshit.

— Gjithsejt hapëm 11 hektarë, 2 hektarë ishin pyll.

— Pati dëborë?

— Po. Ajo ishte një metër. E largonim, pastaj thyenim akullin e pastaj punonim.

— Të gjithë djem paski ardhur?

— Tetëdhjetë vajza i nisëm për në hekuru dhë...

Pranë nesh është Destani, më i riu i brigadës. Atë deshën ta kthenin nga Burreli, si më i vogli që ishte, por ai kundërshtoi. Ndoshta shokët nuk kishin besim, po ky Destan ishte që kishte hapur dita me ditë deri në  $50 \text{ m}^2$  tokë të re, atje, tri orë larg fshatit të vet.

Nga malet zbritën dhe kuksianët: janë nga Shtiqeni, Pobregu, Brati; ata vijnë nga minierat, uzinat, artizanati. Unë interesohem për koooperativistët.

— Fshatrat i merr Gjalica e Lumës — më shpjegojnë ata. — Ne, 37 vetë, u nisëm për në rrugën e re, të tjerët, gati të gjitha vajza, u nisën për në hekurudhë.

Kjo brigadë, që mban emrin e dëshmorit të punës Pjetër Llesh Doda, është brigada e parë që u nis nga Kukësi. Çudi! Edhe jeta e këtij dëshmori ngjan me jetën e këtyre të rinjve! Në janar të vitit 1967 punonjësi i PTT së Kukësit, Pjetër Llesh Doda, midis dimrit të egër, gjatë kohës që po bënte kontrollin e linjave telefonike, mbeti rrugës, në Fan. Mbas dy muajsh brigada e të rinjve të Kukësit u nis Malësisë së Madhe, për të shpënë më tej lavdinë e tij, për të hapur rrugë të reja shkëmbore. Në punën që do të bëhet për të luajtur nga vendi  $730.000 \text{ m}^3$  dhe e shkëmb, do të marrin pjesë edhe këta.

Kështu është kjo jeta jonë! Çdo ditë sjell diçka të rrethe, heroike. Të 450 nxënësit e shkollës «Naim Frashëri», të Durrësit, të shkollës «Dr. Medar Shtylla» të Kavajës dhe të shkollës «Qamil Gjuzi» të Rrogozhinës, unë i shoh tanë dhe i përfytyroj si atëhere kur u hodhën të parët në sulm për të shembur e djegur në flakë çdo zakon të vjetër e prapanik, që pengon të renë të çajë përpara.

Në pejsazhin e egër të maleve lindën këto dy qyteza të çadrave.

Të parët që punuan për ngritjen e tyre ka-

në qenë të rintjtë ushtarë e kooperativistë të atyre anëve si dhe vullnetarët që kanë shkuar për 1 deri në 3 vjet maleve. Puna e tyre që e vështirë. Po ata i përballuan vështirësitë e dimrit, duke transportuar çdo material në krahë. Gjatë punës një nënë kooperativiste tha:

— Kur të kërcasin minat këtej, or bir, atyre andej do t'u kërcasë koka.

E kishte fjalën për armiqtë e të gjithë ata që s'na duan të mirën.

Dhc krisma u dëgjua. Ditën e hënë një batare pushkësh lajmëroi inaugurimin e punimeve të rrugës së Malësisë së Madhe. Kështu e kanë malësorët, çdo fitore e pëershëndesin me pushkë.

*Marrë nga gazeta*

«Zeri i rinisë», 5 prill 1967

50672  
2203

**VALKA E SHKETË**  
**GRADASSET**

## DREJT BJESHKEVE TË MALESISE SË MADHE

Malësia e Madhe, krahina më veriore e atdheut, është në festë. Ato bjeshkë kreshnike ku lindën e luftuan trimat e trimëreshat si Ded Gjo' Luli, Nora dhe Tringa, të cilat u kallën tmerrin pushtuesve otomanë, ato male që u bënë strehë e mburojë për partizanët tanë trima, ato male ku sot kufitarët dhe i gjithë populli vigjilojnë me sy të patrembur për të mbrojtur kufitë tanë të shtrenjtë, ushtuan nga kënga e 1100 vullnetarëve të turnit të parë, të cilët erdhën për të filluar punimet për të hapur rrugën automobilistike, një aksion tjetër ky i rinisë sonë heroïke. Ndërtimi i rrugës automobilistike të Malësisë së Madhe, ashtu si hekurudha Rrogosjinë-Fier, do të jetë një shkollë tjetër e madhe për kalitjen dhe edukimin revolucionar të rinisë. Kjo rrugë i ngjan shumë rrugës Kukës-Peshkopi, të cilën e çelën krahet e fuqishme të rinisë sonë. Në aksionin e ri të rinisë erdhën të derdhin djersë dy muaj rrjesht të rintjtë dhe të rejat nga rrethet e Tropojës, Durrësit, Dibrës, Mirditës, Krujës, Kukësit, Lezhës e Shkodrës. Këtë vepër të tyre do ta pasojnë mijëra të rinj të tjerë në muajt e ardhshëm. Para

se t'i qepeshin Malësisë së Madhe vullnetarët kalluan një natë të bukur në Shkodër, midis kolektivave të fabrikave e institucioneve të ndryshme si edhe familjeve shkodrane.

... Autokolona që transporton vullnetarët gjarpëron nëpër bjeshkët kreshnike të Malësisë së Madhe. Vullnetarët këndojnë këngë revolucionare, dhe malësorët kooperativistë, që u janë qepur maleve për t'i kthyer në taraca, i përshëndesin me dorë duke u uruar mirëseardhjen.

S'ka shumë kohë që edhe në këto bjeshkë njerëzit, të udhëhequr nga mësimet e Kongresit V të partisë dhe të shokut Enver Hoxha, bashkuan tokën, bagëtitë e mjetet e punës dhe krijuan kooperativat bujqësore. Vullnetarët, shumë prej të cilëve vijnë nga zonat fushore, shohin me sytë e vet se si këto vende të ashpra po ndryshojnë pamjen, po bëhen të bukura e pjellore si fushat, në saje të forcës së bashkuar të njerëzve që i kanë vënë vetes qëllim të forcojnë ekonominë dhe të përmirësojnë jetën e tyre. Ja, këto male, ku 250 komunistë dhe të rinj shkodranë kanë shkuar prej ditësh vullnetarë për të punuar nga dy vjet, presin tanë revolucionarë të tjerë të rinj e të reja, që me forcat e krahëve të tyre do të hapin një rrugë të re, e cila do ta përshkojë Malësinë e Madhe tejembanë. Ajo do të sjellë këtej një rreze të fuqishme drite, përparimi e zhvillimi të mëtejshëm. Rruga do të shërbejë gjithash stu për shfrytëzimin më të mirë të pasurisë së madhe pyjore që ka kjo zonë.

Ja, punëtoret e dalluara të fabrikës së ci-

gareve të Shkodrës. Ato po udhëtojnë thellë e më thellë drejt Malësisë së Madhe. Në sytë e tyre, që shkëlqejnë nga gëzimi, shihet vendosmëri dhe optimizëm. Pak ditë më parë disa prej tyre bashkë me shumë të rinj e të reja të vendit tonë, kryen me nder marshimin e madh në rrugën e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë. Nacionalçirimitare, dhe ja tani ato dolën përsëri vullnetarë për të punuar në hapjen e rrugës së Malësisë së Madhe. «Aksioni të kalit, të mëson, të edukon — thotë njëra. — Kur mund të kontribuojmë ne, për atdheun dhe popullin më mirë se tani? Ne kemi energji dhe forca, të cilat na i shton përditë partia. Jam e bindur dhe do të punoj me të gjitha forcat që edhe këtë aksion ta kryejmë me nder».

Midis 52 vajzave të rrethit të Tropojës, që siç na thanë vinin nga dy kooperativa bujqësore, nga Bujani e Markgegaj, ishte edhe Drita Hasa, një brigadiere e dalluar. Ajo ishte shumë e gjuar që ju dha rasti të punojë në këto male, që aq shumë ngjasojnë me ato të rrethit të Tropojës, të ashpra por të bukura. Pranë vajzave tropojase, që marrin pjesë për herë të parë në aksion, ka edhe nga ato që kanë kontribuar në ndërtimin e hidrocentralit «Karl Marks». Ato kanë eksperiençë në aksionet e rinisë, ndaj edhe tashti janë zotuar që edhe këtu të ndihmojnë shoqet që vijnë për herë të parë.

Në vullnetaret e rrethit të Dibrës ka diçka karakteristike, të gjitha janë femra, janë 100 vajza, që kanë ardhur të kaliten në aksion.

«Jemi zotuar — thotë Zyria — që të punojmë

sa më mirë dhe të luftojmë për të merituar flamin e aksionit».

Autokolona ecën gjithnjë përpara, drejt bjeshtëve, dhe kënga ushton mal më mal, gjersa vullnetarët arrijnë në një pllajë ku është ndalesa e fundit. Ata priten aty nga malësorë e malësore dhe nga shumë punonjës, që kanë ardhur përtë bërë preqatitjet për ta.

«Kemi marrë të gjitha masat që vullnetarët të punojnë, të çlodhen dhe të dëfrejnë, na shpjegon komandanti i aksionit. Për vullnetarët janë ngriitur me kohë çadrat, është organizuar shërbimi mjekësor dhe të gjitha shërbimet e tjera. Kemi siguruar gjithash tu frontet e punës. Vullnetarët do t'i përqëndrojnë në dy sektorë dhe pikërisht ja, atje, ku do të hidhet edhe kazma e parë.

*Marrë nga «Bashkimi»  
2 prill 1967*

## **GJITHMONE KËSHTU NA ARDHTË PRANVERA!**

Pranverë më të bukur nuk ka parë malësia. Dëbora po shkrin. Së bashku me rrjedhjen e ujit, që zbret nga mal, erdhët edhe ju, vullnetarë e vullnetare. Melodia e këngës suaj erdh e u tra-zua me cicërimën e zogjve të pyllit. Ngjyra të reja sollët ju ndër këto anë. Njerëz të rinj sollët ju për të ndërtuar veprën e re. Ju erdhët të mundeni me shkëmbin, dhe po e mundni. Ju po fitoni mbi të. Para syve të mi, ju jeni më të mëdhenj, jeni fitimtarët e betejave, ndaj ju nderoj më shumë, ju dua më shumë.

\* \* \*

Jeta e aksionit është e gjallë, e larmishme, e rrëmbyeshme, si vetë rinia. Kanë ardhur vullnetarë nga anë të ndryshme të vendit po ata janë aq të afërt, aq të miqësuar me njëri-tjetrin sa të lënë përshtypjen sikur njihen prej kohësh. Ata i lidh e i bashkon qëllimi dhe ideja e përbashkët.

Ja, po bie çiftelia. Hiqet valle me gaz. Fyturat e vullnetarëve janë të qeshura. Vullnetarët spektatorë shkëputen një nga një. Hyjnë

në valle. Edhe një vajzë matet të hyjë, por prapë nguron. I vjen turp, por zemra ja do të kërcejë edhe atë valle, që di ta hedhë aq mirë. Ja lexoj në sy dëshirën. E shoh që bën një hap përpara, e unë them me mendje: «hyrë», por ajo prapë tërhiqet. Në fshat ndofta nuk ka kërcyer kurrë ndonjëherë valle me djemtë.

Dikush e shtyn nga mbrapa, e ajo gjendet në trethin e valles. Vullnetari i fundit e kap për do-re, e hapat e saj fillojnë të hidhen me ritmin e të tjerëve. Skuqet në fytyrë. Përfytyron fshatin. Ç'do të thoshin atje po ta shihnin?

Bjeri çiftelisë, o djalë! Më shpejt, më shpejt hiqe vallen ti, cuca e turpshme e malësisë. Ju erdhët të shihni si lindijeta e re nëpërmjet punës, e rrezet e saj t'i çoni në vendlindjen tuaj. Ju do të jeni mësues të shoqeve në fshatin e largët malor.

\* \* \*

Diçka më shtyn të shkruaj për çiftin e ri. E kam jetuar fshatin, i njoh së afërmi zakonet e tij, që ja la trashëgim bota e parënduar, ndaj nuk mund të rri pa i sjellë ndër mend ato skena dramatike, që më kanë mbetur në kujtesë si gjurmë të një rruge të errët, nëpër të cilën kaloj vajza apo nusja e djeshme, që nuk zinte asnje vend në shoqëri.

Sa gëzohem sonte, që në rrugën e dy të rinjve ndriçon një dritë e madhe, e fortë. Është drita që solli partia. Nuk ka qetësi në kampin e vullnetarëve. Radio kudo. Mbi një shkëmb, në breg

të lumi, janë ulur disa vullnetarë e po i bien fyellit. Të tjerët vallëzojnë në sheshin e vogël. Në oborrin e ngushtë dhe të gjatë para çadrave dalloj dy vullnetarë. Ai i ka futur krahun (!). Ajo qesh. Ecin ngadalë e fjalosen. Zefi është nga fshatrat e Shkodrës. Nuk ka shumë që është martuar me Luçijen. Në fshat bashkëshortët nuk i thërresin me emër njëri-tjetrin, por këta vendosën ta thyejnë atë zakon. U regjistruan vullnetarë dhe erdhën. E prishi aksioni zakonin. Nuk ka më pér çiftin e ri ecje pér një me disa metra largësi (kuptohet, burri pérpara, bile me kryet lart, e grueja mbrapa, e krrusur nga pesha e barrës mbi shpinë).

\* \* \*

Ajo copë e rëndë hekuri përplaset me forcë mbi barominën, të cilën e mbajnë dy duar të forta. Shikoj me dashuri dhe frikë vajzën që herë mba here godet me tërë forcën. Një lëvizje gabim dhe duart e shoqes...

Më bëjnë përshtypje tiparet e gjalla të kësaj vajze malësore.

Prej nga je moj vajzë?

— Jam prej Dušagjini, — tha ajo, dhe vazhdoi punën me ritmin e parë.

Në përgjigjen e saj dallova krenarinë. Nuk njeh ajo më kanunin e Lekës. Njeh fjalën e Partisë, shtigjet e reja, pér vajzën e re, dhe ka guxim të kalojë nëpër ato shtigje.

— Katrina punon shumë — thatë Xhyherja, vullnetarja që shkoi të punojë e të jetojë dy vjet

në Dukagjin. — Ditën e parë ndoqi me kujdes vendosjen dhe ndezjen e minave. «Dua të bëhem minatore» tha ajo papritmas, por e vendosur. Një herë e shikuam me dyshim, por një ditë ajo hodhi shkëmbin në erë. Kjo ishte prova për minatoren e re. Dhe ne i besuam asaj.

— Po ajo vajza që po sheshon dheun kush është?

— Është nga fshati Lotej i Dukagjininit. E quajnë File. Ajo u regjistrua e para dhe me gjiquajnë — vazhdon Xhyherja — punon këtu me gjithë të kunatin, Nike. Atje e kanë për turp t'i shohin njerëzit e të fejuarit, kurse këtu, ja, punojnë për krah njéri-tjetrit.

Filja dhe Mrija. Dy vajza të fejuara. A nuk janë edhe këto minatore? A nuk e hodhën edhe këto në erë zakonin — shkëmb?

Eci, po ende më duket sikur më tingëllon në veshë ajo përgjigja krenare «jam prej Dukagjini».

\* \* \*

Nuk të njoha më parë, Ida. Veç shokët e tu më thanë që je rritur me përkëdhelje. Të vinte rëndë të ndihmoje edhe nënën në shtëpi. Çdo gjë e deshe gati. Edhe bukën, edhe gotën e ujit, edhe këpucët... Të ndihmuani sa herë shokët, por nuk u korrigjove. Ti erdhe në aksion. Askush nuk besoi që do të punoje. Po ti shokëve u preqatite një të papritur të bukur. Duart e tua të vogla shtrënguan kazmën. Sa e rëndë t'u duk ditën e parë! T'u formuan fluskat e para, por kazmën nga dora

nuk e lëshove. Ti deshe ta mbash lart nderin e kompanisë. Dhe po e mban. Brigada e shkollës flet me dashuri pér ty. Je një nga vullnetaret më të dalluarë në punë. Shoh si lind shkëndija nga pérplasja e kazmës tënde mbi shkëmb. Balli të është mbuluar me djersë. Dhe unë të dua shumë Ida, të dua pér punën tënde.

— Ida!

Ti kthen kryet. Pér një çast ndërpret punën.

— Shkëmbi është i fortë...

— Por ne jemi më të fortë se ai...

— Çka do t'i thuash nënës kur të shkosh në Durrës?

U skuqe në ftyrë. Duket e kuptove që unë dija diçka pér ty, por menjherë e more veten dhe u përgjigje:

— Do t'i them që në aksion u mësova me punë dhe s'ke pse shikon më në shkollë të kërkosh ndihmën e mësuesve e të shokëve të mi.

Po, Ida ashtu thuaji, të vërtetën.

\* \* \*

Hyj në çadrën «spital». Pesë vajza janë të shtruara. Biseda kishte filluar me kohë, por Aishja ngul këmbë në të sajën. Sytë i janë mbushur me lot:

— A e dëgjoni këngën e shokëve që punojnë?

— Ti nuk mund të punosh, Aishe. Mjekja nuk të lejon. Ajo përgjigjet pér shendetin tënd. Biseda vazhdon. Aishja detyrohet të pranojë. Por nuk është e qetë, ajo ka mendjen dhe zemrën te vullnetarët, te rruga e maleve. Atë e mundon edhe diçka tjetër. Nuk po arrin të bashkë-

punojë me vullnetarët fshatarë që kanë ardhur në një turn me të. Por edhe këtu shoqet e ndihmojnë.

— Shiko, shoqe e dashur, programin që kemi hartuar do ta çojmë deri në fund! Ti veç shërohu.

\* \* \*

Një erë e lehtë përkund degët e pemëve. Jephona e këngës ushton në luginë, e shoqëruar me krismën e kazmave mbi shkëmb. Një bajonetë shkëlqen nga rezet e diellit. Dy duar vajze shtrëngojnë pushkën. Vajza qendron mbi shkëmb, shikimin e ka hedhur larg. Ai shkëmb i duket piramidë. Kujton ushtarin. Edhe ai kështu bën viroje. Puna dhe kënga nuk ndërpriten. Liza vi-gjelon. Sa hije i ka pushka! A thua se ka lindur me të në krah!

\* \* \*

Një flamur shpaloset mbi shkëmb. E mban brigada «Manush Alimani» e Shkodrës. Anëtarët e brigadës punojnë me ritëm të shpejtë. Gurët rrokullisen poshtë me zhurmë. Midis të tjerëve njoha Prendushën. Ajo punon me tërë forcat, nuk pyet për djersën, as kallot ndër duar. Nuk lodhet prendusha, e njoh unë atë! Është nga Mjeda dhe ka ardhur në aksion me gjashtë shoqet e reja të estradës së fshatit. Kalon sa në një skuadër në tjetrën, punon, jep udhëzime, kontrollon punën, por në fund nuk harron t'i porosisë shokët për aktivitetin kultural të mbasditës.

Kanë vendosur të marrin flamurin, megjithëqë konkurentët i kanë shumë të fortë.

— Si thoni ju, shokë, a do ta mbajmë ne flamurin e sektorit?

— Nuk e dorëzojmë, shoqja komandante! I pregetitëm dhe skeçet e i mësuam rolet.

Edhe rapsodi e bëri punën e tij. Zojën më gifteli e kanë gati. E çka u mungon? Veç të jepim shfaqjen.

Kjo do të jetë e pesta shfaqje që jep rinia fshatare e brigadës së Shkodrës, me kamandante brigade Prendushën.

\* \* \*

Përfytyroj Dritën të veshur me bluzë të bardhë, duke ndjekur reaksiōsin që lind në epruvetë. Gishtat e saj delikate kapin lapsin e diçka shënojnë mbi letër. Vëmendjen e ka përqendruar brenda xhamave të laboratorit.

Shoh Dritën sot. Drejtobhet për tek fronti i punës. Bluzën e bardhë e ka zëvendësuar me pantallonat dhe shallin e aksionit, lapsin me kazmën, laboratorin me ashpërsinë e maleve, epruvetën me shkëmbin, lëndën reaktive me dinamitin, reaksionin me hedhjen e një shkëmbi në erë, kalkulimet përfundimtare të provës me hapjen e rrugës. Në bluzë mbante atëhere iniciatlet D.H. Sot mban në gjoks katrorin e kuq «S».

O miqtë e mi! Ju erdhët nga anë të ndryshme. U pret malësia me bujarinë e saj shqiptare. Ju sollët freskinë rinore, këngën e jetës së

re. Ju jeni vullnetarë që vini nga shkolla dhe fshati.

Ushtojnë malet nga shpérthimi i minave dhe kjo është kënga më e fuqishme juaja, që dëgjohet deri larg. Ja, një plakë malësore është ndalur karshi jush. Harroi që mushka e ngarkuar i kaloi larg. Mundohej të dallonte vajzën e vet midi vullnetarësh. Por ju i dukeni të gjithë njësoj.

— Si të duket kjo punë, o gjyshe? — i thashë kur po i jepja dorën.

Ajo pa me vërejtje këpucët dhe pantallonat e mia, pastaj më tha:

— Më vjen keq, moj bijë, që u plaka, veç mos deksha pa hypë nji herë në maqinë!

Fjalën e ndërpreu. Hodhi sytë tek vullnetarët, e kuptoj që ajo në çast ndjen shumë gjëra. U mallëngjye, më vuri dorën në shpatulla e më tha:

— Erdh partia, erdh behari, bijë!

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

*26 prill 1967*

## ARTER DRITEDHËNES NË ALPET TONA

Në gji të Alpeve tona, atje ku aksioni përmban në vetëvete dobinë ekonomike dhe vlerën edukative, lodhjen në punë dhe kalitjen e vullnit të qindra të rinxhjeve dhe të reja ve të krahinave të ndryshme të vendit tonë, të cilët mund të shkëmbinjtë për të shtrirë një arter të ri drite në ato anë, ka një njeri, i cili mund të trajtojë në çdo kohë të ditës se në ç'sektorë putton kjo ose ajo brigadë vullnetarësh, ku valëvitet flamuri i kuq tranzitor i shtabit të aksionit, ku gjëmojnë minat dhe shembet mali, sa metra trase është hapur një ditë më parë... Ai nuk është asinxhinjer ose teknik, as anëtar shtabi a vullnetar, po një kalimtar i përditshëm, lindur e rritur në ato anë, një malësor, që s'di ç'është lodhja. Përshkon në këmbë çdo ditë Mallësinë e Madhe, nga Tamara në Rapsh, kalon male e lugina brigjeve të Cemit, duke mbajtur me krahë një çantë plot me gazeta, revista, letra dhe telegrame. Ka dymbëdhjetë vjet që postëshpërindarësi i Kelmendit, fillikat, ditën ose natën, përshkon grykën e Grabonit, luginën e bukur të Brojës, dhe, si hedh urën e Tamarës, ndalet në qe-

ndër të lokalitetit, ku shpérndan shtypin dhe pos-tën. E njeh gjithë Malësia e Madhe këtë Nikollën e papërtuar, por tani e njohin dhe e presin me padurim edhe vullnetarët që kanë ardhur në këto anë. Ai u çon atyre shtypin, fjalën e partisë, dorëzon letra e telegrame nga familjet e dashamirët dhe, në të njejtën kohë, merr prej tyre përgjigjet. Si njeri që përshkon çdo ditë Malësinë e Madhe poshtë e përpjetë, njerëzit e pyesin me kureshtje, sa po arrin në Tamarë «Nikollë, ku punon sot? C'thonë vullnetarët?».

Postëshpérndarësi vë buzën në gaz, dhe gje-gjet: «Me çka shof, shpejt kemi me ja hypë ma-qinës. Djelmoshat janë hqedhë në sulm. Veç t'i shikoni, mor shokë, si fluturojnë në Cem shkambi-jtë...»

Dhe pa mbaruar mirë fjalën Nikolla, lugina e Brojës sjell në veshët e malësorëve gjëmimin e fortë të minave, oshëtimën e jetës së re në këto male të heshtura.

Frontet e punës të sektorit numër 2, ku në pjesën më të madhe punojnë vullnetarët e re-thit të Durrësit, shtrihen gjatë gjithë bregut të lumit. Pjesën më të madhe të vullnetarëve e përbëjnë nxënësit e shkollës «Naim Frashëri», nisia-torët e parë të luftës kundër koncepteve të vjetra e paragjykimeve të kota fetare. Fryma revoluci-onare, që karakterizon këta nxënës, për të pas-truar ndërgjegjen nga çdo ndikim i huaj, shpre-het më së miri edhe këtu në aksion, në punë për ndërtimin e rrugës së re. Ambientimi kaq shpejt i këtyre nxënësve të qytetit bregdetar me natyrën i ashpër të maleve të Kelmendit, me borën, tu-

fanin, ujët e Cemit dhe aq më tepër me punën e rëndë, dukej si një gjë e vështirë. Mirëpo nuk doli kështu, mbasi ata, me zjarrin rinor që u vlon në gji, u hodhën në frontin e punës me të gjitha energjitet e tyre. Ata plotësuan normat që në ditët e para dhe në punën e jetën e gjallë të aksionit u shfaqën virtutet e qmuara të moralit të shëndoshë komunist, lindën sulmuesit e parë, pararoja e skuadrave, kompanive dhe brigadave.

— Të thyejmë normat ekzistuese! Një për të gjithë, të gjithë për një. Përpara!

C'doli nga kjo? Doli që shkollarët normën e vjetër nga 1,3 metra kub që ishte më parë tanërenë në 1,7 e pastaj në 2 metra kub.

«Jo për lavdinë tonë personale, po për të mirën e atdheut, të socializmit. Na kuptoni drejt, shokë e shoqe!» shkruanin ata në thirrjen që u drejtuan vullnetarëve të sektorit Nr. 1 Dëshira janështë të përfundojë sa më parë rrugën...

Luftëtarët derdhin djersë, shkëmbinjtë rrroku-lisen në Cem, shemben drurët shekullorë.

Traseja kapercen, qafa, lugina e male, e Nikolla, shpërndarësi i shtypit dhe postës, ecën mbi të dhe u jep shokëve sihariqin:

— Traseja kaloi më tej, u ca shkëmbi i Grabonit. Brigada «Q. Gjuzi» e Rrogozhinës, tri herë sulmuese, e ngriti normën ditore në 2,2 m<sup>3</sup>.

— Urra! Fitore!

Një vullnetare lë mënjanë kazmën, fshin djer-sën, nxjerr nga xhepi fletoren dhe lapsin, e nis të shkruajë:

I fortë shkëmbi, më të fortë jemi ne.  
Dekurajim aspak, s'na mposht asgjë mbi  
dhe  
Kazmën pushkën nga librat s'do t'i nda-  
jmë,  
Kështu do marshojmë përherë, në çdo  
aksion.  
Me kazëm do ngrejmë ne vepra madhë-  
shtore  
Me pushkë në krahë gjithmon' do vigji-  
lojmë,

— Suzanë, po vijnë minatorët, si jemi sot?  
— Si përditë, dy mbushje më tepër nga nor-  
ma, i përgjigjet shokut të punës, Islamit, tri he-  
rë sulmuesja e shkollës «Naim Frashëri» Suzana,  
duke shtrënguar barominën, që futet thellë në  
shkëmbin gëlqeror. U afrohem, i fotografoj. Su-  
zana më shpjegon:

— Kur erdha këtu s'dija ç'është baromina.  
Është hera e parë që marr pjesë në një aksion  
me karakter kombëtar. Më pëlqejnë këto male  
të ashpra, me njerëz bujarë dhe trima. Më vjen  
keq që po merr fund aksioni. U mësuam, u kali-  
tëm. Besomëni, të gjithë kemi shtuar në peshë.  
Puna është shëndet, kalitje, burim energjish, më-  
sim. Sa mirë na mësojnë partia dhe shoku Enver!  
Vajza tha këto fjalë dhe, duke kthyer kokën  
nga vullnetari që kishte pranë ju lut:

— Më jep mua varen, ti mbaj barominën!  
Dhe qëlloi me gjithë forcën e muskujve, du-  
ke shpërndarë në ajër tinguj të fortë metali-  
kë, që mua më ngjanin si refren i këngës, që  
përsëritej rregullisht:

I fortë është shkëmbi, më të fortë jemi ne.

Pak më tutje, ca djelmosha i janë qepur shkëmbit, e godasin me kazma, dhe kohë pas kohe i shkëputin pjesë të mëdha nga trupi për t'i rrukullisur në honet e Cemit, si orteqet në dimër.

— Kujdes, shokë! Gjithmonë nga prapa shkëmbit se... — qorton një më i rritur vullnetarët.

Nga të folurit ke përshtypjen se këta djelmosha i përkasin pellgut të Shkodrës, por nuk janë shkodranë. Gjini, Pali, Gjoka, janë nga Manatia e rrëthit të Lezhës. Ata kanë dalë dy herë sulmues. Janë të reja e të rinj sypatrembur dhe me sedër të zhvilluar malësori, revolucionarë me kuptimin e plotë të fjalës, të parët në sakrifica, të fundit në pretendime. Komandanti i brigadës tregon se si ky masiv shkëmbor ishte planifikuar të hidhej në erë, pasi të vendosej aty pranë motokompresori dhe se si të rintjtë lezhjanë nuk pritën po i hynë punës.

— Motokompresori le të punojë në një sektor tjetër, — kishin thënë ata, — muskujt e kraheve tanë do ta bëjnë punën më mirë se kompresori këtu.

— Masivi është shumë i fortë, i vështirë përt'u shembur!

— Pikërisht se është ashtu, duam të provojmë forcën tonë ne — ishin përgjigjur lezhjanët dhe i ishin qepur shkëmbit.

Beteja kishte nisur, shkëmbi kryeneç qe dorëzuar dhe tani aty valëvitej një flamur i kuq, simbol i fitores së njeriut tonë të ri, mbi natyrën. Kazmat godasin pa pushim, barominat shpo-

jnë zemrën e shkëmbinjve, që pas pak hidhen në erë, djersa rrjedh çurk e arteri dritëdhënës, rruga ku nesër do të uturijë maqina, zgjatet, në thellësi të alpeve. Në këtë betejë të rëndësishme pune e shkolle revolucionare, edukohen e kaliten të rinjtë tanë, duke patur pikësynim që t'i bëjnë malet po aq pjellore e të lulëzuara sa fushat. Në të gërshtohen kujtime të largëta e të afërtë. Endrra dhe dëshira, ndjenja të flakët për punën, për të mirën e atdheut. Aty farkëtohet ndjenja e solidaritetit proletar e humanizmit. Ja, Hajrija nga Tropoja, e rrëmbyer nga vrulli dhejeta e aksionit, kishte kohë që kishte harruar dhembjet nga apendisiti, gjersa një ditë u gjet kruspull. «Plasje apendisiti», konstatuan mjekët e sektorit, kur e vizituan. S'kshte rrugë tjetër vec të operohej urgjent. Po ku? Spitali ishte larg, shumë larg. Duheshin bërë afro tri orë rrugë më këmbë.

Dymbëdhjetë djelmosha e vajza të brigadës «Manush Aliman», rrugë pa rrugë, duke mbajtur në krahë barelën, ku qe shtrirë vajza, thyen ndofta normat më të përparuara të «vrapimeve» nëpër male. Në këtë mision, sa fisnik aq humitar, atyre u printe dashuria për shoqen e punës, për njeriun. Qëllimi u arrit. Pas një ore e njëzet minutash barela me të sëmurën,jeta e së cilës qëndronte në fije të perit, ishte në vendin ku priste autoambulanca. Tropojanja shpëtoi. Atë ja rrëmbyen vdekjes nga thonjtë vullnetarët dhe mjekët me humanizmin, guximin dhe sakrificën e tyre.

Do të kalojnë vite. Nëpër rrugën e Malë-

sisë së Madhe do të lëvizin lart e poshtë autobuze, kamiona plot lëndë druri, të nxjerra ngë pyjet virgjër të këtyre maleve e me mallra të ndryshme, e malësorët e Kelmendit do të urojnë me gjithë zemër të rinxjtë, ushtarët dhe gjithë ata që ndihmuani në hapjen e saj. Kurse Marku dhe bashkëshortja e tij, Ageja, nga Selca, do t'u tregojnë fëmijëve se si një ditë të bukur prilli të vitit 1967, duke ju përgjigjur thirrjes së partisë, i vunë kyçin shtëpisë dhe zbritën në aksion, punuan krah për krah me durrsakë e shkodranë, peshkopias e lezhjanë, mirditorë e tiranas... Ata mposhtën ndjenjën e rehatllékut, kanune e zakone prapanike dhe u rreshtuan në radhën e guximtarëve duke kryer si duhet detyrën patriotike ndaj atdheut e popullit. Kështu do të tregojnë çiftet e tjera Rizai e Lubja nga Kopliku, Toni e Vitorja Muhameti dhe Servetja, të cilët lanë vatrën familjare, dolën vullnetarë.

Brigjeve të Cemit do të lulëzojë jeta e re. Në Malësinë e madhe do të jenë ngritur kantieri të reja pune, shkolla e institucione shëndëtësore, po 300 të rinj e të reja, vullnetare të para të këtij aksioni, do të kujtojnë kurdoherë më mall ditën kur në sheshin para çadравe, shokët e dërguar nga partia dhe shoku Enver u dorëzuan teserat e anëtarit të BRPSH. Ata do të kujtojnë betimin solemni të tyre për t'i shërbypër kurdoherë me ndër atdheut, si ndërtonjës të socializmit dhe mbrojtës besnikë të fitoreve tonë. Atë ditë, këtu të rinj e të reja, pasi muarën tesarat, i dërguan një letër shokut Enver Hoxha, me anën e së cilës dhanë besën se do të punojnë,

do të mësojnë dhe do të luftojnë gjithmonë si revolucionarë, si pasues të denjë të veprës së mëdhe të komunistëve dhe gjithë popullit, të cilët i sollën vendit lirinë.

U largova nga vullnetarët me ndjenja të larta respekti për ta. Kujtoja tablotë e bukura të punës në ato ditë e net sulmi mbi male, ku gërshtohej thjeshtësia me heroizmin, vrulli revolucionar me romantizmin, dëshirat rimore me vullnetin e çeliktë për të çarë gjithnjë përpara drejt objektivave që ka caktuar partia. Atdheu ka patur gjithnjë besim tek kjo rini, me vullnet të papërkulur, që di të kapërcejë çdo pengesë e vështirësi në udhën e saj, duke lënë pas vepra madhështore, përmendore që s'do të kenë mort kurë.

Piketat bëjnë gjithnjë përpara, traseja kapton male, shpate e lugina, flamurët e fitores valëviten thellë e më thellë alpeve dhe malësorët, si mbarë vendi, i thurin këngët më të bukura partisë, shokut Enver dhe jetës së re, socializmit fitimtar.

*Marrë nga «Bashkimi» 1 maj 1967*

## MELODI E RE NË BJESHKËT E VJETRA

Shpërthejnë minat, gurët rrokullisen me zhurmë, ndonjë kalimtar atje poshtë struket mbas trungut të ahut, e lugina ushton. Ushtojnë malet. Karvani i mushkave ende vazhdon rugën në shtigjet e vjetra zigzage të shpatit të malit, kurse ne i lëmë ato shtigje dhe ecim në trasenë e re. Nuk është më i zhveshur mali. Pemët gjelbërojnë. Ngjyra të gjalla të një natyre të ashpër. Po sa të tërhjek kjo ashpërsi malesh! Ndoshta sepse ka një bukuri të rallë, apo ndoshta sepse në vesh më erdhi melodia e një këngë që këndohet diku... larg apo afër? Nuk mund ta përcaktoj. Ajo jehon në luginë, e më duket se vjen nga të gjitha anët. Melodia e re në bjeshkët e vjetra.

Ecim. Rrjeshti i vullnetarëve është i gjatë. Punojnë dhe këndojnë. Cila kompani jeni ju? — pyesim një grup vullnetarësh që kishin rrëthuar një shkëmb dhe po bëheshin gati ta hidhnin poshtë.

— Kompania e Shllakut — na përgjigjet një djalë bjond, i dobët, i gjatë po shumë i shkathët.  
— A mund të na njihni pak me komandanin e kompanisë?

Ai qeshi lehtë, u afrua drejt nesh, na zgjati dorën e tij të ashpër e plot kallo, e na tha:

— Njihuni, Lekë...

— Lekë, kompania juaj në fillim ka qenë problem për shtabin qendror të rrugës. Ishit të padisiplinuar. Një ditë shiu, në çadrën tuaj, filloi një bisedë e zakonshme, e cila, për hic gjë, kaloi në grindje. Zefi dhe Ndoci u rrahën. Ju i nxorët para kompanisë dhe ata e pranuan gabimin. Tashti shkojnë shumë mirë, janë shokë. Ju në fillim nuk i bindeshit rregullit të kampit. Prishnit qetësinë në orët e vona të natës, në çadrat tuaja mungonte pastërtia, e as në punë nuk e realizojshit normën. Kurse sot shokët e shtabit qëndror flasin fjalë të mira për ju. A mund të na thuash, Lekë, si ja arritet që nga kompani e mbrapambetur të shpalleni kompani sulmuese?

— Ne jemi nga fshatrat e Shllakut. Nuk kemi ba ndonjiherë jetë kolektive. Na e kishte marrë mendja me punue si të na tekët. Ne malësorëve na dukej fyemje kur të tjerët na kërkojshin llogari. «Pse — thojshim ne — ky ose kjo don llogari. Pse — thojshim ne — ky ose kjo don me na diftue ne se kur me fjetë, a? Pse nuk shikoni ma mirë punën e vet!». Por ne e kishim gabim. Tamam ajo ishte puna e tij, me na edukue, me na mësue me ba nji jetë të rregullt, ashtu si të gjithë shokët, por që ne i pamë vonë. Shokët e shtabit na kanë mbajtë shumë afër. Nji ditë në kompaninë tonë erdhë sekretari i parë i komitetit të rinisë të Shkodrës. Ai ishte një dijeni të të gjitha dobësive tona. Na foli gjatë, na foli aq shumë, sa ne u prekëm në sedër.

Me punën tonë të dobët damtojshim rininë e të gjithë rethit. Mbas disa ditëve do të zhvillohej konferenca XV e rinisë së rethit tonë. Kongresi V i rinisë ishte shpallë. Si do ta shlyejshim fajin? Atë ditë premtuem që do të bahemi kompani shembullore. Punën e filluem me vrull. Çadrat tona ndryshuen menjherë. Sa të pastëra u banë! Dhe orarin e zbatojshim gjithnjë, i bindeshim çdo urdhni. Në punë norma filloj të plotësohej gjithnjë e ma shumë. «Për nder të Kongresit!» thojshim ne, e vrulli na shtohej. Në fillim e kishim normën 1,7 m<sup>3</sup>, e realizojshim rreth 100 përqind. Me iniciativën tonë e ngritëm normën në 2 m<sup>3</sup>, kurse realizimi kaloi në 110 përqind. Në kompani sot dallohen shumë vullnetarë. Ne u shpallem kompani sulmuese. Kemi vendosë me e mbajtë këtë titull deri në fund të aksionit. Kemi besim në forcat tona, sepse këtë besim na e dha vetë kolektivi. U thoni në komitetin e rinisë që fjalën e kemi mbajtë.

Sa të gëzon një kthesë e tillë në jetën e një kompanie! U urojmë atyre suksese më të mëdha dhe vazhdojmë rrugën. Mbi atë shkëmbin e madh, që pothuajse është copëtar nga minat, bie pa pushim kazma e një vullnetari. Një djale tjetër e një vajzë mbajnë barominat e varetë e rënda, i shtyjnë ato drejt shkëmbit që po mundet.

Kush i përdor me aq shkathtësi varetë? Kush janë këta të pestët. Le t'i njohim, i dashur lexues.

- Puna e mbarë!
- Mbarë pagi!
- Të cilës organizatë jeni ju?
- Të organizatës së rinisë Pjetërshan-Gradec

të lokalitetit të Koplikut — përgjigjet vullnetari që ka hypë mbi shkëmb.

— Sa vullnetarë keni ardhë?

— Organizata jonë — vazhdon ai — duhej të dërgonte tri të reja e dy të rinj për këtë turn. Nga fshati ynë asnjëherë nuk kanë shkuar vajza në aksion, prandaj organizatës i dolën pengesa të shumta. Ne të pestë vendosëm ta thyenim të parët këtë rezistencë. Unë erdha me gjithë gruan, Lubën, kurse ky shoku im, erdhi me dy të motrat, Katrinën e Hanën. Ky qe hapi më i vështirë, kurse në turnin tjetër do të vijnë më shumë dhe më lehtë. Ne kemi mjaft gjëra për tu thënë kur të kthehem.

— Po mirë, më fal, si e ke emrin ti?

— Riza — përgjigjet bashkëbiseduesi.

— Ju, Riza, gjithnji veç rrini?

— Jo, jo, as ne nuk e dimë si ndodhi që u grumbulluam të pestë, sepse të shpërndarë punojmë. Edhe nér aktivitete marrim pjesë. Këto ditët e fundit në sektorin tonë erdhën disa vullnetarë nga Tirana. Vajzat tona shoqérohen shumë me vajzat e tyre.

— Ku punojnë ato?

— Ecni edhe pak, se do t'i takoni.

. . . . .

«Në sulp përpala, brigadë kreshnike

. . . . .

Këndon një grup vullnetarësh. Melodia e këngës së tyne harmonizohet me ritmin e kazmave, me shpërthimin e minave, me gurgullimën e ujit.

Kallot në duar posa u janë formuar. Kanë vetëm disa ditë që kanë ardhur. Komandanti i kompanisë «Hekuran Zenuni», të ndërmarrjes së Ministrisë së Mbrojtjes, na foli për punën që po bëjnë ata me të rejet fshatare këtu në aksion.

— Me ç'punë merreni në Tiranë ju vajza?

— Të gjitha jemi rrobaqepëse — përgjigjet Eljana, zv. sekretare e organizatës së rinisë.

«Rrobaqepëse!» mendova unë. Ç'kontrast! Pota'i kisha parë në mbrëmje, në bulevardin e ndriçuar me drita neon, zor se do të mundja t'i përfytyroja se si do të ishin në luftë me shkëmbin këtu, në malësi. Po a ka vështirësi që e ndal vrullin rino? Duart e Zanës, të Dhorës... të cilat shtërangojnë kazmën aq fort, më thanë «jo, nuk ka». E unë bindem. Gjithkush bindet.

Po malësori nga fshati Vukël i Tamarës a do të bindet që jetë e re po depërtón në thellësi?

Vajzat e Vuklit në aksion erdhën me shamilja në krye. Edhe Mare Nikoll Cekaj, vullnetarja që u zgjodh kandidate për në këshillin populor të lokalitetit të Tamarës, me shami erdhi. Sot, ato, jo vetëm që i kanë hequr shamijat, po i kanë prerë edhe flokët, i kanë rregulluar bukur.

— Mare, si do t'u thoni shoqeve tuaja kur të ktheheni?

— Kur lexuam parullën që u shkrua këtu «Ta presim Kongresin është BRPSH-së me rezultate të rreja», ne vendosëm me hjekë shamijat — do t'u themi atyre ne — e mos me i vue ma, prandaj edhe ju për nder të Kongresit duhet ta bani këtë.

— Jo vetëm kaq — ndërhyn Filja — ato do t'i mësojmë edhe me kërcye.

— Po ti, Shaqe, çfarë do t'u thuash?

— As unë nuk e di si do ta filloj bisedën.  
Kam aq shumë gjana me u thanë.

Me të vërtetë shumë gjëra kanë. Dhe mali  
lësori plak ka për t'u bindur. Kanë kaluar shumë  
pranvera, por kjo e këtij viti ka diçka të veçantë  
nga të tjerat.

Shpërthejnë minat, gurët rrokullisen me zhurmë,  
ndonjë kalimtar atje poshtë struket mbas  
trugut të ahut, e lugina ushton. Ushtojnë malet.

*Malësi e Madhe, maj 1967.*

*Marrë nga «Zëri i Rinisë»*

*24 maj, 1967*

## PUNE HEROIKE

Unë e ndjeva atmosferën dhe entuziazmin e tyre pa arritur ende në vend. Që lart, nga maya e malit të thepisur, dëgjohej zhurma e kazmave, lopatave dhe këngëve të tyre. Qëllontë që të shpërthente ndonjë minë dhe atëhere të dukej sikur këto zhurma kazmash e lopatash, sikur këto këngë humbisnin diku thellësive të Lugut të Grabinës; mirëpo përsëri, pasi shuhej krisma e shpërthimit të minës, ato dëgjoheshin edhe më të forta, më të ëmbla, më entuziazte.

Arrita vonë, kur dielli kishte humbur tutjemaleve. Një mori çadra e rrjeshtuar njëri pas tjetrit, tamam si ushtarët në kolonë për dy, sajnin një pamje të bukur. Quajeni si të doni, qytet a fshat këtë vend, po ai nuk është një vend i zakonshëm. Këtu s'ka lëvizje kamionash, vetrash, qerresh; s'ka pijetore, bile s'ka as të vegjël, as pleq. Ai është një qytet rinie, qytet pune e këngë. E kur futesh në një qytet të tillë, padashur ndjehesh i përrirë shpirtërisht dhe nuk të kujtohet më lodhja që ke ndjerë.

Pashë shumë lëvizje nëpër çadra. Duke ecur

Rinia me torcën e saj shembri gurët shekullorë.



dëgjova disa duartrokitje të forta si breshëri armësh.

— Kemi festivalin e grupeve tona artistike — më tha një vullnetar. U drejtova për atje. Një shesh i vogël i mbushur plot e përplot me vullnetarë. Po jepnin shfaqje grupi i shkollës «Naim Frashëri» dhe ai i shkollës «Dr. Medar Shtylla». Tingujt e këngëve dhe të recitimeve përplase-shin me furi maleve e bashkë me shushurimën e lumit të Cemit, lëshonin një jehonë të émbël jo-shëse.

Më bëri përshtypje kur mora vesh se në repertorin e shfaqjeve të tyre shumica e pjesëve ishin krijime të vetë nxënësve. Aktorët e vegjël u këndojnë këtyre bjeshkëve krenare, atdheut e partisë, godasin të metat dhe zakonet e vjetra në jetën tonë. Dikush në vjershën e tij i këndon rrugës së re, dikush tjetër Cemit, me atë pamjen e tij të madhërishme. E ku s'të çon kënga e tyre rinore? Kudo, sepse kudo rinia ka derdhur energjitet e saj, kudo ajo ka vulën e saj.

Mbrëmja bie e purpurt dalëngadalë. Është përsëri kënga ajo që e bën karakteristik këtë qytet. Kënga shoqëron çdo grimcë jete të këtyre banorreve të rindës. Aty, sipër çadrave, dëgjohen tingujt gazmorë të fizarmonikës. Vullnetarët e brigades «Margarita Tutulani» kanë mbasdite dëfrimi.

\* \* \*

Të nesërmen doli ditë e bukur, por Cemi dukej sikur ulërinte. Vendosa të shkoj së pari në zonën ku punonin 51 vajzat e Tropojës.

— Kjo është «brigada e vajzave» — tha komandantja e brigadës.

Ato punonin të gjitha njëlloj, pa lodhje, pa droje. E pyeta si shkonin me realizimin e normës.

— Në fillim brigada jonë qe nga më të prapambeturat, por bëmë kthesë shumë shpejt.

Pastaj shtoi:

— Ditët e para vajzat tona qenë të myllura, të pashoqërueshme, bile nuk dilnin fare nga çadrat. Veshja dhe flokët e tyre binin në sy menjëherë. Tani ju i shikoni vetë.

Ato punonin, qeshnin, bënин shaka me njëratjetrën. Tani shumica e tyre i kanë prerë flokët. Më bëri përshtypje një vajzë që punonte me vare.

E quanin Zade. Kishte ardhur nga fshati Shoshan. Ishte e fortë, si burrë. Ja kishte marrë dorën varesë.

Fytyra e saj kishte marrë një ngjyrë të kuqe, gadi po aq të kuqe sa ç'ishin 3 «S»-të që i shndrisnin në gjoks.

Një vajzë tjetër, më tutje, mundohej të rrokulliste një gur të madh. Ajo nuk ishte dhe aq e rritur nga trupi.

— Kjo është motra e dëshmorit Jaho Salihi, emrin e të cilët mban brigada jonë. E quajnë Kumanije. E kemi nga më të mirat.

Atje kishte 51 vajza, që kishin ardhur nga fshatra të ndryshme: Shoshan, Lek-Bibaj, Kaçanaj, etj. Vetë komandantja e brigadës, Lezja, kishte ardhur nga Lek-Bibaj, 6 orë më këmbë larg Tropojës. Kishin pëshpëritur ndofta për të, e kishin sharë nën hu-

ndë, por ajo nuk i kishte përfillur ata, qe nisur e kishte ecur orë të tëra më këmbë. Atë s'e dallon dot nga një qytetare, jo vetëm nga veshja, por as nga të folurit.

Kur po largohesha prej tyre, ajo më tha:

— Megjithëse jemi brigadë vajzash, ne nuk jemi pas brigadave të tjera. Jemi zotuar ta realizojmë 110 përqind normën ditore.

Ata të shtabit thanë fjalë të mira për brigadën e Rrogozhinës. Duke shkuar tek ata, ndalova pak me vullnetarët e shkollës «Dr. Medar Shtylla».

Njëri prej tyre mori barominën dhe ju afrua atij gurit të madh që i kalonte  $4 \text{ m}^3$ . Duhej bërë kavaletë për të vendosur minën, ndryshe ishte vështirë ta rrrokullisje poshtë.

— Lëre barominën! — u hodh e tha tjetri. — Pse të mos e hedhim me krahë? Kështu kursejmë edhe minën.

Mbi dhjetë duar të vogla, por të fuqishme, ë mbërthyen atë qenje pa shpirt. Në fillim guri as lëvizi fare, pastaj, pak e nga pak, zuri të imposhtet, gjersa u dorëzua. Ai humbi thellësive të Cemit plot zhurmë.

Bashkë me ta punonte dhe drejtori i shkollës, Shkëlzeni. Atë e gjeje kudo. Nxënësit e donin mësuesin e tyre, që gjithmonë i bënte të ishin gazzmore.

Kur po largohesha prej tyre pashë flamurin e kuq, ku qe shkruar me shkronja të bukura: «Brigadë sulmuese».

Kur u ndodha në mes të vullnetarëve të Rrogozhinës më erdhi pak çudi, sepse këta ishin të

gjithë trupvegjël, ndërsa mbanin flamurin e sek-torit pér ditë me radhë.

— Kështu na pandehin të gjithë ata që s'na njohin. — më tha mësuesi i tyre, — kujtojnë se jemi trupmëdhenj. — Ai më tregoi një djalosh me trup mesatar, por të lidhur mirë. Ishte zhveshur i téri, nga mezi e lart, e qëllonte me kazmë një gur të madh.

— Samiun e kemi punëtorin më të mirë, — më tha komandantja e brigadës. — Është mje-shtër pér të hapur kavaleta pér mina.

Sot ata punojnë jo si çdo ditë. Secili mundohet të jetë serioz. Komandantja më shpjegoi gjithçka.

— Mbrëmë nà e morën flamurin ata të «Naim Frashërit». Ne vërtet ua kaluam atyre pér sa i takon volumit të punës, por humbëm disa pikë në aktivitetet e tjera. Prandaj . . .

— Sot duhet t'uua marrim flamurin — hidhet e thotë Esati.

— S'ikim në Rogozhinë pa flamurin e sek-torit — thotë Bardhyli.

— Të gjithë punojnë si një trup i vetëm. Ata s'e harrojnë ditën e kaluar, kur komandantja e ty-re gati duke qarë doli nga çadra e shtabit, ku ishin komunikuar rezultatet e punës së treditorit të fundit.

Kur sheh Samiun, Esatin, të nxirë nga dielli, që ndihmojnë njëri-tjetrin në çdo çast, kur sheh pedagogun e tyre të fiskulturës, që përleshet me gu-rët më të mëdhenj, vetëvetiu të mbushet men-dja pér fjalët e mira që ke dëgjuar pér ta. Ndofta në mes tyre ka dhe çapkënë, ka dhe nga ata që

mësuesi i ka nxjerrë jashtë mësimit dhe i ka qortuar rëndë. Por këtu puna i ka bërë vellezër, puna i ka bërë të ndërgjegjshëm.

Tani ata i lënë lamtumirën Malësisë së Madhe. Ata marrin këtej shumë kujtime të bukura, disa prej të cilave ndofta do t'i humbë koha. Por rruga që ata hapën është një kujtim i paharruar. Ata sollën këtyre anëve fjalën që u tha partia. Ajo fjalë u shpërnda kudo, u bë jetë, u bë këngë, rrugë, ku do të parakalojë zhvillimi më i shpejtë i krahi-nave malore.

Secili do të kthehet në vendlindjen e vet, por jo ashtu siç erdhi. Ata shkojnë me mendime të reja, me ndërgjegje më të formuar, me shpirt vetëmo-himi. Puna u ka forcuar trupin, shpirtin dhe mendjen.

Nesër, kur këta nxënës do të bëhen punonjës të atdheut, atyre do t'u kujtohen këto ditë ak-sioni plot vrull e entuziazëm, e atëhere do t'i shtonjnë dhe më tepër forcat në shërbim të atdheut. Keni parë ndonjëherë heronj të gjallë? Po të doni ata i gjeni atje, në Malësinë e Madhe, duke u kacafytur me shkëmbinjtë e me ashpërsinë e maleve, pa menduar asnje çast pér vështirësitë. Po, po, ata janë heronj, ata bëjnë punë heroike.

*Marrë nga «Zëri i Rinisë»*

## NE THELLESI TË BJESHKEVE

### Dy kujtime

Më kujtohet se si, këtu e nia dy viet më parë, patëm takuar në Leqet e Hotit një malësor. Ai ngiste përpëra mushkën, mbi të cilën pat ngarkuar një dollap buke. Shtegu ishte i ngushtë. Kështu që dollapi përplasej herë pas here anës shkëmbinjve. Mushka ecte me vështirësi dhe në një kthesë e mori ana e gati sa nuk u rrëzua. Malësori nxitoi ta kapte për kapistalli, dhe, duke rrezikuar veten, e shkarkoi barrën nga kafsha. Pastaj, pa ç'pa, u detyrua ta hidhte mbi supe dollapin e të zbriste te poshtë. A mund ta mendoni se në ç'vështirësi hastë ai burrë i fortë që çapiste nëpër shtegun e ngushtë? Shtegu shkonte vende-vende buzë humnerës, që binte poshtë thik, me qindra metra. Ju afroam malësorit dhe i thamë ta ndihmonim. Dhe kështu, duke e mbajtur me hall të madh plaçkën, duke pushuar vende-vende, zbritëm. Rrugës fshatari na tha se kishte qejf të blinte dhe ca plaçka të tjerë për shtëpi, po kjo ishte gjë e vështirë.

— Nuk ke si i zbret nga Leqet e Hotit, — tha malësori.

— Do të hapim rrugë maqine, i tha shoku.  
Malësori buzëqeshi.

— Eh, mor mik! Këtu nuk hapet rruga. Po ta hedhësh brashkën nga maja, nuk ja gjen fijen në fund. A nuk e sheh çfarë dreq mali është ky? E si mund të çahet tërë ky mal?!

Ne ngritëm kokën lart, pamë Leqet e Hotit, dhe, të themi të drejtën, as nuk ishim në gjendje ta përfytyronim si do të mund të gjarpëronte rruga nëpër mal të zhveshur e të pjerrët.

\* \* \*

Po atë ditë që arritëm në Vermosh, rastisi të mbrinte atje edhe një mjek gjinekolog, bashkë me një ndihmësmjek. Ata qenë nisur urgjent, që më naqë, nga Shkodra, për të arritur sa më shpejt në Vermosh, ku lëngonte një grua shtatzënë. Me mjetet e nevojshme ngarkuar mbi mushkë, ecën pa pushim, nga Rapsh-Starja, deri në Vermosh. Kush e ka bërë këtë rrugë me këmbë e di sa kohë zgjat dhe sa e lodhshme është. Po këtu nuk ishte puna për lodhjen, po vetëm për kohën. Një grua ishte në rrëzik. Kësaj gruaje nuk kishte ç't'i bënte mëmia. Pritej mjeku. Dhe mjeku erdhi. Ky u fut pa e zgjatur në dhomën e së sëmurës. E vizitoi me ngut dhe, aty për aty, vendosi ta operonte. Ai mbajti pranë vetëm ndihmësmjekun, maminë dhe një fshatar. Të sëmurën e ngritën peshë, dhe, me kujdesin më të madh, e lëshuan mbi një shtrat tjetër të lartë, që ishte pranë dritarës.

Ne prisnim jashtë të shqetësuar. Nëna, dhëndri, dajallarët patën ngirirë nga shqetësimi. Nusja e pat

dështuar një fëmijë, mos do ta dështonte dhe këtë? Çfarë?! Ta dështonte? Atëhere familja do të mbetej pa fëmijë... Po së pari donin të shpëtonte nusja. Nga brenda dëgjoheshin hera-herës ca fjalë të shkëputura. Qetësi. Ca tinguj metalikë. Qetësi. Pastaj një zë i hollë si mjaullimë... Dera u hap me vrull dhe mamia thirri:

- T'u rrojë! Djalë e kini!...
- Po nusja?
- Si molla...

Hymë brenda. Mjeku tha se nuk ishte mirë të hynin kaq njerëz, se rëndohej frymëmarrja e bëhej zhurmë. Kësaj radhe nuk e dëgjoi njeri mje-kun. Nuk dolën jashtë, po aty pér aty u vendos një qetësi e thellë. Mjeku ishte lodhur. Në ballë i patën buluar pikëza djerse. Lehona dyllë e verdhë, i mban-te sytë gjysëm të çelur. Nëpër buzët e saj dhe nëpër sytë gjysëm të çelur rrëshqiste një gëzim që mezi diktohej.

- Faleminderit — tha ajo.
- S'ka gjë... asgjë!... tha i turbulluar mje-ku. Rrini e qetë. Mos flisni.. Ju mos e pyesni — na u drejtua neve.
- Pat rrezik? — e pyeti dikush.
- Pat, por tani rreziku kaloi. Sikur të kisha ardhur një orë më vonë do t'i kishim punët keq.
- Ah, kjo rrugë sa na pengon!
- Do të ndërtohet edhe rruga — tha mjeku. Fshatari buzëqeshi njëlloj si ai malësori poshtë Le-qeve të Hotit.
- Ka pér t'u ndërtu, mor Kolë, ka pér t'u ndërtu e atëhere kini me pa si do të hyjë maqina në katund...

## Kamioni me targë 17-78

Në të dalë të Rapsh-Starjes na zuri rrugën një kamion me targë 17-78. Shoferi i ra burisë, po kamioni nuk lëvizi. Shoferi ynë i ra përsëri burisë. Nga kabina e kamionit doli një djalë me shtat mesatar, mjaft i shkathët.

— A nuk e shihni? — pyeti duke na treguar me gisht karrocerinë ku po ngarkonin ca tuba të mëdhenj prej betoni. — Prisni pak!

Ne pritëm. Shoferi i kamionit këceu mbi karroceri e filloj t'i udhëzonte punëtorët si t'i shty-nin tubat e betonit nëpër dy trarë të vendosur buzë karrocerisë.

— I ra vlefta edhe kamionit tënd, o Sali! — i tha një punëtor.

— Me gjithë mend e thue? — e pyeti Saliu.

— Po, për besë. Në fillim ishe vetëm ti, kurse tash janë shtue kaq shumë makina, sa nuk ua mbajmë mend targat.

Tërgat e të tjerëve nuk i mban mend, po targën e kamionit tim e mban mend, dhe jo vetëm ti, po tanë malësia.

Punëtorët filluan ta ngacmonin shoferin. Ai nuk zemërohej, vetëm se bënte shaka. Pastaj njëri nga punëtorët tha:

— More Sali, të turpëruam para atij shoferit që i ke zënë rrugën. Ai nuk e din se kush jeti...

Ne e morëm vesh se kush ishte Saliu. Morëm vesh edhe pse mbahej mend targa e kamionit të tij. Saliu ishte kreshniku i maleve. Po, tamam

kështu. Ishte i pari që kishte kaluar me kamion nëpër Leqet e Hotit. E kush e harron atë ditë? Buria gjëmonte nëpër dredhat e Leqeve të Hotit. Gjëmonte buria, gjëmonte motori, gjëmonte tërë malësia. Ah, sa ditë e bukur ka qenë ajo! Fëmijët dilnin nga shtëpitë, linin kecat e dhitë, e duke u hedhur gur mbi gur, qëndronin majë shkëmbit, buzë xhadesë. Ata thërrisin me sa zë kishin e të lumtur çonin duart lart. Kur maqina kaloi pranë shkollës, nga dyert e klasave, bile dhe nga dritaret, u hodhën fëmijët e i dolën përpara maqinës. Saliu muk kishte parë kurrë kaq tepër sy të gëzueshëm! Sy fëmijësh, grash, burrash, pleqsh... Saliu i binte burisë, buzëqeshte dhe se si e ndjente veten.

Në Tamarë, apo në Rapsh-Starje, një fshatar i fali si shenjë kujtimi një palë çorape të reja prej leshi. Në një fshat tjetër një fshatar u mallëngjye kaq shumë sa qau nga gëzimi.

— O, moj parti, të qofshim falë! Faleminderit... faleminderit... Kjo është si ëndërr!

### Në Selcë

Kështu kamioni kalon tani nga Rapsh-Starja, në Tamarë dhe prej këndej arrin në Selcë. Një vit më parë çadrat qenë ngritur në Rapsh-Starje dhe në Tamarë, tani qyteza e vullnetarëve është shpërngulur në Selcë. Qyteza është ndarë në dy lagje të mëdha: në Selcën nr.1 ku janë grumbulluar vullnetarët e Tiranës, Durrësit, Lushnjës, Elbasanit, dhe në Selcën nr.2 ku janë grumbulluar vullnetarët e Fierit, Vlorës e Beratit. Këta janë vullnetarët e parë të këtij turni, që do ta shpien akonit.

ma më tej rrugën, drejt fshatit Gropë, e drejt fshatit Vermosh.

Midis gurëve të bardhë, në lartësira të mëdha, prej nga lumi Cëm duket si një vijë e kaltër, vajza dhe djem përleshen me shkëmbinjtë. Duart e njoma shtrëngojnë fortë barominën. Mbi barominë godet fort vareja. Një herë, dy herë... dhjetë herë. Duart dhëmbin. Po guri ipet. Mu në zemër të gurit çahet një vrjmë. Me dhjetëra vrima të tilla çahen në zemër të shkëmbinjve. Në këto vrima vijnë e vendosin pastaj dinamitin ushtarët. Nga mëngjezi deri në darkë, midis shkëlqimit verbojnës të diellit e vapës së madhe që reflektohet nga gurët, vullnetarët e brigadave të ndryshme punojnë në garë njëri me tjetrin. Ata përdorin qysqinë për të ngritur copat e shkëmbinjve, grumbullohen e shtyjnë masivet gurore, heqin me kazmë thepat e mprehtë. Nga lartësitë bien me trapëllime gurët, dhe rruga çelet.

Pastaj duken ushtarët. Para ushtarëve ecën një djalë i ri, me shtat të hollë e të gjatë. Ai këcen i lehtë e i shkathët gur mbi gur, sikur këta gurë të mprehtë e të rrumbullakët, të jenë shkallë ndërtuesash vigane. Pas tij vrapojnë ushtarët. Djali i ri është oficeri që udhëheq vendosjen e minave. Nga larg shtrihet silueta që përkulet rrëzë shkëmbinjve. Përkulen dhe ushtarët. Në vrimat e hapura futen fitilat. Një, dy... dhjetë fitila. Dikush hipën majë një shkëmbi dhe thërret me sa fuqi ka: «Minaaat! Minaaat!». Jehona fluturon tej. Ndizet cigarja, me të ndizen fitilat. Ushtarët vrapojnë. I fundit vrapon oficeri, duke u hedhur gur mbi gur. Pastaj ata fshihen mbas shkëmbit, që bie

si çati mbi kokën e tyre. Dhe pesë sekonda. Dhe një sekondë. Shpërtheu mina e parë, e dyta... të gjitha në seri. Një tym i bardhë çohet në hava. Midis tymit fluturojnë gurët. Gjëmimi kalon si jehonë nga një shpat mali, në një tjetër. Në mëngjes vullnetarët i heqin këta gurë të copëtuar dhe hapin më tutje vrima të tjera.

Pastaj vjen mbasditja. Nga megafoni transmetohet muzikë. Në lëndinën me bar, lozin volejboll. Në një kënd lexohet shtypi. Në mencën verore dikush ulet në stol e shkruan letra. Diku bie fizarmonika. Anës qytezës nëpër rrugën gjithë gurrej kalojnë fshatarë. Djemtë e vegjël e vajzat e vogla u afrohen vullnetarëve. Një nxënës shkolle ulet mbi murin e gurtë e i bie çiftelisë. Poshtë, nga çadra e farmacisë, dalin disa gra fshatare. Me siguri ato kanë shkuar të vizitojen tek mjeku. Se kush u ka thënë se ka ardhur një mjek i mirë.

Qyteza e vullnetarëve sapo ka filluar jetën. Po fshati i Selcës është shtrirë me qytezen. Kështu rruga do të shtrihet më tutje...

*Marrë nga «Zëri i Rinisë»*

*1 maj 1967*

## HISTORIA E NJË QYTEZE VULLNETARESH

*Ahere binte dëborë, një dëborë me flo-kë të mëdha, që nuk kishte të sosur. Ne kishim hipur shumë lart, majë malit. Dhe në këtë lartësi na qëndronte mbi kokë qilli i ulët, ku përziheshin retë me mjegullën e lagët. Pastaj filloj të binte ski i rrëmbyer e të bënte furtunë e madhe. E patëm vëshitirë, vëlla, po nga puna nuk hoqëm dorë. Ne duhej të ndërtonim qytezën, ku do të vinin të jetonin vullnetarët, për të të ndërtuar rrugën.*

*(Nga tregimi i një ushtari).*

Sa kohë do të na mbeten ndër mend këto qyteza kapanonesh të gjata prej dërrasash e të thurrura herë të tjera me thupra gjineshtrash e thupra ahu! Këto qyteza të vogla e të thjeshta, të përhapura andej këndej nëpër fushën e qetë të Myzeqesë dhe buzë shpateve të Malësisë së Madhe. Këto qyteza që jetuan me muaj, pastaj u shpërngulën për t'u vendosur më tutje, pastaj shkuam edhe më tutje, deri sa ja arritën qëllimit... Këto janë qytezat më të lëvizshme të botës. Ato jetojnë për një kohë të shkurtër, po jeta e tyre është kaq e madhe,

sa për secilën mund të shkruhet një roman. A mund të emrohen episodet dhe ngjarjet që kanë parë këto qyteza? Kuvendet e vajzave malësore, këngët, bisedat në rrugicat e ngushta, pritje para flamurit për të dëgjuar komunikimin se cila brigadë do të marrë flamurin? Jeta e Dranës, e Mrikës, e djemve të Elbasanit, e gjimnastëve, e kooperativistëve, universitarëve?.. Ne kemi shkruar për ta, po nuk kemi shkruar fare për jetën e këtyre qytezave, që do të zhduken e do të shfaqen vazhdimisht. Ato do të na ndjekin kështu këmba-këmbës, si vegime të bardha, stacione në stinat e jetës sot, për të shkuar më përpara.. më përpara.

\* \* \*

Atëhere binte dëborë, një dëborë me flokë të mëdha, që nuk kishte të sosur... Kjo ndodhë më 20 mars. Një skuadër ushtarësh, e udhëhequr nga komandanti i tyre, pat hipur në majë të malit Golisht në Malësi të Madhe dhe priste me sopatë trupat e mëdhenj të ahut. Era u fishkëllinte ndër veshë, dëbora u përplasej në fytyrë, duart u ngrinin, këmbët u ngrinin, po sëpata sokëllinte pa pushim duke qëlluar trungjet e forta. Ashklat fluturonin djathtas e majtas. Midis ashklave e flokëve të dëborës, lëvisnin sëpatat pa pushim. Me fishkëllimën e mprehtë e të hollë të erës, fluturonte e ngatëtrohej sokëllima e sëpatave. Pastaj binin njëri pas tjetrit trungjet. Rrapëllima e tyre i mbushte me gëzim ushtarët. Binte i pari, binte i njëzeti trung... Beteja ishte e lodhshme. Ajo mbaronte vonë. Ushtarët shikonin trungjet e shirira midis dë-

borës, i numëronin, fshinin djersën me kurriz të dorës dhe buzëqeshnin. Mirë. Fare mirë. Komandanti u rrihte krahët. Kishin korrur fitore. Pushonin ca. Pastaj nisin betejën e dytë. U shkurtonin krahët trungjeve. Pushonin përsëri vetëm pasi ngelnin trungjet të zhveshura. I mblidhnin degët dengje. Pushonin përsëri fare pak për të nisur betejën e tretë.

— Hajde, trima! A i zbrisim poshtë?

Dhe nisin e i zbrisnin poshtë. Për transpor timin e druve të djegjes kishin një taktkë më vete. Trungjet i zbrisnin me anë të kataraktit, që varet pranë xhadesë së hapur nga vullnetarët. Kata rakti ndahet në katër taraca. Nga njëri kat në tjetrin binin njëri pas tjetrit, deri sa transportohen në gjithë. Që andej mbaheshin në sup e çoheshin në lëndinë. Këtu fillonte të merrte jetë qy teza e vogël. Çoheshin kapanonet e thurura me degë ahu. Një kapanon, dy... Ndërtohej biblioteka, qendra e zërit, menca verore, guzhina...

Drutë harxhoheshin. Po ushtarët i ngjiteshin që me natë shpatit të malit, me nga një sopatë në krah. Bënte ftohtë. Këmbët rrëshqisnin nëpër gurët e quillur. U vriteshin brylet e u vriteshin duart ushtarëve, po ata mbas 4 km. rrugë arrinin pyllin dhe aty ushëtima përzihej me sokëllimën, ashklat me flokët e dëborës, djersa me lagështirën. Dhe dru të tjera zbrisnin nga kataraktet. Drutë e trasha, deri në 20-30 cm., mbaheshin pastaj mbi supe. Kështu, deri më datën 31 mars mbaroi prerja e gjithë lëndës që duhej. Gjithsej 2200 copë shtylla dhe  $165 \text{ m}^3$  trungje. Pra për 11 ditë mbaroi beteja në pyll. Dhe pesë ditë më vonë qy teza çoi kokën dhe pa fshatin e Selcës. Qy teza u bë gati e priste vull-

netarët që të fillonte jetën e saj të shkurtër, po të madhe . . .

— E patët vështirë? — e pyetëm një ushtar.

— E patëm vështirë, vëlla, po nga puna nuk hoqëm dorë. Ne duhej të ndërtonim qytezën, ku do të vinin të jetonin vullnetarët, për të ndërtuar rrugën. Qytezën duhej ta ndërtonim në një mënyrë që vullnetarët ta ndjenin veten sa më mirë. A e shikon tani? Qyteza gumëzhin. Këto janë qytezat më të bukura që ikam parë unë. Ç'rëndësi ka në u lodhëm apo nuk u lodhëm ne?

Jo, shok, ka rëndësi, se ti je qytetar i kësaj qyteze. Se ti je i fortë. Dhe qyteza duket kaq e bukur e kaq e gjëzuar se ka të rinj si ti e si shokët e tu. Ne nuk e kemi harruar. Ne e dimë ç'ju ndodhi kur prisnit trungjet në pyll. Ti nuk na the, po na tha tjetër kush. Tre shokë nga ju u sémurën. Kur erdhi komandanti i repartit e bisedoi me ju, asnjëri nuk u ankua. Po përgjegjësi juaj, ja tha komandantit dhe komandanti solli nga Shkodra mjekun. Asnjëri nga vullnetarët nuk shkoi te mjeku. A ka qenë kështu?

Ushtari tund kokën dhe shikon andej, nga faqja e malit Golisht. Nga faqja e malit bie me rrëmbim katarakti i shkumbëzuar. Aty, pranë kata-raktit, është hapur xhadeja që gjarpëron anës mësivit shkëmbor. Diku, ngulur mbi një gur, mezi shihet flamuri i kuq i brigadës. Pak më tej lëvizin siluetat e vullnetarëve.

— Që këndejej, mezi duken — thotë ushtari. — Mbas ca kohe do të shkojnë më përpara dhe nuk do të duken fare. Pastaj do të shkojnë aq tutje, sa kjo qytezë nuk do të duhet më.

— Do të ngrihet një qytezë tjetër . . .

— Edhe ajo do të jetë e përkohshme. Megjithatë, a do mundemi t'i harrojmë? Jo, kurrë! Secili vullnetar, që do t'i qëllojë të udhëtojë nëpër këto rrugë, do të tregojë me gisht qytezën ku jetoi për dy muaj.

Do të tregojë me gisht e do të thotë: «Shokë, ja qyteza ime, ja qyteza tjeter... Ja, këtu kemi qëndruar ne... Dhe qindra kujtime do të bulojnë si lule».

*Marrë nga «Zëri i Rinisë»  
8 maj 1968*

## ME VULLNETARET DHE MALESORET

Le të udhëtojmë drejt Veriut. Cemi kaltërosh gjarpëron midis malesh të thepisura; krahas tij gjarpëron rruga e Malësisë së Madhe. Lëmë mbas Tamarën, Selcën, ku është ngritur lapidari i Norës së Kelmendit.

Ecim, gjithnjë ecim, tamimë jo në rrugë ku mund të kalojnë makinat, po në copa rrugë të hapura nga vullnetarët.

Së fundi arrijmë në sektorin numër dy. Ai është ngritur pranë një burimi ujë-borë, që del nga mali si nga një tunel. Banorët e atyshëm kanë ardhur nga fshatrat e Vlorës, Beratit dhe Fierit.

Dua të tregoj për ndihmën që i kanë dhënë vullnetarët kooperativës bujqësore Lëpushë. Çdo ditë të diel vulnetarët shkojnë në Sudaç e Lëpushë, ku jepin programe artistike për kooperativistët dhe kufitarët.

Le të vazhdojmë pra udhëtimin tonë drejt Veriut. Arrijmë në lagjen Gropë të kooperativës Lëpushë. Në qendër të kësaj lagjeje po ndërtohet një stallë model për strehimin e lopëve të racës. E këtë punë po e kryejnë vullnetarët.

— Ne kemi përvojë në këto ndërtime, —thonë vullnetarët, — prandaj duhet t'u ndihmojmë.

Dhe ata, së bashku me kooperativistët, po japid një ndihmë të madhe në këtë stallë.

Gjatë udhëtimit tonë kalojmë përmes një pylli të dendur. Ndjekim anën e majtë të një degë të Cemit dhe ngjitemi në Qafën e Përdëlecit. Kjo qafë është një ndër vendet më të bukura të Kelmendit, që rrallë të zë syri kësaj ane.

Këtu 30 vullnetarët e sektorit të dytë po ngrënë një kantier të ri, kantierin Nr. 3. Me 1. qershor të këtij viti, ai do të fillojë jetën e vet. Mbi 1400 të rinj e të reja, që nga ky sektor do të vazhdojnë më tej drejt Vermoshit, të hapin rrugën e makinës.

Të tridhjetë vullnetarët janë shkëputur krejtësisht nga sektori i dytë dhe në Qafën e Përdëlecit bëjnë jetën e tyre. Ngjajnë si një togë ushtarresh të shkëputur nga një regjiment, të cilit i është ngarkuar të kryejë detyra të rëndësishme... Dhe 30 vullnetarët janë zotuar që kantierin e ri ta përfundojnë brenda këtij muaji.

Unë jam mësues i fshatit. Thua jse çdo mbasdite, e kaloj me ta. Këta 30 vullnetarë i drejton një i ri i palodhur dhe i shkathët. Të gjithë e dëgjojnë si komandantin e tyre.

Këtu është ende ftohtë. Vështirësitë janë të mëdha. Po dhe zotimi i vullnetarëve është i madh, ndaj mposhtet çdo vështirësi. Kantieri duhet të përfundojë patjetër.

— Ju lutemi, shoku komandant, ne jemi si një togë e nisur me shërbim, prandaj mos na kërkoni të punojmë me orar!

— Dhe me shërbim ka një regull.

— Rregullin e dimë, kufizim kohe në punë nuk duam.

Të rintjtë shkojnë e vijnë të ngarkuar me drurë për ndërtimin e këtij kantieri. Ata ndërtojnë shpejti dhe mirë, punojnë dhe ndërkohe dëgjohen brohoritje.

— Ç'është kjo brohoritje?

— Nga vjen kjo këngë? — pyet Aqifi.

— Pionerët e shkollës së Lëpushës po vijnë tek ne.

Turma e pionerëve gjithnjë afrohet. Ata vijnë te vullnetarët.

— Mirëmëngjes! — pëershëndesin.

— Mirë se ardhët, miq të vegjël!

— Erdhëm t'ju ndihmojmë! — thonë pionerët

Në krye të tyre qëndron një nxënës më i rritur. Ai as flet, as dëgjon, Megjithatë bën jetën si gjithë të tjerët në këto male. Në krye të shokëve ai ka ardhur të punojë vullnetar. Lëviz disa herë, jep disa shenja dhe të gjithë shpërndahen në punë.

Mua më thanë vullnetarët:

— Na fal, shoku mësues, a mund t'ju pyesim një gjë?

— Urdhëroni!

Ata deshën të dinin për lëvizjet që bënte një nxënës që nuk fliste e nuk dëgjonte. Unë u tregova për këtë malësor të vogël, për vullnetin e tij.

— Shkon mirë në mësime, bile në aritmëtikë e kam nxënësin më të mifë të shkollës — u them.

- Nä ç'klasë është?
- Nä të katërtën.
- Ne duhet të mësojmë shumë nga ai — thanë vullnetarët.

Puna vazhdon me hov revolucionar; pionierët po edukohen nga puna e vullnetarëve.

Atë ditë norma u tejkalua 150 përqind.

Për ndërtimin e kantierit ndihmojnë edhe kooperativistët. Kështu kryhet puna aty: vullnetarët ndihmojnë pér ndërtimin e stallave dhe fshatarët pér ngritjen qytezës së ardhshme.

Po të rintjtë vullnetarë kësaj ane i shohim dhe në aktivitete të tjera. Mbi 200 banorë të sektorit të dytë të rrugës së Malësisë së Madhe kanë dalë në Qafën e Përdilecit që të japid një program artistik pér kooperativistët. Para se të zhvillojnë aktivitetin ata u ulën rreth një lapidari, lapidarit të Ded Mark Gjerkajt, që u vra nga banda titiste me 17 korrik 1950.

Programi artistik i vullnetarëve përbante këngë dhe valle të krahinave të Jugut. Për banorët e Kelmendit ky ishte një program i ri me melodi e valle të reja. Aksionistët duartrokiteshin ngrohtësisht nga kooperativistët dhe kufitarët e Lëpushës.

Pastaj vallet u gërshetuan: vullnetarë, kufitarë, kooperativistë dhe pionierë kërcejnë së bashku valle popullore. Kështu zhvillohet jeta këndej, në punë dhe aktivitet të përbashkët.

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

*22 maj 1968*

## FLETË TË SHKËPUTURA

### 1. Fusha e «Djallit»

Ka një shesh malesh që quhet Fusha e Loes. Disa e quajnë dhe Fusha e Erës, se fryn shumë erë nga që ndodhet midis grykash. Nuk dihet se kush e emëroi edhe Fusha e «Djallit» dhe ndoshta këtë nofkë ja dha për ashpërsinë e saj: një vend midis malesh të egra me shtresë të gurtë, që nuk sheh veç tre dynymë qiel.

Aty përreth nuk ka banesa, por malësorët panë një ditë të vijnë vullnetarët dhe të ngulin mbi shpinë të Fushës së «Djallit» ndërtesat e veta të përkohshme. fjetoret, mencat... Këtë quajtën sektori numër dy i Selcës. Prej aty vullnetarët nisën dhe hapën rrugë. Rrugë malore.

E ky shesh ka veçantinë e vet. Duket si më origjinali i gjithë sektorëve, se është futur thellë në grykë mali, i lidhur vetëm me rrugë të vësh-tira, që kalojnë nëpër shkëmbinj.

Në këtë shesh vullnetarët kanë ngritur një farë lartësie me gurë dhe këtë e kanë quajtur «podium». Prej aty çdo herë jepen rezultatet e arritura në hapjen e rrugës.

— Shokë, brigada...

Përmenden emra brigadash. Aty nuk flitet më

për plotësim norme, por kush është ka tejkaluar më tepër, kush ka fituar më tepër pikë në organizimin e aktiviteteve.

## 2. Pista e vallëzimit

Po a mund të quhet ajo pistë vallëzimi? Një vend i shtruar me zall, i rethuar me dy breza paralele drurësh, që shërbejnë si stola për t'u ulur, i ngjan më tepër një vathe se sa një piste. Këtu brigadat e ndryshme organizojnë mbrëmje. E bëhet pastaj një kërcim i veçantë, i ndryshëm nga të tjerët, se është këcim i ashpër, që nuk përfill regullat teknike të elegancës në sallat e pistave, një këcim i çlirët, ku manifestohet bota e vrullshme e vullnetarëve të rivierës, të Myzeqesë apo të malësive të Jugut. Ata hedhin valle mbi shpinë të Fushës së «Djallit», ku pispilloja, duket e neveritshme. Hedhin valle sipas melodive të paregjistruara me nota muzikore, valle me ato roba të punës që mbajnë erë dinamit, të zhyera nga shkëmbinjtë, që i kanë rokollisur nga lartësitë e mëdha.

Në këtë vend vallëzimi, mbas pune, lodhja dhe mundi harohen...

— Shiko, moj vajzë, do ta mirrni veten në qafë, do të shembeni ndonjë ditë nga shkëmbi, se nuk i afrohet aq shumë buzës së rrugës ku punoni.

— Më fal, mos ke mbeturina?

— Unë?!

— Po, po ti. Do t'i them komandantit të vish në skuadrën tonë, se ke nevojë të edukohesh, aty në shkëmbin më të rrezikshëm. Në vend që të na përgëzosh!..

Fillon pastaj një vesë shiu. Po dhe në atë vesë shiu vullnetarët këcejnë mbi shpinë të Fushës së «Djallit».

Në shërbim të postërojes është një vajzë. Ajo ka imbetur e vetme me pushkën. Nga «pista» dëgjohet melodia dhe gazi i vullnetarëve.

### 3. Armiku: imperializmi, revizionizmi

— Shoku komandant, simbas urdhërit tuaj paraqitet...

Dhe përpara tij duket një vajzë, që nderon ushtarakisht.

— Nuk nderohet ashtu, prapsohu!

— Shoku komandant!...

Ai nuk është komandant ushtarak, as ka ndonjë funksion në brigadë, por është një vullnetar i thjeshtë, që ka ardhur për të hapur rrugë në malësi. Po duhet që vullnetarët të pregetiten dhe ushtarakisht. U thanë se ndonjë njeri të veçantë, që të merret kryesisht me drejtimin e punës ushtarake, nuk kishte, prandaj çdo gjë të përballohej me forcat e brigadës...

— Me lëje, shokë? Unë kam qenë në ushtri dhe sa po jam liruar, — tha njëri.

— Pastaj?

— Do t'u mësoj unë si përdoret pushka, si qëlllohet armiku...

— Dhe unë e kam kryer ushtrinë.

— Dhe unë...

— Hajde, pra, të mësojmë së bashku.

— Me leje, shoku komandant! — tha njëri.  
Të tjerët qeshën, po ama atij ushtarit të liruar i mbeti emri aty komandant dhe u caktua nga masa vullnetare komandant ushtarak i një brigade.

Dhe brigadat e tjera kanë komandantët e zgjedhur. Detyra e tyre është e rëndësishme sa është dhe ajo e komandantit të brigadës në organizimin e punës. Ai përgjigjet për preqatitjen ushtarake, në mënyrë që pranë qysqisë e varesë, këtu ndër male, mbi shpinën e Fushës së «Djallit», të qëndrojë dhe pushka.

Komandanti shpjegon:

— Armiku ndodhet...

Ata shpeshherë fjalën «armiku» e zëvendësojnë me «imperializmi», «revizionizmi».

Vullnetarët preqatiten në mënyrë të gjithashme për të mbrojtur atdheun dhe punën ndërtimitare.

#### 4. «Shkëmbi i Rrethit të Bardhë».

Kështu quhet ai, «Shkëmbi i Rrethit të Bardhë», se është i gjithë një brez, me kilometra i gjatë, në formë harku, që bie thik në bazën e vet, thua nga një lartësi 100 metrash. Poshtë tij është rruga këmbësore, një rrugë fort e ngushtë, ku dhe mushkë e ka të vështirë kalimin.

Po vullnetarët u ngjitën majë atij shkëmbi. Aty nuk ka rrugë, por po hapet rrugë. Këtu e një muaj më parë aty mendohej të punohej vetëm me makineri. Dhe urdhëri kështu ishte dhënë, po vullnetarët thanë:

— Do ta thyejmë ne.

Dhe u lidhën me litarë. Poshtë nga rruga këmbësore ata ngjajnë si silueta shqiponjash që godasin me sqep mbi shkëmbinj: një nga vullnetarët mban barominën, tjetri qëllon me forcë me vare. E pérplasura e varesë ndihet deri në breg të Cemit.

Një ditë aty erdhën dhe shokët e kinostudjos për të xhiruar pjesë të një dokumentari nga rruga e Malësisë të Madhe. Në këtë vend nuk ndihsj nevoja të pregetateshin skena e tablo. Aty kishte skena e tablo të gjalla të punës së vullnetarëve në këto vende. Operatori jep shenjën e fillimit të punës.

Një çast shkëmbi i madh shkëputet nga vendi. Kamera xhiron. Nuk pret koha që shkëmbi të zgresë deri në lumë, se ai thërmohet i téri në fund të Rrethit të Bardhë. Rrapëllima e tij shoqërohet nga brohoritje vullnetarësh.

Tëk i shoh këta vullnetarë, më kujtohet biseda e një plaku vermoshas.

— Nuk do të desha jetë ma tepër, veç sa me pa nji herë makinën dhe dritat elektrike në Vermosh.

— Më 16 tetor, xhaxho.

— A thue?

Shkëmbi i Rrethit të Bardhë është vëndi më i vështirë i punës; ndofta më i vështiri i gjithë turneve që kanë kaluar e do të kalojnë në këtë rrugë. Ai duhet gërmuar e ulur nga masa e vet deri në 20-30 metra. Rruga automobilistike do të gjarpërojë mbi kreshta.

Aty tanë punojnë vullnetarët.

## 5. Kur bie mbrëmja

Kur bie mbrëmja, malet hedhin hijen e vet mbi qytezën e sektorit të parë. E në këtë kohë ngrihen si një shpërthim këngët vullnetare.

Rrugës duken dritat e ndonjë makine të vonuar, që s'ka arritur ende deri në Selcë. Këngët vullnetare e mbysin zhurmën e makinës. Po dhe shfaqjet në sektor kanë karakteristikën e tyre vullnetare. Aty dallohen tipa të veçantë, që nuk para u bëhet vonë për rregulla të caktuara.

Eshtë një taracë e lartë. Mbi të zënë vend amatorët. Si perde shërben vetëm një batanije. Hiqet ajo dhe programi vazhdon.

Ka lindur dhe një këngë e re në këto male. Ajo u thur disa ditë mbas botimit të letrës së plenumit të Komitetit Qendror të BRPSH-së drejtuar Komitetit Qendror të PPSH-së dhe Këshillit të Ministrave të RPSH-së për mbarimin e rruge së Malësisë së Madhe më 16 tetor. Dhe kënga i uron mësonjësit të rinisë, në 60-vjetorin e ditëlindjes, jetë të gjatë sa malet ku sot ata vetë punojnë për hapjen e rruge.

Po e bukura ndër këto male është se vullnetarët shfaqjet e tyre i japid pa u ndrojtur. Njëra mbaron me këngën dhe thotë pa të keq:

— Kaq kisha unë — dhe largohet.

Pastaj në skenë del të këndoja një vajzë e gjatë. E kam parë dhe tjetër herë atë. Unë e kam

parë atë edhe në punë, edhe kur paraqiste forcën,  
edhe kur këndonte.

Mbrëmja kishte rënë në sektor. Shfaqja artis-  
like s'kishte të mbaruar.

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

*29 maj 1968.*

## RRUGË DHE DRITË NË MALESI

Makina lë Hanin e Hotit dhe merr në të djathtë. Kalon nëpër Kushe e kapet për shpatin e vargmaleve, për t'u ngjitur lart. Rruga është e shtruar, e sheshtë, e drejtë, kalon nëpër pejsazhetë ndryshme, përshkon përrrenj, gryka, çuka, gjarpëron e shkathët, e ngjitet, gjithnjë ngjitet. Kapet në luginën e Rapsh-Starës, ku blerimi i shumtë sikur i jep hije e freski edhe më shumë rrugës. Parritmas, në fund të fshatit, na shfaqet një humnerë e thellë, e errët, e lubishme! Rruga lëshohet tatëpjete brinjazi, duke çarë mes shkrepash, rrëshpeve, mes bloqesh të mëdhenj granitikë, e të sjellë ndër sy pejzazhet gjithnjë e më të ndryshme, gjithënë e më të buta. Ajo ashperësi e natyrës malore nis të ëmbëlsohet nga ngjyra e gjelbër, nga ngjyrat e ndryshme të luleve, nga ngjyra e kaltër e lumit Cem, megjithëse zhurma e këtij lumi të rrëmbyar shkumor, plot kërcime të hovshme, i ngjet më shumë turfullimës së një kafshe parahistorike. Leqet e Hotit! Dikur i kallnin tmerrin në zemër udhëtarit, kurse tanë, puna e rinisë sonë heroike ua prishi qetësinë e lashtë

këtyre maleve hijerëndë, i futi në qytetërimin socialist.

Tamarë. Unë e kam bërë para pesë vjetësh në këmbë këtë rrugë. Kurse sot, tok me shokët e mi aktorë, po ngjitemi këtyre maleve të japim shfaqje për malësorët e përvullnetarët, që janë shpërndarë këtu shpat me shpat. Ja Tamara! Një fshat me shtëpi të shpërndara shpateve. Tanë ja spitali, ja komiteti ekzekutiv, ja restoranti, dyqani i manifakturës, i sendeve ushqimore, këpucaria, rroba-qepësia, etj. Ndërtesat të reja. Tamara është bërë një qendër e këndshme e Kelmendit. Qendër me të ardhme.

Një komunist, aksionisti dyvjeçar, i cili është shpallur gjashtë herë sulmues në hapjen e rrugës së Malësisë, më thotë:

— Unë e dua këtë qendër të vogël, këtë qytet të vogël, e dua sepse në themel e tij ka pikla të vogla nga djersa e shokëve të mi, nga djersa ime. Ja, e shikon atje atë ndërtesën e re? Atje, përtej lumen Cem, është centrali. Shiko si shtrihet kanali me tuba! Atje, në thellësi të grykës, zbret në shtratin e lumen dhe merr ujët. Ky hidrocentral do të shpërndajë dritë. Nuk ka kënaqësi më të madhe, kur edhe vetë ke derdhur djersë për këtë dritë.

Përsëri bëjmë rrugë. Kalojmë asaj lugine të ashpër, të zhveshur, plot thepisje, të rrethuar në të dy anët nga vargmale shkëmbore. Makina uturin, e uturima më duket këngë e re, që përhapet gazmore për rrith. Malet e dëgjojnë ballëvrejtur e sikur mendojnë: «Hëm! Po ju mbush mendja këtyre, ehe, edhe ne na sheshojnë!» Ne vazhdojmë

rrugën drejt Selcës, ku në mbrëmje do të japim shfaqje.

\* \* \*

Porsa ka aguar. Buçitja e fortë e minave naziq. Dalim nga çadrat. Ai shpat me shkallëzime, ku është ndërtuar kampi, përnjëherësh zjen nga zërat rinore. Përmbi shtatëqind të rinj shkojnë për të larë fytyrën e për t'u bërë gati për punë.

Rrugën deri në sektorin e dytë do ta bëjmë në këmbë. Nisemi për në gropat e Selcës. Me ne është edhe komisari. Ka filluar puna. Rrugës ndeshim grupe të rinjsh që janë duke u përlleshur me natyrën e egër. Flamurët e kuq të kompanive kuqëlojnë gjithandej. Ky është front. Front i vërtetë pune. Një shkëmb ka prerë rrugën. Shkëmb? Jo, mal 200 m. i lartë. Vullnetarët duhet të luftojnë me guxim kundër këtij përbindshi. Janëngjitur mbi të të lidhur me litarë, dhjetë a pesëmbëdhjetë, e me qysqi e vare luftojnë kundër atij masivi të gurtë. Më tutje ka vetëm shkrepë. Këta rrokullisen pa i minuar. Ecim mbi rrugë të hapur. Këtu mund të eci fare mirë makina, por ende nuk është bërë lidhja. Që këtu duket sektori. Është fare në breg të Cemit. Kundruall tij derdhet nga mali, si katarakt, një nga burimet e tij. Ujët e tij të ngrin dhëmbët. Pak më tutje ka edhe borë. Ende nuk ka shkrirë dhe, me sa duket, as do të shkrijë! Vend i shëndetshëm. Por edhe më të shëndetshëm do ta bëjnë duart e kësaj rinie!

Takohemi me komandantin dhe me komisarin. Këtu punonin brigadat e Vlorës, Beratit dhe Fierit.

— Flamurin e garave nuk do ta lëshojmë nga duart, — thotë komisari, — nuk do ta lëshojmë, sepse nuk duan ta lëshojnë aksionistët, të kuptohemi, shokë.

Ai më dëftoi se këtu vullnetarët u solidarizuan njëzëri me vendimin e plenumit të KQ të BRPSH, për ta përfunduar me 16 tetor edhe rru-gën e Malësisë.

— Qe një solidarizim entuziazrt!

Dhe ja, ne po ngremë skenën në një shesh, ku ka përballë një anfiteatër natyror, ku mund të rrinë vullnetarët. Në këtë kohë komandanti i thérret rojes tek hyrja:

— Dili moj, dili para e merre për dore!

Vajza hutohet një çikë. Duket se në fillim nuk kupton. Një shami aksionisti kuqëlon larg, në kthesë të rrugës. Ajo turret andej. E shoh që i jep dorën atij që e mban këtë shami dhe drejtohet nga kampi. Unë vrejta komandantin disi i habitur. «Ç'është ai?» pyeta.

— Fuat Çela! — Por kur pa se unë ja ngula sytë i habitur edhe më shumë, shtoi: — Një shok i tij, që ndjek shembullin e tij.

Ai na u afrua. Ndër tiparet e tij shquhej ajo energji e madhe shpirtërore dhe mendore që ndryjnë në vete këta njerëz. Ishte rrëth të tridhjetave.

Unë kam tani parasysh dy fjalë të shkruara aty për aty nga dora e tij: «Lavdi Partisë». Tash për tash, këto dy fjalë dinte të shkruante ai. Më vonë do të mësonte patjetër.

Ishët nga Himara. Prej kohësh kërkonte të shkonte në një aksion.

— Nuk deshën të më dërgonin, more vesh, po

unë e pikasa. Vajta tek ata të rinisë. Mos u ngut, o Kiço më thanë, mos prish gjakun. U mblohd rinia. Unë vajta atje. Kështu, kështu, u them. Partia kërkon edhe nga unë punë, apo jo? Pse t'i pres të mirat ndenjur, pse nuk paskam sy? Nuk paskam sy, e mirë, kam këmbë, duar, kokë, gojë... Dhe ja, u nisëm nga Himara 21 vetë; në Vlorë, u bëmë 71, e kështu, si ai lumi që zbret duke grumbulluar përrënjtë, edhe ne u bëmë 700 vëllezër e motra dhe erdhëm të hapim rrugën këtu, në Malësinë tonë.

Ishë shumë e zorshme të punoje me të, se ai, si thoshin vullnetarët, «nuk të lë as të marrësh frymë!». I verbëri punonte me qysqi dhe varele.

Vullnetarët po ktheheshin duke kënduar. Po ktheheshin të nxirë nga dielli, të pluhurosur e të djersitur. Këndonin, përziheshin këngët e krahi-nave.

Ne do të jepnim shfaqje me kënaqësi të mëdhe për këta të rinj të mrekullueshëm, që kishin ardhur këtu, të hapnin rrugën, të punonin pa u lodhur për të çuar dritën e partisë thellë në Malësi.

*Marrë nga «Drita»  
2 qershor 1968*

## KËSHTU LINDI NJË LEGJENDË

Kështu u ngrit një legjendë. Dikur lugu i thellë shpërndau një ulurimë dhe dhjetëra male-sorë të lartë e të bëshëm u varën shkallëve të maleve, ndoqën rrjedhën e kaltër të një lumi e ranë në qytet. Pastaj u nisën përsëri dhe, duke ecur tragicave të ngushta, ndoqën njëri-tjetrin, që t'ua çonin atë pak misër atyre kasolleve të ftohta. Binin në shtrojen e gurtë, ndërsa era kafshonte kasollat e tyre, ndërsa bora mbyste tragat, ndërsa mala-zezët që tej kufirit kishin dalë tek Qafa e Shtrugës. Çoheshin atëhere ata dhe ngjiteshin nëpër atë mal. Se duhej pritur armiku, se duhej mbrojtur Qafa e Shtrugës. Kështu rridhte kjo legjendë, e hidhur, por trimëreshë.

Ndërsa male-sori ecte, ecte, ecte...

Nis vargmal i për në perëndim dhe një vargmal tjetër e pret për në veri. Një kërleshje e tërë malesh, që presin njëri-tjetrin. Dhe midis tyre një lug i thellë, përmes të cilit bën udhë një rrjedhë kristale. Nëpër gjoksin e maleve këputen katarak-tet, midis maleve rrjedhin rrëketë e gjelbëra të pishave të dendura, me këmbët të xhveshura; midis squetullave të maleve ende ruhet dëbora e bardhë

dhe përfund malit një ortek që vazhdimisht pikon, pikon.

Diku malet zbuten dhe aty shtrijnë një pjesë të gjymtyrës së tyre, që vjen e ngrë barin e plajës. Pikërisht aty ka mbirë një shtëpi e gurtë me çatinë e lartë e të pjerrtë të mbuluar me dërrasa nga drurët e malit. Qëllon që diku, tej pyllit të dendur, në të djathtë të një katarakti, i cili hedh ujin e shkumbëuar si një tufë «kuajsh të bardhë» shfagjet një copëz lëndinë. Aty pranvera e vonët ka mugulluar lulëzat e imta me kërcenjtë e hollë anës, pyllit të moçëm e të gjerë. Gjoksit të maleve, lugjeve, shpateve, shtigjeve, përmes korijeve dhe përbimi kuadratin e blertë të lëndinës kanë nisur e zgjaten fijet e kuqe të telave elektrike. Malësia do të montojë dritat e bardha.

Ulen vullnetarët e këpusin lulëza, pastaj, si një kurorë e shtrirë, e zbukuruar dhe e spërkatur nga veset e rrëkezave dhe bjeshkëve, vargu i gjatë i vullnetarëve dredhon përmes kthinave të blerta ku fshihen tragat e ngushta, përmes udhëzave të shtruar nga shtroja e gjetheve të rrëzuara. E vëren këtë pamje malësori dhe në çast gjoksi i tij ngre tallaz e ngazëllehet, ashtu siç ngre tallaz e ngazëllehet një pyll i madh, kur e frushullojnë erërat që shtyjnë grykat.

Eshtë i dyti vit ky që në grykat e Malësisë së Madhe punojnë vullnetarët. I kanë lënë Leqet e Hotit tashti, e kanë lënë edhe Tamarën. Vullnetarët janë ngjitur më tej. Ata të gjimnazeve të Durrësit, të Shijakut, të Rrogozhinës punojnë në sektorin e Selcës një, ata të Fierit, të Ballshit, studentët e shkencave të natyrës në sektorin e

Selcës dy, ndërsa në Bordolec punojnë nxënësit e gjimnazeve të Elbasanit, Peqinit, Cërrikut, Këta të rinj nuk kanë dalë për herë të parë si vullnetarë. Këta kanë punuar edhe vjet e parvjet. Edhe vjet e parvjet ata kanë dalë nga tre e katër herë sulmues. Vullnetarët e brigadave të Fierit duan që këtë vit patjetër të marrin flamurin e sekotrit. Po këtë kanë si pikësynim edhe brigadat e tjera. Andej gara midis brigadave është e ashpër. Kush do ta fitojë flamurin? Kush do të dalë katër herë sulmues?

Një brigadë e gjimnazistëve të Fierit punon tek brinja ndanë sektorit, atje ku prej shekujsh mali ka zbritur shtresa të tëra zhuri. Zhurma e kazmave dhe barominave vjen nga të gjitha drejtimet. Vjet Naili doli tre herë sulmues atje në Gradishtë. Po kështu edhe Vera e Gëzimi. Fronti i punës zgjatet e zgjatet. Kapercen shkëmbin dhe hidhesh tek punojnë studentët e shkencave të natyrës. Në frontin e tyre nuk ka zhur. Ai është një front i vështirë, ndoshta nga më të vështirët. Aty ngrihen drurë të lartë dhe gurë të mëdhenj. Gurë! Ata janë me dhjetëra, me qindra. Ata kanë zënë vend aty dhe të duket sikur ashtu për jetë nuk do të lëvizin nga rrënja. Aty ka shumë gurë dhe njerëzit e atyre anëve i quajnë «bloqe gurësh», ndërsa në një vend tjetër diku, në Shqipërinë e Mesme apo në jugë të vendit, çdo njeri nga këta gurë do të konsiderohej si një shpellë më vete dhe secilit gur mund t'i thërrisin me emrin «Shpella x» ose «Shpella y». Por atje ku një vend i tërë ngrë gjer lart male, male të pafund gurësh të këtij lloji,

të cilët i kanë shpatullat pranë njëri-tjetrit, i quajnë «bloqe gurësh».

A do t'i vendosin, vallë, këta gurë? A do t'ik rrrukullisin poshtë?

Dhe nis puna qysh herët në mëngjez. Qysh herët në mëngjes, Ilirjana, e vëtmja vajzë në skuadrën e saj, nis e gërmon rrreth një guri të tillë. Gurit i zbulohen rrënjet, pastaj mblidhen tërë vullnetarët, ose katër, pesë a gjashtë prej tyre dhe ashtu, me gjunjë të pështetur fort pas tokës, e shtyjnë. Ai varguia i tërë gurësh merr rrukullimën tatëpjetë, ndërsa mali pret e përcjell gjëmimet e ulurimës së tyre! Kështu u ndodh shumë herë vullnetarëve të atyre anëve. I mihin rrënjet një shkëmbi, pastaj mundohen ta shtyjnë. Por ai s'tundet. E shtyjnë përsëri. Përsëri ai s'tundet. Vjen atëhere Kastrioti dhe ai komandanti i sektorit. Hyjnë edhe ata në atë valle. E shtyjnë, e shtyjnë, por shkëmbi, shkëmb. Fusin nën të baromina, drurë të gjatë e të fortë, por shkëmbi s'luan që s'luan.

Ngrihet atëhere ai komandanti dhe u thotë studentëve:

— Lëreni! Atij ja gjen anën dinamiti. Lëreni se do të pësojmë ndonjë aksident!

Kastrioti dhe komandanti ndjekin rrugën përmë tej në drejtim të kompanive të tjera, ndërsa ata, studentët e kompanisë së parë të brigadës XVI, ndalin një hop.

— Si s'rrëzohet?! — tha Bashkimi.

— Rrëzohet!

— Futi qysqinë, Lirim!

Dhe përsëri i turren shkëmbit, pesë, gjashtë, dhjetë, e tërë kompania.

Pas ca, shkëmbi lëshon një si rënkim dhe merr tatëpjetën.

Të njëjtën punë bëjnë edhe ata të kompanisë së dytë të po kësaj brigade. E kështu vazhdon ky varg i gjatë vullnetarësh gjer tej, e kështu ngrihet ky hov i madh pune tek të gjithë. Zbret dreka dhe vullnetarët kthehen duke shkelur nëpër rrugën që ata kanë çelur atë ditë apo një ditë më parë. Freskohen anës burimeve të ftohta, mandej shtrohen e bëjnë drekën nëpër ato tavolina e stola të thurura me thuprat e pyllit, që fëshfërin tej tek faqja e malit.

— Pse më shikon me sy skeptik ajo shoqja?

— Kush?

— Ajo që ndan supën.

Nëpër buzët e shoqes që ndante racionin e supës në kompaninë XIV, tek tavolina e kreut, regëtinte një buzëqeshje e këndshme. Vullnetarët përtypen, ndërsa shtigjet e thella të maleve sjellin krismat e njëpasnjëshme të minave; ata përtypen duke sjellë nëpër mend rrugën e çelur, shkëmbinj-të, «bloket e gurëve», që përmes atyre shpërthimeve copëtohen e thërrohen. Befas dielli djeg aq shumë sa ai gjirokastriti pëshpërit, duke ngjeshur mirë shapkën në krye:

— Djeg, do të kemi përsëri shi.

Vullnetarët janë shtrirë dhe ose lexojnë, ose qepin diçka, ose dremisin, kur, papritur, mbi kapannon ka buisur një re e zezë, grykave rrëshqasin lulkat e rrufeve dhe pas pak nis e roit shiu. që pastaj merr vrull e bashkë me erën, rrëh kapanonet

e vullnetarëve, të cilët atëkohë ose lexojnë, ose qepin diçka, ose dremisin... Avitet dikush dhe thotë se në sektorin e tyre, d.m.th. ne sektorin e dytë, në pesëditorin e parë realizimi ka arritur në 105 apo 106 përqind. Ngrihen kapanonet dhe secila brigadë interesohet për realizimin e saj, secila kompani për punën që ka bërë në pesë ditët e para. Ndërsa vullnetarët e sektorit të parë kanë mbrijtur më vonë dhe atje ende s'kanë dalë përqindjet e realizimit të pesëditorit të parë, se ende s'janë mbushur pesë ditë pune. Ky sektor është një sektor interesant, një qytezë interesante, doja të thoshja. Mbështetet për hir të vendit ku ka ngritur kapanonet dhe mencën, kjo qytezë sikur shpalos më tepër «qytetërim». Aty ka edhe fushë volejboll, edhe një lloj hekuri për ushtrime, ambulancë, fushë ping-pongu, dyqan, megafona, roje vullnetarësh me pushkë (natyrisht këto gjenden edhe në sektorët e tjerë), një kuti poste mbërrthyer tek trungu i një druri, një infermiere, një mjeke.

Bie mbrëmja dhe ndizen Llampat elektrike. Vullnetarët ulen të shohin filmin «Skënderbeu».

— Malet shqiptare shohin fytyrën e tyre — thotë dikush.

— Po, këtu i kanë të dy fytyrat — ja pret një tjetër.

Kështu bisedojnë vullnetarët; ndërsa ai ushtaraku i imtë, ai djali i mirë e shembullor, të cilin e quajnë Çerçiz dhe është nga Kuçi i Vlorës, diç u tregon disa vullnetarëve për atë mushkën e ngarkuar me misër, që para ca ditësh u këput nga një udhë e ngushtë atje tek ura dhe këceu

në bujan, ndërsa komandanti pi duhan dhe ndoshta mendon për sigurimin e vullnetarëve nga minat. Natës tjetër, atje tek «skena» e fushës së volejbolit, vullnetarët e brigadës «Naim Frashëri» dhanë shfaqje. Kështu do të veprojnë paskëtaj edhe brigadat e tjera.

\* \* \*

Kështu u ngjall një legjendë e re. Dikur tej malësive të Kelmendit u shpërnda një thirrje që përcolli zërin se atyre anëve brezi i ri i Shqipërisë do të çelë rrugë makinash, se atyre anëve do të vërshojë drita elektrike. Zbret tashti malësori në Selcë dhe hipën në maqinë e maqina vrapon përmes xhadesë së çelur nga vullnetarët, nëpër Tamarë, ngjitet përmes legjendës së lashtë të Leqeve të Hotit e del në Rapsh, ndërsa ujërat e kristalta anës rrugës duket sikur fiksojnë në kamerën e tyre transparente buzëqeshjen e re të malësorit që vrapon nëpër makina, legjendën e re që u ngrit atyre anëve.

*Marrë nga «Zëri i rinisë»  
12 qershor 1968*

Qysqia në duart e rinisë çau me dhjetra metra kub gurë.



## **DREJT MAJAVE TË VERMOSHIT**

Dielli, që fshihet diku prapa maleve, hedh rrezet e tij në majat e egra të maleve, kurse në luginat e thella duket vetëm zbardhëllimi. Kreshtat e maleve, diku shkëmbore e diku të veshura me ahe e lisa të gjatë duken si bedenat e një kështjelle mesjetare. Nga sqetullat e maleve të larta dalin aty-këtu burile të akullta. Poshtë rrjedh Cemi.

Ijeve të tyre kalon dredhushë rruga e re, vepra e rinisë sonë heroike. Mahnitet njeriu, që vjen këtu, në këto vende të ashpra dhe të këndshme të natyrës!

### **«Fusha e lojnave»**

Kështu e quanin malësorët atë. Fushë ku lozin erërat. Ajo është një fushë në formë rombi, ku ndodhen ndërtesat e sektorit Nr. 2. Kapanonet paralele, kuzhina, çadrat e shtabit, fushat e lojrave sportive, ja kanë prishur qetësinë kësaj fushe

nitë, skuadrat, individët sulmues. Këtu zhvillohen aktivitetet kulturale sportive, këtu ka jetë. Sipër, si roje vigane, qëndrojnë malet, që me shtresat e tyre shkëmbore, të petëzuara, të japin pamjen e një amfiteatri vigan.

Një zë flet. Papritur dëgjohet një urra e fortë. Për këtë 5-ditor brigada XIV merr flamurin.

— Ne do ta mbajmë deri në fund të aksionit, flet një vajzë e qeshur.

— Dale, moj ti — i përgjigjet dikush — po ne për çfarë jemi?

— Edhe ju punoni, por nuk është vetëm puna ajo që përcakton fitonjësin e flamurit. Brigada jonë është e dalluar, është...

— Do të shikojmë pesëditorin tjetër kush do ta marrë — përgjigjet tjetri.

Bisedat vazhdojnë diku të qeta, diku të shpejta e të forta. Bile disa fillojnë të grindeshin. Biseda pune, biseda vullnetarësh, ato ndërpritën nga zëri i komisarit të sektorit.

— Flamurin e sektorëve të rrugës së Malësisë së Madhe, në bazë të të gjitha pikave të grumbulluara... — Ai numëroi një pér një pikat. Vullnetarët rrinin në heshtje. Dikush lëvizte, ndërsa shoku që kishte afër ja bënte me shenjë që të mos bënte zhurmë. Komisari shqiptoi me zë të lartë:

— Flamurin e mori sektori ynë.

Një urra e fortë shpërtheu në rreshtat e vullnetarëve. Duartrokitjet nuk pushonin. Vullnetarët duartrokisnin punën dhe aktivitetin e tyre. Në duart e tyre tërë kallo kjo duartrokite bëhej

më e fortë, më e bukur. Sy të qeshur që gëzo-nin për frutet e fitores!

### Me vullnetarët në trase

Vazhdoj rrugën nëpër trase. Sapo kalon sek-torin, rruga ndërpritet. Në mes të dy anëve të saj kalon Cemi. Këtu do të ngrihet ura. Këtu punojnë vullnetarët e Fierit. Terreni është shumë i vështirë. Një shkëmb i petëzuar binte thik mbi lumë. Minat kishin hapur disa metro vend, ku mund të punonin të rinjtë. Dikush me barominë hapte një vrimë në shkëmbin e egër, cisa të tjerë hidhnin gurë të mëdhenj në lunë, gjithse-cili ishte në lëvizje. Ndonëse disa ditë më parë i kishin kritikuar se në punën e tyre kishte pasur pengesa në drejtim të organizimit tani kjo bri-gadë ishte pretendente për flamurin.

— Ne nuk mund ta marrim flamurin vetëm për punë — thoshte një vajzë fierake — sepse kuptohet, universitarët janë më të rritur, por ne do ta marrim për aktivitete të tjera, për rregull dhe zbatim regjimi.

— Jo, puna nuk është tek flamuri — ja pret një djalë. — Ne do të ndërtojmë rrugën. Kjo ka rëndësi.

— E, po pse, në fund do të mbetemi ne? Jo, more, s'është punë që bëhet kjo. Rrugën do ta ndërtojmë dhe flamurin do ta marrim.

Ata punonin me të gjitha forcat. Dhe rruga dalngadalë po ja zinte vendin shkëmbit. Të dy anët e saj po bashkoheshin.

Më tutje ndeshemi me pararojën e sektorit, brigadën XV. Ajo ishte brigada e flamurit. Ishte me të vërtetë e tillë. Tek kthesa takohemi me Agimin, Emlihan, Sokratin, Remziun, Elenin, Suzanën, etj. Janë nga ata që këtu i quanin «sulmues në kator». Dy norma në punë, dy norma më mencë tek usta Bajrami — kështu tha Emlihaja duke qeshur. Me ta ishte dhe «autoboti». Cili është «autoboti»? — pyeta.

Ishte fjala për Elenin që u i sillte ujë, dhe ata e quanin herë «autobot» herë «ujësjellës». Punonin dhe qeshnin. Traseja në atë vend ishte në të mbaruar. Më tutje vazhdonte punën po kjo brigadë. Ata punonin gjatë trasesë dhe nga larg dukeshin si një kolonë partizane në marshim.

Dhe ata po marshonin drejt majave të Vermoshit, që rruga të shkojë sa më shpejt. Ata ishin të gjithë punëtorë të gjallë, brigadë e dalluar, e palodhur.

— Një, dy, tre — hop dhe guri rrrokullisej me shpejtësi, duke marrë me vete dhe gurë të tjerë e duke i përplasur në lumë. — Jepi, Guri, se nambeti guri! — Të rintjtë qeshnin.

Është fjala për skuadrën e Gurit. Skuadër dy herë sulmuese. Para disa ditësh punonin tek shkëmbi i kuq. Ishte një shkëmb shumë i madh, në brinjët e të cilët do të kalonte rruga. Teknikët nuk i lejonin të punonin aty, sepse kishte rrezik. Por guximi e mposhtë vështirësinë. Ata punuan në atë front, e hapën rrugën. Tani fronti i tyre i ri nuk u dukej i vështirë.

— Zaten, ky Guri gurë don — qeshin shokët e skuadrës.

Në këtë skuadër bënин pjesë 9 veta. Dua t'ua them të gjithëve emrin, sepse secili nga ata ishte një «antiminë», «buldozer në malësi». Guri, Xhe-lili, Josifi, Bukuroshja, Razija, Thomaqi, Vl-adimiri, Ylli, Anasyasi. Tani ata janë zotuar në heshtje pér ta marrë përsëri flamurin. Në një skuadër të tillë si ajo e Gurit, nuk ka sukses që të mos buzëqeshë. Të gjithë punonin me hov-të lartë revolucionar, pér një qëllim: të shpien rru-gën sa më shpejt, duke qenë flamurtarë.

### Inisiativa

Më 15 korrik, makina e parë do të shkelë në sektorin Nr. 3. Kjo ishte inisiativa që morën vull-natarët e sektorit Nr. 2 në përgjigje të fjalës së shokut Enver në Gradishtë. Kjo inisiativë ishte aq e guximshme, sa dhe vetë rinia. Ajo lindi si vegim në zemrat rinore, si rezultat i entuziazmit dhe dëshirës pér ta parë të realizuar veprën e tyre.

Kjo inisiativë e madhe lindi dhjetëra të vogla. Çdonjëri i dha fjalën vetes, të gjithë partisë. Forca të reja, entuziazëm i ri, kilometra të reja. Dhe male-ve kryelarta, sikur u hyri frika nga buçitja e minave, nga përshëndetja e këngës aksioniste. Duket sikur dhe shkëmbinjtë u bënë të butë. Jo, ata s'janë zbutur. Vetëm forca e të rinxve ka ndryshuar. Ajo është dyfishuar, është bërë si një vullkan që shpërthen e me forcën e tij hap rrugë të re, dritë të re.

Makina do të shkojë në qafën e Bordolecit. Malësorit kjo i duket si një ëndërr.

— Na, me thanë të drejtën, nuk na e priste mendja, që të hapej rrugë në malësi. Por forca e rinisë kenka e madhe — e xha Kola tregonte për të rintjtë vullnetarë që përlesheshin me shkëmbin, fliste për partinë që po i ndrit këto vende. — Dy rrugë, dy mendime. Rruga e vjetër e malësorëve, ku dhe mushka kishite frikë të kalonte — rruga e re e rinisë, ku dhe makina kalon me shpejtësi.

Rrugë dhe dritë — dy dhurata. Jetë e re! Në dritaret e malësorëve do të hyjnë rrezet e kuqe të dritës së partisë!

Prandaj i shikon të rintjtë që punojnë me hov të paparë. Gurët fluturojnë nga shkëmbi, traseja zgjatet, të rintjtë gëzojnë, malësorit i thyen konceptet e vjetra.

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

17 korrik 1968

**«MËSIMET E PARTISË DHE TUAJAT, SHOKU  
ENVER, DO TË NA PRIJNË KURDOHERË NË  
JETË SI FLAMUR»**

**SHOKUT ENVER HOXHA  
Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të PPSH  
Tiranë**

I dashur shoku Enver!

Ne, 2 mijë vullnetarët e rinj të turnit V, nxënës dhe studentë, ndërtonjës të rrugës së Ma-lësisë së Madhe, ju shprehim Juve dhe Partisë nënë mirënjojen e thellë për kujdesin atëror që tregoni, për jetën tonë të përditshme, edukimin dhe kalitjen revolucionare, për perspektivën e qartë dhe të sigurtë që Partia dhe Ju i kanë çelur rinishë sonë.

Ne, shoku Enver, studjuam me vëmendje të thellë fjalën tuaj, mbajtur përpara vullnetarëve të hekurudhës Rrogozhinë-Fier. Përshëndetjet që na dërguat në emër të KQ të Partisë, porositë dhe këshillat tuaja, ngritën peshë zemrat tona. Ju nuk ndodheshit midis nesh, por megjithatë ne ju ndjenim

pranë, ne dëgjonim zërin tuaj, ndjenim vështrimin tuaj.

Mësimet, këshillat dha fjalët tuaja të afërta për zemrat tonë, na shtytën t'ju shkruajmë këtë letër, nëpërmjet së cilës duam t'ju sigurojmë edhe një herë se ne, vullnetarët ndërtonjës të rrugës së Malësisë së Madhe, si gjithë rinia e vendit tonë, do të jemi pérherë ushtarë besnikë e të devotshëm të Partisë e të revolucionit.

Mësimet e Partisë e Tuajt, shoku Enver, do të na prijnë kurdoherë në jetë si flamur. Ne do t'i studjojmë e do t'i zbatojmë ato me guxim e vendosmëri, duke kapërcyer çdo vështirësi, duke bërë një luftë të pamëshirshme kundër çdo mbeturine të së kaluarës dhe kundër gjithë tentativave të armiqve imperialistë e revizionistë, që e kanë halë në sy Republikën tonë.

Puna në aksion na mbush me gjëzim e krenari. Vështirësitë nuk na trembin. Rruga kalon përmes shkëmbinjve e ndonjëherë na është dashur të zgresim me litar, nëpër faqet e thepisura, për t'i copëtuar. Drunjët shekullorë kanë hedhur rrënje të thella e na është dashur t'i shkulim ato për të hapur trasenë. Qershori ka qenë muaj i ftrojtë e me shira, por as shkëmbinjtë as rrënjet, as shirat nuk na ndalën dot. Ju njoftojmë me gjëzim se i kaluam gjithë vështirësitë, e tejkaluam planin, dhe traseja e rrugës po i afrohet përditë e më tepër Vermoshit.

Puna dhejeta në kolektiv shërbën përritjen dhe kalitjen tonë revolucionare, ajo ne na pajis me vëtitë e larta të moralit komunist, me ndjenjën e mrekullueshme të dashurisë përkolektivin dhe për

shokun, të miqësisë së pastër, të thellë e të sinqertë, na mbush me guxim e forcë për të kaluar çdo vë-shtirësi, rrënjos tek ne koncepte të drejta për punën dhe njerëzit.

Ne jetojmë tanë bjeshkëve të larta, ku ndeshen pranë e pranë shkrepët e egër dhe livadhe të ble-ruara alpine me një bukurji mahnitëse, male të larta me majë shkëmbore dhe shpate të veshura me pyje, ku burime të ftohta e të kulluara zbresin rrëmbyeshëm nëpër katarakte shkumbëbardha. Ne sot disim me ëndje bukurinë e ashpër të maleve, syri na gëzohet e zemra na rreh plot dashuri për vendin e lindjes. Por ne s'jemi vetëm soditës të natyrës. Ndjehem krenarë se kemi ardhur këtu si ndërtues të së resë. Të frymëzuar nga mësimet e Partisë ne japim kontributin tonë për transformimin e natyrës dhe thellimin e revolucionit në këtë anë.

Jemi njojur e miqësuar me malësorët trima e bujarë, punëtorë e kufitarë sypatrembur, bijtë dhe nipat e Dedë Gjo Lulit dhe të Norës sokoleshë, jemi njojur me traditat e tyre luftarake e patriotike dhe kemi mësuar shumë prej tyre.

Në ndryshimet e mëdha që vërejmë në jetën dhe mendimet e tyre, në luftën që ata bëjnë kundër zakoneve të mbrapshta, trashëguar nga shekujt, ne shohim si kudo fuqinë jstëdhënëse të ideve të Partisë, hovin e pandalshëm të revolucionit.

Do të tregojmë, shoku Enver, për një plak nga Vermoshi. Ai është 90 vjeç. I thanë vjet se partia ka vendosur të çelë rrugë përmes maleve. «Jo, tha ai, asht punë që s'bahet, nuk çahen shkrëpat». I thanë pastaj se rruga arriti deri në Tamarë e Selcë. Dhe ai prapë nuk besoi. Sivjet u ngjit gjer në

Qafë të Bordolecit. Kur shkeli vetë mbi trase, ai tha: «Hallall! Kjo Parti e kjo rini përbysë malet». Po, shoku Enver, nën udhëheqjen e Partisë e Tuajën, ne jemi në gjendje të përbysim edhe malet.

Bashkë me malësorët ne punojmë edhe përzbatimin e vendimit të Partisë që çdo fshat i Kelmendit të marrë dritë elekrike brenda këtij viti. Këto dy dhurata të mëdha të Partisë — rruga dhe drita elektrike, — kanë çuar peshë zemrat e malësorëve, i kanë hedhur të gjithë ata në aksione revolucionare për forcimin e ekonomive kolektive dhe përparimin e fshatit.

I dashur shoku Enver.

Tek mësimet e Partisë dhe Tuajat ne shohim qartë perspektivën e ndritur e madhështore të vendit tonë. Ato janë një burim frymëzimi dhe optimizmi revolpcionar. Me një ndjenjë besimi dhe optimizmi të thellë, ne ju sigurojmë Juve, Partinë dhe gjithë popullin, se aksionin tonë do ta kryejmë me sukses. Më 16 tetor të këtij viti, makinat do të përshkojnë luginën e bukur të Vermoshit të largët e do të sjellin këtu të kthjelët e të fuqishëm këngën e një fitoreje të re revolucionare.

*Të rinjtë dhe të rejet  
vullnetare në rrugën e Malësisë  
së Madhe*

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

*24 korrik 1968*



№ë koién e lirë vullnetarët studjojnë materialet e Partisë

## **«PUNË TË MADHE KA BA PARTIA»**

Shoferi me shkathtësi merr kthesat e pjerrëta të Leqeve të Hotit.

Në maqinë me ne udhëton një burrë i moshuar dhe një grua me fëmijët e saj, që shkon në fshatin e lindjes, në Zagorë. Ajo ka dy vjet pa shkuar atje dhe për rrugën vetëm sa ka dëgjuar... Habia e saj, e përzier me gëzimin e malësores së çliruar nga zakonet dhe mundimet e jetës, nuk është diçka e papritur për ne. Kushdo që ka zbritur në Leqe, malësor apo vizitor qoftë, është habitur për rrugën e hapur në rrëpirën e madhe.

— Rrugë në këto anë?... Këtë s'e besojsha kurrë. Edhe tash, që e shoh me sytë e mi, sikur s'më besohet. — Dhe tek shkiste makina tërthorave ajo hem e trembur, hem duke qeshur, u thoshte dy fëmijve të vet:

— Nikollë, Pjetër mos shikoni andej poshtë. Po ju merren mentë. Mbahuni pas meje se mos bini.

— Dhe shtërgonte në gji fëmijën e vogël, që pinte i qetë.

— Punë të madhe ka ba partia! — tha burri i

moshuar. Punë të madhe shumë... I thonë Parti e Punës kësaj, — vazhdoi. — Dhe punë të madhe po ban. Kjo parti u ka vu drunin dembelave dhe anmiqve tanë...

«Punë të madhe ka ba partia!» kështu më tha dhe një plak flokëbardhë në Bodaç, tek kalonte shkëmbinjve me kalin ngarkuar.

«Më shtohetjeta dhetrita e syvet kur shoh rininë tue punue. Një dorë e humba në luftë me malazezëtë, por tashti më ngjan se kam katër krahë, katër duer, o bir...».

«Punë të madhe ka ba partia!» kështu më tha dhe axhë Gjetja, kooperativisti i moshuar nga Vermoshi. Kështu thonë gjithë malësorët e Vermoshit, kur flasin për rrugën e Malësisë së Madhe.

Kjo rrugë, që hyn thellë në lugjet e maleve, është vazhdimi i historisë shqiptare, është historia e sotme, e këtyre viseve të përtërrira, është vepra e pavdekshme e rinisë e gdhendur në shkëmbinjtë e kohërave.

Mbi të do të hedhë hapin i sigurt malësori do të marshojë socializmi, kultura. Dhe fijet elektrike do të ngjiten krah saj, mbi ahët, mbi shkrepat.

Drita e madhe e partisë do të vërshojë përmes kësaj rruge si ujërat në brigjet e një lumi të madh. Vullnetarë të rinj do të marshojnë në të.

## Duke ecur midis brigadave

Në sektorin e Lëpushës punojnë vullnetarët e Vlorës, Himarës, Selenicës, Beratit, Qytetit-Stalin dhe Patosit. Të gjithë e kemi të qartë në hartë pozicionin gjeografik të këtyre qyteteve. Po këtu gjeografia e qyteteve ndryshon. Qyteti Stalin është fqi me Himarën, Selenica me Beratin, Patosi me Vlorën. Kështu lindin në aksion miqësitë e rëja të qyteteve, miqësitë e vullnetarëve. Ja, këto trungjet këtu i kanë rrëzuar ata të «Ali Demit», tek ky dheu i kuq ka punuar «22 Tetori» i Beratit... E shihni këtë rrugë, këto njëqind metra të shtruara bukur me çakell? Këtu kanë punuar djemtë e «8 Nëntorit» të Qytetit-Stalin. Kanë hapur birat në shkëmb, ku mezi hynte baromina. Më tej punojnë ata të «Halim Xhelos» aty ku është një shkëmb i lartë si mur, që bie thikë mbi përrua. Atje duhet të kalojë rruga.

Ndaj vullnetarët lidhen edhe me litar kur është puna të hapin bira për minat, të rrëzojnë ndonjë trung apo të shtyjnë ndonjë shkëmb.

Cilët janë këta, si quhen? Vullnetarë! Ky është emri më i njobur dhe më i dashur për secilin Njeriu mund të radhisë qindra emra prej tyre, mund të shënojë mbresa dhe dialogje të shumta gjatë çdo metri rrugë që hapet.

— Hajde, Mira, dil andej, se mos vraşësh këmbën! Më kujdes vajzë, më kujdes.

— Kujtim, mos i dil andej shkëmbit! Ashtu!

— Dale, xha Vangjel, ma jep mua kazmën ta shtyj shkëmbin nga lart!

Janë vullnetarët e brigadës «Hajredin Begari» të Selenicës, që punojnë në fund, përtej Bodaçit. Janë punëtorë të dalluar ata. Midis tyre ju mund të shihni edhe një burrë të moshuar, xha Vangjelin, që tani e njohin të gjithë në aksion. E njoha edhe unë atë ditë: i gjallë dhe i palodhur, i dashur me vullnetarët dhe mësuesit, ai ka fituar respektin e të gjithëve. Kur u nisën shokët e djalit të tij për në aksion, xha Vangjeli u dolli përpara: «Daleni, bijtë e mi, do të vij edhe unë». Dhe xha Vangjeli u nis në aksion ta bëjë atje pesëmbëdhjetëditéshin e lejes. Por ja që kaq ditë janë pak. Nuk mjaftojnë. Detyra e thërret përséri atje në Selenicë. Nesër do të ikë. Ndaj sot nuk ndjehet i qetë. Shkon nga njeri vend në tjetrin dhe bisedon me shokët e djalit si një baba i dhembshur.

— Janë djem punëtorë këta, — thotë, — s'më bëhet të ndahem prej tyre. U flas nganjëherë përtë mirën e tyre... Dhe fjalën s'ma kanë prishur asnjëherë.

Xha Vangjeli rri midis tyre gjithmonë. Tani, në pushim, e dëgjoi me vëmendje letrën që shokët e turnit të parë i dërgonin shokut Enver.

— Si thoni, djema, do ta mbarojmë para afatit, apo jo?

— Posi, xha Vangjel, edhe më shpejt nga ç'mendojnë ata.

— Shokë, kur vullnetarët e turnit të parë shkruan këtë letër, u mbështetën edhe në punën që do të kryejmë ne, — thotë Asqeriu, sekretari i organizatës.

— Besimin e tyre ne do ta justifikojmë me punë, thonë të rintjtë.

Dhe do ta tejkalojmë parashikimin e tyre.

Ra nata, një natë e freskët korriku. Vullnetarët organizojnë një mbrëmje me rastin e ikjes së xha Vangjelit...

Tani ajo vajza vlonjate do të këndojojë këngën e saj të dashur «Erdh Enveri kah malësia»; ai djali i shkathët, flokëzi, do të tregojë një kruozitet, një ngjarje, do të pyesë për një datë; ajo letrarja e re nga Qytetit Stalin do të recitojë një vjershë për partinë, për atdheun.

Dhe vullnetari më i vogël nga Babica, Agimi, do të vallëzojë dorë përdorë me xha Vangjelin...

### Krismat vërshojnë nëpër gryka

Teknikët dhe ata që punuan më parë tek shkëmbi i keq, thanë se ky shkëmb mund të hapet vetëm për dy-tri javë.

Por ja që u hap shumë më shpejt: në dy-tri ditë, ose më saktë: në dy ditë e gjysëm... Dyzet vullnetarë dhe ushtarë punuan me vetëmohim tek shkëmbi i rrezikshëm, duke kryer një volum pune prej  $244\text{m}^3$ . Në këtë shkëmb, me gjatësi 35 m., mund të shikosh të grumbulluar tërë shpirtin luftarak të rinisë sonë: thjeshtësinë, madhështinë, forcën dhe pjekurinë e madhe të saj. Njeriu që ka punuar aty, qoftë dhe disa çaste, s'mund të harrojë vullnetarët e brigadës «Muhamet Shehu» të Patosit dhe grupin e ushtarëve që punuan atje. S'mund të harrojë Vladimirin, Nduen, Perikliun, Lirinë,

Florën dhe shokët e tjerë. S'mund të harrojë ushtarë Esatin, Fiqiriu, Vilajetin dhe midis tyre komandantin Ndue, njeriun e dashur dhe punëtor, vigan nga trupi, të ashpër ndaj të metave, por të ngrohtë në bisedë midis ushtarëve dhe vullnetarëve e përherë më të afërt. Këto tridhjetë e pesë metra rrugë në shkëmb u bënë një galeri e madhe portretesh, karakteresh... Këto tri ditë sulmi — një shkollë e tërë.

\* \* \*

Shkëmbi i Keq, rasa-rasa, sikur qëndronte para nesh vetëm për të na penguar. Konstruktivi i tij ishte i tillë, që minat nuk jepnin efektin maksimal...

— U lodhët, djema?

— Jo, shoku komandant!

— Mirë, burra, edhe një sulm! Hë, ju lumshin krahët! — thirri komandanti i aksionit, Jordani. — Si thoni, do ta çajmë sonte?

— Duhet ta çajmë — u përgjigjën vullnetarët. Por me gjithë dëshirën e madhe të vullnetarëve, makina nuk mundi ta kalojë atë natë. Bazamenti i rrugës duhej zgjeruar, çakëlli shkiste në anën e përrroit. Dhe puna vazhdonte. Prozhektorët e makinës së shofer Toninit shkëlqenin vendin ku punonin vullnetarët... «Edhe pak, edhe pak!».

Kazmat lëshonin shkëndija.

Në orën dhjetë të natës mbritëm në sektor.

Bisedat tonë gjatë rrugës ishin të shkurtëra, dëshira për ta sjellë makinën sa më parë qe e madhe. Përpara nesh vajzat e «Muhamet Shehet» këndonin këngën «Revolucioni marshon». Fitorja ishte shumë afër.

\* \* \*

Puna ditën e tretë ishte më intensive. Goditjet e vareve mbi baromina ja linin radhën buçimës së minave, kazmave, lopatave. Nga shpërthimi i eksplozivit shkundeshin ahet e gjata, tronditej gropë e Selcës dhe gjëmimi tretej larg nga maja.

Shtëllunga e mjegullt e tymit hapej ngadalë dhe zbulonte shkëmbin e sapogërryer.

Gëzimi i vullnetarëve, gëzimi dhe entuziazmi ynë mirrte hov pas çdo shpërthimi.

...Ra dhe mbrëmja e ditës së tretë. Erdhi çasti i shënuar, i shumëpritur. Në orën 6,10 makina me targën 040-817 kaloi shkëmbin e vrecikshëm dhe u nis përpara...

Dhjetëra përqafime e shtrëngime duarsh, zëra të gëzuara dhe thirrje, brohoritje. Në kthesën e parë u zbras batareja e parë. «Rroftë Partia e Punës dhe shoku Enver!». Zbrazej brashëria dhe merrte me vete urimin e madh, e ngrinte lart, e shumëfishonte... Buria e makinës gjëmonte si trumpetë, duke çarë kilometrat e rrugës. Nga zëri i saj, si nga një buri kushtimi, zgjoheshin brigjet dhe pyjet, fshatarët dilnin nga shtëpitë para makinës, vullnetarët vraponin.

Doli në kthesë një nuse e re me një gotë të madhe qumështi në njérën dorë, me një pjatë me djathë me sheqer në tjetrën. Kështu e do zakoni i mikëpritjes, i festës. Fshatarët brohorasin dhe sytë u shkëlqejnë nga gjëzimi dhe lotët.

Nga të katër anët filluan breshëritë. Bariu la tufën në pyll, kooperativistët dolën nga shtëpitë, fëmijët vrapuan drejt makinës... Kur ja, në kilometrin e fundit vrapuan drejt nesh tre vullnetarë më flamur në duar. Ishte flamuri i brigadës «Muhamet Shehu», që shumicën e anëtarëve e kishte matanë qafës së Bordolecit.

Vladimiri, Ndueja dhe Perikliu, si tre marathonomakë të rinj, për pesë minuta ja mbritën që nga sektori. Janë pikërisht këta djem, kjo brigadë që vjet inauguroi lokomotivën e parë në Gradishtë. Mos vallë kjo është një koingcidencë e rastit? Dy ngjarje të shënuara për vullnetarët e kësaj brigade. Dy vjet, dy inaugurime. Po mot, vallë, ç'do të inaugurojnë?...

Makina ecën mes varganit të njerëzve si një karrocë e rrallë dasme, që sjell lumturinë e vërtetë në këto anë. Ajo është lajmëtare e një jete mëtë mirë për malësinë, pararoja e të mirave materiale e kulturale në të ardhmen.

Makina ecën. Në orën 7 të mbrëmjes ajo ngjitet në Qafën e Bordolecit, ndalon në sheshin e bukur të sektorit. Për vullnetarët e fshatarët e këtyre anëve do të mbetet e paharruar kjo natë e ngrohtë e bukur, kjo natë e 2 gushtit plot yje dhe krisma hareje. «Kjo është dita më e lumtur për ne» thonë fshatarët. Dhe urimet ngrihen njëri pas tjetrit si një tufë e pafundme pëllumbash...

Atë natë flamuri i sektorit nuk u ul si zakonisht. Ai qëndroi i ngritur deri në mëngjezin e datës 3 gusht. Qëndroi si një shqiponjë e kuqe mbi shtyllën e gjatë. Ç'thanë vullnetarët atë natë kur u rrjeshtuan? Do të punojmë me vetëmohim si revoluconarë të vërtetë, ta mbarojmë rrugën para afatit të caktuar. Ç'tha atë natë kryetari i kooperativës së Lepushës? Ç'thanë fshatarët atë natë? Faleminderit, shokë vullnetarë, faleminderit partisë dhe shokut Enver për këtë dhuratë të madhe! Kjo është dita më e lumtur pér ne. Dikur ne e mirrim bukën nga Shkodra deri këtu me krahë, udhëtonim dhjetë ditë në dëborë e në shi.

— Dhe na vdisnin njerëzit në duar, se s'mund t'i çonim dot në spital. Kurse sot...

— Faleminderit, shokë, faleminderit!

Kjo është fjala e malësorëve të Kelmendit pér rrugën e re, pér rrugën e partisë, që zgjatet në male, pér dritën që zgjatet mbi telat elektrike.

Lart yjet shkëlqenin. Vallja mbushte sheshin e madh. Dhe krismat vërrshonin si dallgë nëpér gryka.

### Me gjuhën e shifrave

Në mëngjes të dy gjeometrat nxorën përfundimet e dyjavorit të parë pér sektorin e Lepurresh. Volumi i përgjithshëm  $12.811 \text{ m}^3$ , prerje shkurtresh  $16.200 \text{ m}^2$ , nxjerrje rrënëjësh  $15.100 \text{ m}^2$ . Rrugë e filluar 2543 ml. rruge e mbaruar 1390 ml.

Ç'thonë përqindjet e brigadave, «Muhamet Shehu» — 116 përqind, «Ali Demi» — 142 pér-

qind, «Hajredin Beqari» — 134 përqind dhe më e ulëta «Halim Xhelò» — 95 përqind. I gjithë sektori për dyjavorin doli 110 përqind.

Kjo është gjuha e shifrave. Megjithatë shifrat nuk janë shenja pa jetë. Ato mund të thonë shumë. Grafikët janë barometri i punës së kryer. Po a mund të tregojnë shifrat sakrificat dhe vësh-tirësitë e kaluara? A mund të shprehin ato ndje-njat e shumta që vërshojnë në zemrat e vullne-tarëve? A mund të flasin ato për kalitjen e karakterëve të tyre, ashtu siç ndodh në të vërtetë? Për-këtë gjuha e shifrave është e varfër. Të sjellim një shembull: Në fillim flamurin e mori brigada «Avni Rustemi» e Vlorës. Ata të Patosit, me përqindje më të lartë në punë, sikur u mërzitën pak...

Po pse e mori flamurin «Avni Rustemi»? Se anëtarët e kësaj brigade dallohen në aktivitetet e ndryshme kulturolao-sportive. Leximi i shtypit, dy ekspositat që hapen në sektor, diskutimi popullor i teksteve shkollore, rregulli në punë, në rrjesh-timin, në mencë, në kapanon... dhe rezultatet e mira në realizimin e normës, u dhanë më në fund atyre flamurin e sektorit. Se për këto aktivitete merren pikë. Dhe, siç e dini, shifrat janë mjafit kokëforta...

Këtë e kanë kuptuar dhe po e zbatojnë përditë e më mirë vullnetarët, mësuesit dhe shtabi i sektorit. Prandaj ata e zgjerojnë sferën e aktiviteteve dhe në fshatrat për rrëth. P. sh. në turnin e ka-luar u hapën 5 dynyme tokë e re, u bënë dhjetë shtëpi model dhe ju shpall luftë mbeturinave të vjetra në ndërgjegje dhe në mënyrën e jetesës së fshatarëve. Kjo rrugë po ndiqet edhe tani. Vull-ne

tarët ndihmojnë për ndërtimin e kanalit, për hidrocentralin, për elektrifikimin e shtëpive të fshatrave, njihen me jetën e tyre, me jetën dhe trimëritë e kufitarëve tanë.

...Dhe rruga çan përpara. Shifrat ngrihen lart. Dhe në çdo metër rrugë, në çdo rrënje, gur apo trung të shkulur, shihet puna e pamasë e të rinxve, mbetet një pjesë e lodhjes dhe e gjëzimit të tyre. Gjuha e shifrave është me të vërtetë e varfër për të matur vlerat morale dhe materiale që krijon aksioni dhe puna e këtyre qindra vullnetarëve që thyejnë shkëmbinjtë, normat dhe konceptet e vjetra.

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

*14 gusht 1968*

## NË FRONTIN MË TË VESHTIRË

### Një udhëtim i bukur

30 qershor. Dielli sapo kà dalë majë maleve. Kolona e gjatë e makinave marshon drejt frontit të punës, drejt rrugës së porsahapur. Kënga jonë ngrihet në fillim e lehtë, pastaj ushton e fuqishme dhe përhapet në mes këtyre bjeshkëve. Dëgjojnë këngën malësorët dhe malësoret, kthejnë kokën dhe buzëqeshin. Na përvendetin të gëzuar ne, të rinjtë që do ta çojmë më tej rrugën e re. Shumë nga ne, kursantët e rinj të Shkollës së bashkuar «Enver Hoxha», kemi punuar dhe vjet për hapjen e rrugës.

Makinat ndaluan. Zbresim. Ndodhemi para Leqeve të Hotit, të cilat, me dredhat e tyre të shumta, përshkojnë faqen e malit si gjarpër gjigant. Sa mund dhe djersë është derdhur për t'i hapur këto leqe!

Kolona vullnetare vazhdon udhëtimin. Mbrijëmë në sektorin e Grabonit, ku vjet kanë punuar fierakët.

— Ja, tek ai shkëmbi atje, kam punuar vjet me pistoletë — u thotë shokëve një i ri.

Të gjithë e vështrojnë me dashuri shokun e tyre, i cili, si dhe të tjerët, kur la bangot e gjim-

nazit doli vullnetar për t'u bërë kuadro i ardhshëm i ushtrisë sonë popullore.

— Tani do të shihni vendin ku kam punuar unë — u thotë shokëve një tjetër. — Ja, tek ajo kthesa aty ka punuar brigada «Ismail Qemali», kurse më poshtë, te ura, ka punuar brigada «Partizani».

Afrohemë pranë sektorit të Tamarës, ku vjet kanë punuar maturantët e Tiranës. Duket vendi ku kanë qenë vendosur kapanonet, pista e vallëzimit, guzhina e dashur, burimi i ftohtë, ku mbushnim paguret për në punë.

— Këtë shkëmb masiv, të cilil rruga i kalon mes për mes, e ka hapur brigada jonë — thotë Jani Stoja. — Vjet ne e realizuam normën njëqind e katërbëdhjetë përqind dhe muarëm flamurin e sektorit.

Para nesh gjithnjë e më shumë shpalosen pamje të ndryshme. Dalëngadalë i afrohemë Selcës. Lart rrugës së re gjelbërojnë arat e mbjella të kooperativës, kurse poshtë është ngritur hidrocentrali, që do t'u japë dritë fshatrave të Kelmendit, deri në Bordolecin e largët. Në Selcë punon brigada «Gjergj Kastrioti — Skënderbeu» e Durrësit.

Tashmë është ngrysur. Natën e kalojnë këtu, kurse nesër do të nisemi për në sektorin tonë.

### Dita e parë e punës

Mëngjez i bukur. I gjithë batalioni i kursantëve është rreshtuar. Dëgjojmë përshëndetjen e koman-

dantit të shkollës me rastin e fillimit të punës. Sa e sa emocione të zjarrta përshkojnë zemrat tonarimore! Dridhuni, o shkëmbinj, se pas pak në gjirin tuaj të gurtë do të ngulen përsëri me dhjetëra e qindra baromina, do të futen pakot me eksploziv dhe pastaj, lamtumirë! Midis jush do të kalojë krenare rruga e re.

Kolona vullnetare nis e gjarpëron përmes shtigjeve të ngushta të fshatit Lëpushë. S'do kalojë shumë dhe këto shtigje të ngushta, ku mezi kalon mushka, do të zgjerohen dhe do t'ja lënë vendin rrugës së re. Nis kënga, të gjithë janë të gëzuar dhe gëzimi i tyre është premtim pér të ardhmen.

Vendi ku do të punojm është i gjithë shkëmb, një shkëmb i kuq mjافت i fortë. Qëndrojmë përpara shkëmbit masiv. Ai na sheh me vegla në duar. Mos u çudit, shkëmb! Në s'të shkatërruan dot stuhitë, furtunat dhe tërmetet e fuqishme, do të të shkatërrojmë ne.

Dhe puna nis e vrullshme. Vendi ku punojmë është i rrezikshëm e pakujdesia më e vogël mund të të rrezikojë jetën, por ne, kursantët, punojmë me hov. Dëgjohet rrahja e varesë mbi barominë, futja e levës së rëndë në plasjen e shkëmbit, zhurma e kazmës, lopatës. Muzikë e vërtetë, muzikë pune, kjo! Shkëmbi mundohet të rezistojë, po baromina futet gjithnjë e më thellë në gjirin e tij. Leva shkëput prej tij pjesë të mëdha dhe i rrokullis poshtë në Cemin e flohtë. Fillojnë të dukken rezultatet e para të punës; brimat e para u mbaruan, u hap një shteg, një «galeri» ku është mina. E kupton, shkëmb, që rezistenca jote

është e kotë? Që në përpjekjen e parë dole i mundur.

Mbas dite shpërthimet e minave çelin në gjirin e shkëmbit metrot e para të rrugës së re. Puna mbaroi.

Fitore! Norma u realizua.

### Ura u ndërtua, çakëlli u hoq

Një pjesë e kursantëve zbritën nga Lepusha në Selcë, ku i priste një detyrë e re. Në frontin e punës, ku punonin vullnetarët e brigadës «Gjergj Kastrioti-Skënderbeu» kishte dalë një shkëmb i madh e i fortë. Shkëmbi duhej hapur nga 30 metra e pastaj të ndërtohej ura mbi Cem. Vullnetarët këtë volum pune duhej ta mbaronin për një muaj, mirëpo ky ishte një afat i gjatë e për këtë shkak pengohej furnizimi i sektorëve. Mushkat duheshin zëvendësuar me makina, por ura që s'ishte ndërtuar dhe çakëlli më sipër, i cili sapo e hiqje rrëshqiste sérish nga lart dhe mbushte rrugën, ishin pengesa.

Në këto dy fronte u caktuan një pjesë e kursantëve. Detyra ishte e vështirë, por ne u zotuam që të kalonim normat tonë xhenjëre dhe të ndërtonim urën për një kohë sa më të shkurtër.

Puna filloi sérish e vrullshme. Të gjithë dëshironin që ta kryenin detyrën sa më parë. Te çakëlli puna qëndronte krejt ndryshe. Sipër rrugës, gjatë faqes së një shkëmbi, ndodhej një sasi e madhe gurësh të coptuar, që mbushnin rrugën sa herë që vullnetarët e hapnin atë. Diçka duhej bërë. Që të

hiqje gjithë atë volumn çakëlli duhej një kohë e gjatë, të cilën nuk kishje ku ta gjeje.

Njëri prej nesh dha një mendim të mirë. Të vinim në faqe ku kishte çakëll gurë të mëdhenj, të cilët do të ndalonin rënjen e tij nga sipër. Dhe kështu u bë. Filloi të dukej rezultati: çakëlli nuk rrëshqiste më si më parë. Dalëngadalë vendi po pastrohej. Vendosja e gurëve të mëdhenj po e pakësonte gjithnjë e më shumë rrëshqitjen. Tempi i punës filloi të rritej. Dikush, duke dhënë shembullin personal, i nxiste shokët të punonin sa më shumë. Dalloheshin kursantët: Ylli, Petraqi, Shkëlqimi, dhe Vasili.

Më tej po zgjerohej një kthesë e fortë. Puna aty duhej të mbarohet për dy ditë, por, në sajë të vrullit revolucionar, kursantët e mbaruan për një ditë dhe ditën tjeter ndihmuani për heqjen e çakëllit. Komandanti dhe i gjithë kolektivi i falënderoi ata për punë të palodhur. Shkëmbi në Selcë u ca dhe ura ishte gati të hidhej pas 8 ditësh. Disa ditë më vonë u pastrua dhe rruga tek çakëlli. Detyra u krye, kursantët u nisen për në një sektor tjeter, ku pak më parë punonin studentët.

Sektor i ri, punë e re, vrull i ri...

### Boria e parë

E hënë, 22 korrik. Pas shirave që ranë dy ditët e fundit, koha u ftoh mjaft. Shiu vinte rrotull. Kursantët nisen për të punuar. Ata nuk i tremb as shiu, as të ftohit. Rruga ka shkuar deri

në Bordolec, por në disa vende ajo duhej zgjeruar dhe ca. Më sipër duhej ndërtuar një mur, duhej çarë copa e fundit e një shkëmbi, që kishte zënë rrugën më parë. Megjithë të ftohtit e atij mëngjezi, vullnetarët zhveshën gjimnastjorkat dhe të kërrusur vazhdonin punën.

Pa pritur ndihet një zhurmë.

- Sinjali i minave — u thotë shokëve Jani.
- Jo, nuk është sinjali i minave — përgjigjet Ylli.

— Shokë, më duket si bori makine.

— Po, po, makina, shikoni!

— Urraaa!

Poshtë nesh u dukën dy makina «Gaz-69», që po gjarpëronin në leqet. Makina e parë! Boria e parë!

Dëgjoni, o bjeshkë, borinë e makinës dhe na falni në ju prishëm qetësinë!

— Shpejt, shokë, t'i heqim dhe këta gurë të mëdhenj, makina duhet të kalojë.

Tek rruga, dy pleq të moshuar. Ishin dy vëllezërit Zefi dhe Pjetri. Pas u vinin bijtë dhe nipërit. Makina erdhi. Çlumturi ndjejnë në ato çaste malësorët! Pranë shtëpisë së tyre kaloi makina e parë. u dëgjua boria e parë! Qeshnin vocërrakët; malësorët u përqafuan me komandantintonë. Në sytë e tyre shkëlqenin dhe pikë loti, lot gëzimi.

— Vetëm se s'më lejohet, shoku komendant, pa do ta kisha shkrehur armën për këtë ditë të madhe që na solli partia — thotë i lumtur Zefi.

— Kjo fitore i detyrohet partisë, kjo rrugë është dhurata që bën partia për ju, për ne, për gjith vendin, — përgjigjet komandanti.

Ja dhe Luigji i vogël. Ai për herë të parë shihte makinë me sy. E shihte e nuk ngopej së pari. E ledhatonte si të ishte vëllai apo motra e vet e vogël. I binte borisë, dhe jehona e saj përhapej e fuqishme, krenare. Tungjatjeta bjeshkë! A e dëgjoni borinë e makinës? Asaj i ra Luigji i vogël.

Për kujtim, të dy vëllezërit malësorë, së bashku me bijtë dhe nipërit e tyre, bënë një fotografi para makinës që shkoi deri afér Lepushës së largët.

### Një shoku ynë

E quajnë Trifon. Është kursant i rrregullt e shembullor.

Trifoni ka mbaruar politeknikumin mjekësor. Mjeku që kishim mjekonte pjesën më të madhe të kursantëve që ndodheshin afér Lepushës, kurse ne, që punonim në Gropën e Lojnavë të Erës, na vizitonë Trifoni.

Ai kishte trup të lidhur mirë. Gjatë punës gjithnjë tregohej i dashur me shokët, u mjekonte me kujdesin më të madh plagët dhe gërvishjet që u shkaktoheshin në përleshje me shkëmbinjtë. Në punë, duke rrëzuar copat e shkëmbit me levë, u plagos Vllasi. Gishtrinjtë ju dëmtuan, sidomos gishti i madh, kështu që njérën dorë nuk mund ta përdorte. Trifoni ju ndodh pranë, ja mjekoi dhe e këshilloi që të nesërmendë mos dilte në punë, por Vllasi nuk pranoi.

— Jo, unë mund të punoj edhe me një dorë;

edhe kështu unë do të përpinqem ta realizoj normën.  
Trifoni buzëqeshte i lumtur.

Ja, të tillë janë shokët tanë, ata kurrë nuk e lënë rrugën për gjysmë.

### Mes për mes

— Ja, mes për mes këtij shkëmbi do të kalojë rruga, — thotë komanadnti. — Puna ka shumë vështirësi, por ne do t'ja dalim në krye.

Duheshin hapur me dhjetëra brima në gjirin e shkëmbit, që të hapej një shteg ku të mund të punohej. Pastaj duhej vënë në përdorim leva, kazma, vareja, lopata dhe baromina.

Zhurmë, punë; dëgjohet rrahja e varesë mbi barominë, ushtojnë veglat e punës. Ja tek punon një djalë i shkurtër me trup të lidhur e krahë muskulozë. Djersët bulojnë në trupin e tij të burkur, që rrezet e diellit i kanë dhënë ngjyrën e çokollatës. Ai ngre e ul vazhdimishit varenë, duke goditur me të mbi barominë. Është Agimi i palodhur, ashtu si shokët e tij, dhe do që normën sot ta tejkalojë.

Shpërthimet e minave hapin gjithnjë e më shumë shtegun e ngushtë të fillimit. Dalëngada ë rruga merr formën e duhur. Duhet zgjeruar dhe ca, duhet çfarë dhe pjesa e sipërme e shkëmbit dhe rruga është gati.

— Shpejt, shokë, — nxit Agimi — sot duhet ta mbarojmë rrugën!

Dhe shkëmbi u çà, rruga u hap. Mes për mes shkëmbit do të kalojë makina.

## Ditë sulmi

Ditët e fundit i shpallëm ditë sulmi. Ngrihem më herët se zakonisht dhe punonim deri sa errej. Bukën e hanim në frontin e punës. Në mëngjez, apo jepej sinjali «çohu!», të gjithë ngrihem nga shtretërit dhe pregetiteshim për punë.

— Shokë, shikoni, Astriti nuk është zgjuar akoma.

— Çohu, more gjumash, «se të presin vepra të mëdha!»

Të gjithë qeshnin.

Punë e madhe është bërë për të çarë shkëmbin e fortë e viganë, disa qindra metra të gjatë. Dhe një pjesë e vogël e tij kishte mbetur. Duhej shkaterruar ai, se kishte penguar përparimin e rrugës.

Në një vend baromina përparonte ngadalë, leva mezi i shkëpuste copat e shkëmbit. Dita kalonte dhe shkëmbi nuk po çuhej. Kursantët që punonin aty vendosën të qëndronin deri sa shkëmbi të hapej.

Filloi të errej. Vullnetarët nuk e linin punën. Ata ishin të vendosur ta kryenin detyrën me gjithë vështirësitë që hasnin.

Ora 20, detyra u krye me sukses! Lart, në qiellin e pastër, yjet, me shkëlqimin e tyre, përshtendesnin të rintjtë. vullnetin e tyre të paepur, fitoren e tyre mbi shkëmbin e fortë.

Çdo ditë në rrugën e porsahapur, vinin makinat me ushqime dhe eksploziv. Mushkat filluan të zëvendësohen me makina. Kjo ishte fitorja jonë e madhe. Vullnetarë të tjerë punonin në sektor të ndryshëm. Kudo shtigjet dhe monopatet e

ngushta zgjeroheshin. Rruga e re marshonte me kiuometra të reja.

### Mirë u pafshim


Dita e fundit. Nesër, mbas një muaji, ndahemi nga fronti i punës. Lamtumirë, Malësi e Madhe, rrugë e re! Mirë u pafshim, Zef, mirë u pafshim Pjetër, mirë u pafshim, o Luigj i vogël! Mirë u pafshim në aksione të reja, në rrugë të reja!

Po ndahemi, por kjo është një ndarje plot suksese. Largo hemi nga Malësia e Madhe me dy flamuj të aksionit. Ja dhe kompania më e dalluar me flamurin që valëvitet krenar përpëra saj! Sot gjokset e vullnetarëve shndrisin nga S-të e kuqe. Disa kanë marrë nga dy shenja sulmuese, të tjerë nga tre.

Mirë u pafshim!

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

*21 gusht 1968*



Të rinjtë të ardhur nga të katër anët e Shqipërisë hapën 64 km. rrugë.

## DEGJONI KUMBIMIN E MINAVE...

Vermoshi është sektori më i ri i Malësisë së Madhe. E filloj jetën me ardhjen e vullnetarëve të Korçës dhe Maliqit.

Është sektori më i ri, por që në jetën e tij do të shënojë një nga ngjarjet më të paharruara të këtij aksioni të madh.

Këtë ngjarje të madhe do ta jetojë turni tjetër i vullnetarëve, që do ta çojë rrugën ditën e 16 tetorit 1968...

«Ne erdhëm këtu natë e tretë pas nisjes nga qyteti. Ky nuk ishte një udhëtim, por marshim i vërtetë.

Ditën e parë mbritëm në fshatrat e Shkodrës. Atje fjetëm. Të nesërmen fshatarët na përcollën përsëri për udhë. Na përcollën me dashuri sikur të ishim fëmijët e tyre. Na përcollën nënët fshatare, ne, vullnetarët e Malësisë së Madhe. Ditën e dytë arritëm në Selcë. Këtu na zuri nata. Mbësh-teteshim në shpinën e shokut... Herë-herë zgjoheshim nga të ftohit e natës dhe nga shiu që binte. Në të aguar pamë yjet mbi gryka, midis reve të cara. Dhe u nisëm përsëri për udhë. Ditën e tretë arritëm në Vermosh. U lodhëm... Por

lodhja na bëri dyfish më të fortë. Dhe valixhet na dukeshin më të lehta ditën e tretë. Asnjëri nuk ankohej. Asnjëri s'u sëmur. As gjërvishtjen më të vogël nuk patëm. Të gjithë arritëm shëndoshë e mirë. Ne kishim bërë shumë marshime dhe eskursione të tjera, por ky ishte më i bukuri, më i vështiri. Ky marshim mund të quljet fitorja jonë e parë në këtë aksion.

«Kur mbritëm në sektor kishim shumë punë për të bërë. Gjithçka duhej ta ndërtonim me duart tonë: disa kapanone, mencën, fushën e futbollit, brezin e sulmit, tabelën e fletërrufeve dhe të gazetës së aksionit.

Duhej të merrnim nga sektori i Lëpushës batanijet dhe veglat, të rregullonim dyshekët. Dhe të gjitha i ndërtuan vetë për bukuri. Degët e ahut na hynë shumë në punë...»

Kieto na treguan në fillim vullnetarët e sektorit më të ri.

Dhe nga fjalët e tyre mund të kuptosh shumë. Ku janë këtu vajzat delikate apo djemtë e përkëdhelur? E ku ka vend në mes të rinjve përpshërtima dhe vogëlsira. Tani, pasi marshimi u kthye në një kujtim të largët, të rinjtë e kuptojnë më mirë bukurinë dhe madhështinë e tij, e kuptojnë sa shumë përfituan nga ato tri ditë dhe net të paharruara, nga vështirësitet e fillimit. Dhe e dinë mirë se pérpara kanë shumë marshime.

### Jetë plot gjallëri

Përse dallohet kjo skuadër? Ç'gjë të veçanta ka? Anëtarët e saj shumica janë vajza. Ja,

Qamilja, komandantja e skuadrës tek pastron me lopatë dheun e rrëzuar.

Ja Dituria, Pranvera, Sofika, Rozeta, Kostandina... Dhe midis tyre vetëm një djale, Zefi...

Por nuk është kjo veçanti e kësaj skuadre. Veçantia e saj është puna shembulllore që bëjnë vajzat. Është fakt i njojur që skuadra e Qamiles mbahet nga më të dalluarat e brigadës së tretë.

— S'janë vetëm të punës, po edhe të këngës — thotë pedagogu i letërsisë, Vangjeli. — Në shfaqjet që preqatit brigada janë gjithmonë të parat... Ato me punën e tyre e kanë thyer konceptin se «vajzat s'punojnë baraz me djemtë» dhe marrin pjesë gjallërisht në gjithë jetën e aksionit.

Kjo jetë e madhe mund të plotësohet edhe më mirë nga aktivitetet e vullnetarëve, nga ekskursionet apo vizitat në postën kufitare, nga puna vullnetare në ndihmë të kooperativës së Vermoshit, nga diskutimet e shumta në një mbledhje rinie, nga aktivitetet kulturale dhe nga shfaqjet.

Kjo poezi aksioni është kudo. Ajo është edhe në ato pak minutat e pushimit aty midis vullnetarëve të brigadës «Themistokli Gërmenji», ku dëgjohet një fizarmonikë dhe një zë i dridhshëm:

— Hej, djema, djema, dëgjoni! Po këndon Paskali! — foli dikush në kthesën e rrugës.

Paskali për herë të parë preqatitej të këndonte në shfaqjen që do të jepte brigada e tij.

— Atje, në shfaqje, do ta dëgjojmë më mirë.

— Një talent i ri na u shtua — thanë shokët e Paskalit duke qeshur.

Pas pak minutash vullnetarët filluan përsëri punën.

## Viganët e Maliqit

Ju do të pyesni: ç'janë këta viganë?! Nuk janë tjetër veç vullnetarët e kompanisë «8 Nënitori», që u dallua qysh në fillim për rezultate të larta në punë.

Atë ditë që i takuam, ata punonin rrëzë një përroi me ahe të larta.

— Kjo është skuadra e tretë, apo jo?

— Po, skuadra e tretë e kompanisë së Maliqit!

— E treta, por nga rezultatet na thanë se jeni e para...

— Jo, — thotë me mirësjellje komandanti i kompanisë, Petriti, — të trija skuadrat janë njëlloj të dalluara.

Skuadra e tretë ka me të vërtetë punëtorë të palodhur.

Ja p.sh. komandanti i saj, Vigani, shkul dhe pret rrënjet e një trungu. Forca dhe këmbëngulja e tij në punë nuk e turpërojnë emrin që mban.

Goditjet e tij me kazmë janë të sigurta, i xhvatin shkëmbit copa të mëdha, rrëzojnë dhen, apo presin rrënjet dhe kurrë nuk pushojnë.

Si Vigani punojnë të gjithë shokët dhe shoqet e tjera, punojnë vërtet si viganë. Prandaj dhe ne, që në krye, i cilësuam me këtë epitet.

Ja Pirrua, Sulejmani, Rakibi dhe Mërgimi po gërryejnë një masiv të madh dheu nga lart dhe anash. Punojnë me shpejtësi. Dhe ja, tani barominat japin shtytje të forta:

— Jepi edhe pak!

— Mos rëndo nga përpara!

— Jepi fort lëvës!

Dhe masivi i dheut rrëth trem<sup>3</sup> bie dhe thërmohet menjëherë.

Cili është sekreti i kësaj kompanie?

— Janë pak vajza — tha një vullnetar.

— Janë vetëm 39 vullnetare, — tha një tjetër...

Po më mirë le të flasin ata vetë.

Kryesorja është organizimi dhe mobilizimi. Puna fillon mbarë qysh në mëngjez. Ndahen veglat dhe krahët e punës, sipas terrenit, sipas nevojave. Fryma e shëndoshë e kolektivitetit, vlerësimi kritik i punës së kryer ditën e kaluar, janë faktorë të rëndësishëm që ndihmojnë në tejkalimin e normës.

— Ne kemi ardhur në aksion me duart me kallo, — thotë Hamiti, një pjesëtar i kësaj kompanie. — Para se të vinim këtu, ne e kaluam muajin e pushimit që të gjithë në fermë duke punuar arave. Prandaj tanë maliqasit e kanë nië të lehtë për të punuar kudo, për të kapërcyer çdo lloj vësl tirësie.

— Djema, nesër do të punojmë tek shkëmbi i madh, dëgjuat? Të gjejmë qysh në drekë barominat dhe varetë!

Është zëri i pedagog Ibrahimit, pedagogut të fiskulturës. Ai midis tyre është një shok i vërtetë. Fjala e tij e ngrohtë dhe shembulli personal, puna në frontin më të vështirë, janë një nxitje e heshtur për secilin:

— Djema, nesër do të punojmë në shkëmb! — ky zë fluturon nga skuadra në skuadër si një sihariq, si një shprehje me kuptim të veçantë. Kjo

mund të shpjegohet fare thjeshtë: «viganët» kanë shumë dëshirë për t'u ndeshur me vështirësitë, me shkëmbinjtë. Puna në shkëmb u duket vullnata-reve më tërheqëse dhe më e bukur.

Shikoni të rintjtë duke hapur trasenë. Dëgjoni kumbimin e kazmave, vareve, minavet dhe pastaj do ta kuptioni dëshirën e tyre. Copat e shkëmbinj-ve rrrokullisen në përrua, duke marë me vete lodh-jen dhe zhaurimën.

### Ditëlindja

— Marga ka ditëlindjen sot, — u tha shoqeve në mëngjez Doloreza.

— Ta festojmë së bashku!

— Të bëjmë një mbrëmje gjithë brigada!

— T'i bëjmë ndonjë dhuratë të vogël.

— T'i dhurojmë edhe një tufë lule...

Të gjithë shokët e skuadrës dhe ata përreth filluan të urojnë Margaritën për ditëlindjen.

— Ej, Marga, do na qerasësh me një lloku-me! — i thirri asaj Gjergji që gërmonte pak më larg, rrëzë një trungu.

— Në pushim, o Gjergj, jo tani, se jemi në orarin e punës, — ju përgjegj humorit të shokut Margarita.

— Shokë! Sot duhet të bëjmë nga dy norma, foli komandantja e skuadrës, Antonina, një vajzë e gjallë dhe e qeshur.

— Dy norma!... Dhe një t'ja falim Margës për ditëlindje!...

Shoqja e tyre, që mbushi të shtatëmbëdhjetat,

e ndjen veten me të vërtetë të lumtur këto çaste.

Ka gjë më të bukur se të festosh ditëlindjen këtu në aksion, në mes shokëve të tu, në mes vëllezërve, këtu, në familjen e madhe të vullnetarëve? Eshtë i dyti vit që Marga e feston ditëlindjen në aksion. Dhe në sa aksione të tjera ajo do të festojë ditëlindjen! Ditëlindja atë përherë do ta gjejë nëpër aksione, në malet dhe në fushat e atdheut.

Margaritën e duan dhe e respektojnë shokët e shoqet. Për punën dhe shembullin e saj në shkollë e aksion ata e zgjodhën edhe sekretare riane të klasës.

E gjatë, me fytyrën e mprehtë, me shikimin e thellë dhe të vëmendshëm, me shkathësinë e saj, Margën e sheh kudo: punon dhe drejton. I këshillon dhe i kritikon shokët. Qëllon që me ndonjërin edhe grindet... Por kjo për të mirën e punës, të organizatës. Sepse pa luftë, pa këmbëngulje në kryerjen e detyrave, rinia e humbet gjallërinë e saj, shpirtin e madh revolucionar. Malësia, me bukurinë e saj, me pyjet dhe ujërat e ftohta, me shokët, me punën dhe këngët e aksionit, ja ka përtëritur forcat Margës, i ka dhënë freski dhe gjallëri më tepër. Tani pranë saj punon Flora me Natashën, Anesti me Edmondin, punojnë dhjetëra shokë e shoqe, që ndjejnë sot po atë gjëzim që ndjen dhe Marga.

Ata të gjithë janë gazmorë dhe plot humor. Sonte, në mhrëmje, do të mblidhen në sheshin e sektorit, do të vallëzojnë dhe do të këndojnë së bashku. Flora me Dolorezën e Antonina do të këndojnë një këngë. Anesti apo Xhina do të filloj-

në ndonjë skeç, kurse Genci, ai djali i gjatë e simpatik, do të luejë rolin e Xhonsonit, duke mbajtur në kokë atë borselinon e përhime, të zbardhur nga dielli. Dhe të gjithë do të urojnë me radhë shoqen e tyre:

- U bëfsh dhe njëqind vjeç, moj Margë!
  - Rrofsh sa pishat majë Vermoshit!
  - Rrofsh sa rruga e Malësisë së Madhe!
- Janë urime vullnetarësh.

### ...Vermoshi i vullnetarëve

— Këtu çdo gur e çdo shkrep ka historinë e vet. Pishat kanë shtrirë rrënjet mbi heroizmat e gjyshërve tanë. Breza të rinj janë shtuar në pyjet e Vërlishit, breza të rinj kanë lindur nga gjiri i popullit.

Kjo pishë gjigante mbi fshat nuk duhet prerë! Ka historinë e saj dhe ajo. Aty u asgjësua një bandë dhe na ra një trim. Kjo pishë, si një rapsodo plak, i thinjur nga bora e viteve, do t'ju trajtë nipërve për stuhitë e kaluara.

Ja, Shkëmbi i Djegur dhe livadhet e Jaciqes në malin e Përbicës. Ato do t'u tregojnë se si ra pionieri trembhëdhjetëvjeçar Nik Pjetër Ndreka.

Në ato livadhe të bukura-kulloste tufën djaloshi vigjilent. Pasi kthehej nga kullota, Nika shkonte një herë nga posta kufitare e pastaj në shtëpi të vet. Një ditë, një bandë diversantësh shkeli barin e gjelbër të lëndinave të praruara, shkeli tokën tonë. Dhe Nika, që kuptoi, duke mos

u dhënë asnë shenjë dyshimi, shkoi dhe tregoi në postë për gjithçka pa. Banda u shpartallua. Por një tjetër bandë diversantësh, një javë më vonë, u «hakmuar» egërsisht ndaj tij. Nik Pjetër Ndrekë atë mbasdite nuk u kthyte nga posta dhe as shkoi në mbrëmje nga shtëpia e vet... Kishte rënë poshtë Shkëmbit të Djegur kjo shqiponjë e plagosur nga thikat e kriminelëve!

Këtë histori dhe shumë të tjera për jetën në kufi dëgjonin vullnetarët një mbasdite. Komisari fliste... «Vermoshit strehët e shtëpive i pikojnë mbi piramidë». Kështu mund të shprehet më saktë pozicioni i këtij fshati verior. Këtu lufta më shkelësit ka qenë e paprerë dhe e ashpër. Kanë rënë dëshmorë në këtë luftë edhe Nikollë Toma e Rrok Gjoni po nga ky fshat. Këtu vigjilencia është frymëmarrje e dytë e malësorëve. Ndaj edhe vullnetarët punojnë dhe vigjëlojnë, e zbërthejnë dhe e mbërthejnë karabinën symbyllur.

Vermoshi dhe gjithë Kelmendi kanë vuajtur shumë nga e kaluara. Bajraktari kriminel Preng Cali, luante me fatin e malësorëve, ai ishte kurdoherë me kobure në dorë. Po partia edhe këtu e tha fjalën e vet. Dhe populli e bëri Preng Calin kapedan të shëtisë si pulë e lagur mbi gomar, rrugëve të Shkodrës, nën pështymat e urrejtjes dhe mallëkimeve.

Vermoshi ka dy vjet që u bë kooperativë dhe po ecën me siguri në rrugën e lulëzimit. Më 16 tetor këtu do të vijë makina dhe drita elektrike. Atë do t'i bien vullnetarët së bashku me fshatarët.

Takon këtu vullnetarët e shkollave nga Kor-

ça, Vlora apo Berati. Takon këtu vullnetarë nga ndërmarrjet e qytetit të Shkodrës. Për dy vjet rresht ata kanë dhënë në Vermosh ndihmën e tyre të çmuar dhe kanë mësuar shumë prej fshatarëve... Ata s'gjejnë fjalë të shprehin mirënjohjen e thellë para largimit. Takon këtu vullnetarët kooperativistë nga rrëthi i Gjirokastrës, që kanë ardhur në bjeshkët e Vermoshit të shkëmbjnë eksperiencën dhe të miqësohen me vellezërit nga Vermoshi.

Ka ardhur këtu një e re nga Koshovica, një i ri nga Llovina, një e re tjetër nga Kakavia ku-fitare. Kanë ardhur këtu edhe shumë fshatarë të tjerë dhe kuadro partie. Një muaj jetë në mes miqve të Kelmendit atyre u ka lënë mbresa dhe përshtypje të mira. Jeta këtu po përmirësoshet dita-ditës, në luftë me zakonet e vjetra dhe prapambetjen. Tani historisë së Vermoshit, po i shtohen kapituj të rinj, kapituj të shkruar nga duart e vullnetarëve që po gdhendin në shkëmbinj dhe në zemra vijën e partisë, idealet e ndritura të socializmit...

Shikoni atë bregun përballë sektorit, matanë shtëpive, rrëzë drurëve! Të rinjtë kanë shkruar parulla atje, me gurë të bardhë, me gurë lumi. Dhe marrin një kuptim të veçantë ato fjalë këtu. Dhe skajin më verior të atdheut, këtu në kufi, në Vermosh. Ato i shkroi Gjergji, Ylli, Agimi, Flutura, Vali, Lida e të tjerët një mbasidite korriku:

Rroftë PPSH! Lavdi marksizëm-leninizmit!  
Rroftë shoku Enver Hoxha! Lavdi RPSH!

Duken ato sikur kanë mbirë nga dheu, duken si brazda dëbore që dielli s'mund t'i tretë. Dhe

midis këtyre parullave të zë syri një yll të madh, yllin partizan, yllin e komunizmit. Kështu vullnetarët gdhendin në këto anë fjalën e partisë, portretin e madh të rinisë heroike. Po më thellë nga çdo gjë, më e bukur nga çdo gjë, po gdhendet grykave rruga, rruga jonë.

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

*28 gusht 1968*

## **SHKEMBI U MPOSHT, FLAMURI U FITUA**

Fjetoret e vullnetarëve kanë rënë në qetësi. Dëgjohet vetëm fryshtësia e vullnetarëve që flenë dhe hapat e postrojes që qëndron vigjilient. Këtë qetësi e prish çanga që bie.

Ora 4.30. Përnjëherësh në kapanonet ndihen lëvizje. Vullnetarët dalin, lahen e pastaj rrjesh-tohen për ngritjen e flamurit. Në krye të rrjesh-tit qëndron brigada e të rinjve të Patosit. Komandanti i brigadës, Vladimiri, raporton: «Efekti-vi 75, prezent 75». Pasi hanë mëngjez, brigadat nisen për në frontin e punës. Nga të katër anët shpërthejnë këngë partizane e revolucionare. Flamuri i kuq valvitet krenar nga era mëngjezore, që vjen nga gryka e Budoçit dhe ajo e Selcës.

Këndon e gjithë brigada. Jehona e këngës merr ahishten, poshtë dhe bëhet më e fuqishme.

Këta të rinj revolucionarë duan t'u ngjasin heronj-ve. Në krah mbajnë kazma dhe lopata. Ata punojnë pa u lodhur, po derdhin djersë në zgjatjen e trasësë të rrugës së Malësisë së madhe. Që në 5-ditorin e parë u radhitën ndër brigadat më të dalluara, por nuk kënaqen. Brigada ju afrua shkëmbit shekullor të mbuluar me myshk. Dikush tha:

— Qenka shumë i madh ky shkëmb.

— Ku pyesim ne! — u hodh e tha një vullnetar. Patjetër duhet ta çajmë këtë shkëmb dhe të bëjmë që të kalojë makina brenda 3 ditëve në Qafën e Bordolecit.

Të gjithë aprovuan mendimin e tij.

Filloi përleshja. Një përleshje e vërtetë midis të rinxje dhe shkëmbit. Shkëmbi dukej sikur u lutej vullnetarëve: «Mos më ngani, më lini në qetësi!» Të rënat e kazmave, hapja e birave për minat qe përgjigja e tyre.

Minator Shabani, plak pensionist, që punon me vullnetarët, minatori ushtar Islami, ndihmësit Arqileja dhe Qazimi, vullnetarë të brigadës sonë, vendosën dinamitin, i ndezën fitilat. Një shpërthim prishi qetësinë e pyllit, qetësinë e këtyre luginave dhe bjeshkëve të alpeve tona të bukura. Shkëmbi dukej si i palgosur për vdekje. Pjesë të mëdha u shkëputën nga trupi i tij dhe me rrapi llimë ranë poshtë në Cem. Filloi pastrimi nga copat e shkëmbit.

Fytyrat e vullnetarëve janë mbushur me bulëza djerse, por ato s'duan t'ja dijnë, punojnë atje ku është më vështirë, ku është shkëmbi më i madh.

Më bën përshtypje puna e palodhur e një grupei vajzash. Ato janë gjashtë: Ganoja, Liria, Flora, Xhevoja, Dhoksia dhe Fatmira. Punojnë e këndojnë për jetën e re, për punën. Ja, para tyre qëndron një copë e madhe shkëmbi. Askush nuk mund ta lëvizë dot vetëm. Të gjashta, duke përdorur leva, e lëvizin dhe e hedhin poshtë në Cem. Një jehonë e fortë çan hapësirën dhe kjo më tërë grykën e Selcës.

Dy ditë e gjysëm luftoi brigada «Muhamet Shehu» me shkëmbin 35 m. të gjatë dhe 6 metro të lartë, me një volum prej  $240 \text{ m}^3$ . Dhëmbë për dhëmbë luftuan të rintjtë me shkëmbin dhe dolën më të fortë, më të kalitur.

Nuk ka vështirësi që të mos kapërcehen nga këta të rinj, bij naftëtarësh. Ata e thyen edhe cepin e fundit të shkëmbit që kishte mbetur. Vendì u pastrua nga gurët dhe rruga u hap, shkëmbi u mposht plotësisht.

Ndërsa përgëzonin njëri-tjetrin, buria e makinës tërhoqi vëmendjen e tyre. A do të kalojë, vallë, makina me ngarkesë? Shofer Tonini me marshin e parë e nget makinën ngadalë. Poshtë ndodhet humnera e Cemit. Një «urra» e fortë shpërtheu nga gjokset e vullnetarëve.

Përqafime, shtrëngime duarsh, urime për fitoren. Vladimiri, Perikliu, Nuja, Palushi, me një frysë, morën flamurin që ishte 50 m. larg nesh, dhe ja vunë makinës. Ishte hera e parë në historinë shekullore të këtyre anëve, të këtyre bjeshkëve shkelja e makinës.

Me të dëgjuar zërin e fortë të burisë, të gjithë banorët, burra, gra, fëmijë të fshatit Gropë, dolën në rrugë dhe shihnin me admirim makinën. Kishte fëmijë që s'kishin parë makinë. Teto Liza, plakë 70 vjeçë, me lot gjëzimi në sy, thirri sa pati fuqi: «Rroftë Partia me shokun Enver Hoxha në krye».

Të rintjtë, e ngritën teto Lizën sikur të që ndonjë pendë, dhe e vendosën në kabinën e makinës. Makina, e zbukuruar hijshëm me flamurë e shami vullnetarësh çante përpara. Para, anash,

prapa kishte njerëz. Pas një ore udhëtimi arritëm në qendër të sektorit. Më se 850 vullnetarë, të rrjeshtuar në të dy anët e rrugës, priten me gë-zim ardhjen e makinës dhe brigadën «Muhamet Shehu». Krismat e pushkëve, automatikëve çanë hapësirën, prishën qetësinë, lajmëruan mbritjen e makinës. Përqafime, shtrëngime duarsh, urime përsëri midis tyre.

Oshëtinin grykat e maleve përreth. Në mes të një entuziazmi të madh e mori fjalën komandanti i brigadës. Ai falënderoi brigadën «Muhamet Shehu», që u ndesh ballë për ballë me shkëmbin, e mposhti atë dhe bëri që atje të kalojë makina.

Edhe 10 km. rrugë kanë mbetur pa u mbaruar deri në Vermosh. Si të gjitha brigadat vullnetare edhe brigada «Muhamet Shehu» e Pato-sit, është zotuar që të punojë që rruga të mbarohet sa më shpejt.

Në ndeshje me vështirësitet po kaliten këta të rinj. Me të tjerë shkëmbenj edhe më të mëdhenj do të ndeshen, por patjetër do t'i mposhtin e do të dalin fitimtarë.

*Marrë nga «Zëri i rinitë»  
4 shtator 1968*



## MIDIS NJEREZVE TË XHADESE

Pas tri orësh udhëtimi buzë lumit të Vermoshit, nëpër ahet e hazdisura dhe livadhet plot gjelbërim, arritëm në pikën më të largët. Qytezën e vullnetarëve të vendosur në luginën e bukur e gjetëm në atë gjallëri jetëdhënëse që krijon ambienti rinor. Kishin vetëm tri ditë që kishin ardhur të 568 vullnetarët nga Shkodra, Tirana, Dukagjini, Durrësi e gjetkë dhe, siç është e natyrshme, shumicën i gjetëm duke u shkruar letra familjeve e të afërmve të tyre. Ja, përpara një çadre ishin mbledhur një grup shoqesh të brigadës «Shkurte Vata», nga Vau i Dejës. Marija, një vajzë nga kooperativa bujqësore e Mjedës, po shkruante letër, e rrethuar nga shoqet e saj. Midis tyre njohm një vajzë 18-vjeçare nga kooperativa bujqësore e Gomsiqes. Kishte vetëm një javë që kishte prishur fejesën e imponuar 6-7 vjet më parë nga prindët. Kur e pyetëm pse e kishte prishur fejesën ajo na u përgjigj: «Ai nuk ishte për mua; kishte përbërje politike të keqe. E pata të vështirë, megjithëse im vëlla më ndihmoi shumë, për ta shkatërruar këtë fejesë fyese për nderin dhe dinjitetin tim. Vendosa ta festoj

prishjen e fejesës sime duke ardhur në aksion, këtu<sup>r</sup>  
në Malësinë e Madhe.»

Pak më tej, brigada tiranase «Myslim Keta» po bënte mbledhje. Një natë më parë, Shpëtimi dhe dy shokë të tij, kishin pirë. E tërë brigada ishte mjaft e shqetësuar për këtë gjest. Por pas shumë diskutimesh të anëtarëve të BRPSH-së të brigadës, që e dënonin me ashpërsinë më të madhe veprimin e këtyre të rinxve, këta të fundit kuptuan drejt fajësinë, dhe dolën nga mbledhja me një autokritikë të shëndoshë, duke premtuar se do ta shlyenin këtë njollë, që i kishin vënë brigadës dhe organizatës, me punë të palodhur. Dhe e vunë në jetë qysh të nesërmen zotimin. Për këtë u bindëm gjatë ditëve të mëvonshme, duke i parë në valën e punës, tek çanin shkëmbinjtë për të hapur rrugën.

— Sa e realizoi normën skuadra juaj dje? — e pyetëm Shpëtimin.

— 115 përqind, — na u përgjigj ai pa e ndërprerë punën.

— Skuadra jonë do të punojë me të gjitha forcat dhe do ta kryejë para afatit të caktuar detyrën e ngarkuar — shtoi përsëri ai.

— Do të marrim flamurin e brigadës, shton një tjetër.

— Por jo duke soditur natyrën, ama, — e thumboi duke qeshur një e re.

— Nuk ka dhe aq faj, se natyra e Vermoshit të magjeps me bukurinë e vet, thotë një tjetër — Por xhadeja që po përfundojmë do ta bëjë edhe më të bukur këtë krahanë. Ja, drejt Vermoshit po shkojnë paralel rruga dhe kanali i hidrocentralit, — dhe bën me shenjë drejt kanalit të

betonuar që çan buzë xhadesë së re, me gjatësi prej 1300 metrash.

Vazhdojmë rrugën më tej. Në një faqe shkëmbi të thepisur, që ndoshta është pjesa më e vështirë e kësaj rruge, takojmë brigadën e Dukagjinit. Midis tyre më tërheq vëmendjen një malësor rrëth të tetëdhjetë vjetëve. Të bën përshtypje me të vërtetë ky plak që punon krah për krah 137 të rinjeve. Por xha Zefi ta shuan kureshtjen me përgjigjen e tij të vendosur, që buron nga zemra e tij.

— Si të mos vija këtu, mor bir?! Mos të shkon mendja se rinia ma kalon mua?!... Sa mora vesh se xhadeja duhet të përfundojë përpëra ditëlindjes së Enver Hoxhës tonë të dashur, u nisa me djelmoshat.

— E kemi punëtor të palodhur xha Zefin — ndërhyjn në bisedë komandanti i brigadës, Gjergji, — Dimrin që kaloi, duke punuar nëpër dëborë, ai hapi tre dynymë tokë të re për koperativën tonë. Të 140 metrat e rrugës shkëmbore që na janë besuar do t'i përfundojmë këto ditë.

— Besoni se e përfundoni në një afat të tillë? — e pyesim me një farë mosbesimi, duke patur parasysh vështirësitë e asaj pjese të rrugës.

— Do ta mbarojmë patjetër. — Përgjigjet i vendosur xha Zefi.

Pak më tej, një i ri i mbushur në djersë, godet me vare barominën. Shoh një të re, Marijen, tek gérmon me vrull. Kur e pyeta pse punon me kazmë e jo me lopatë, ajo ma priti me vendosmëri, gjithnjë duke punuar:

— Ne jemi mësuar dhe s'na bën përshtyp-

je kazma. Shoqet që punojnë rrreth saj, e aprovojnë me kokë.

— Para një javë keni bërë një punë mjaft të mirë, i them Marijes, duke prishur një fejesë të lidhur padrejtësisht, por po më bie në sy diçka tjetër... Nuk kini hequr akoma veshjen e rëndë. Fytyra e bukur e Marijes skuqet.

Ndërhyn duke qeshur komandanti i brigadës, Zef Lleshi:

— Ne kemi marrë një vendim dhe deri më 1 tetor do ta zëvendësojmë veshjen e vjetër. Ja kemi filluar me kohë kësaj pune dhe kemi mjaft rezultate.

— Si thua, Marije, a do të kthehet në shtëpi me veshje të re?

— Po he burrë, si një e një bëjnë dy! — thotë Marija.

Ecim në xhadënë e porsahapur, midis vullnetarësh. Edhe e reja e fabrikës së qelqit, Liljana, siç duket, ka shumë punë. Ajo shkon sa në një-rën brigadë në tjetrën dhe mban shënimë. Nganjëherë duket e menduar, e shqetësuar. Liljana qenë tri herë në aksionet e rinisë, por njihet vetëm kazmën e lopatën. Këtë radhë ndryshon puna: ajo është komisare e aksionit dhe e ndjen thellë përgjegjësinë e madhe që i është besuar. Ja, vullnetarët kërkojnë t'u sigurohet shtypi, ose «ushqimi i shpirtit», siç thonë ata. Dhe Liljana bën çmos për t'u krijuar vullnetarëve të gjitha kushtet e edukimit e të argëtimit. Ajo ka besim në forcat e saj, ashtu siç ka besim të patundur edhe komandanti i aksionit. Jordani, se xhadeja do të përfundojë në kohë. Ky është besimi dhe premtimi solemni i të 1400 të rejave dhe të rinjve aksionistë

të Malësisë së madhe. Vetëm Saliu është i shqetësuar këto ditë. Ai qe i pari që shkeli me «Zisin» e tij, një vit më parë, mbi xhadënë e re, gjer në Leqet e Hotit. Tani ai kalon për ditë mbi këtë rrugë, dhe ka shkuar shumë më tej, deri te Qafa e Bordolecit.

— A do të kem fatin që «Zisi» im të shkelë i pari edhe të tri km. e fundit, gjer në Vermosh? — pyet Saliu, dhe shton me një gëzim të papërmbaritur: Pastaj, unë do të jem njeriu më i lumtur!

*Marrë nga «Zëri i rinisë»  
18 shtator 1968*

## U KTHYEN VULLNETARET!...

Një djalë i vogël bërtiti:

— Ej, erdhën vullnetarët!... — Një ushtri e tërë fëmijësh u turr mbas tij drejt maqinave. Zhurmë. Të thirrura. Brohoritje. Dëgjohej këngë e vullnetarëve. Thirrmat e tyre: «Urra!» Fjalë nënash të thëna përgjysmë...

Sy kureshtarë.

Xha Tajari është minatori i vjetër dhe i dalluar.

I erdhi djali, Asqeriu. Xha Tajari rrudhi vetullat. Në gjoksin e Asqerit s'dukej asnje «S».

— Sa «S» more? — pyeti si me inat e me qortim.

— Tri. Asqeriu zbërtheu bluzën.

I jati qeshi. E kapi për dora dhe u shtynë pak më tej. Unë u habita me takimin e tyre. Ata sikur ishin parë dhe një ditë më parë... babë e bir, minatori dhe djali i tij vullnetar.

— Zbërtheje bluzën fare! — tha pas pak xha Tajari...

— U, sa qenke rritur, moj bijë!... — dëgjova një zë.

— Posi, nënë, puna të forcon, të jep shëndet.

Në këtë valë përqafimi e gëzimi, marrin pjesë minatorë që presin djemtë apo vajzat, hijerëndë. Gëzimi i tyre është i qetë, i thjeshtë, gëzim që i ngjan lules që do të shpërthejë, gjithmonë i freskët... Në këtë takim dashuria e zemrave derdhet lumë. Kanë kaq shumë për t'i thënë njëri tjetrit... Vullnetarët duken të gëzuar. Sikur kanë sjellë me vete agimet e bukura të alpeve, freskinë e pyjeve. Duket sikur derdhen në sytë e tyre ujërat e kaltra të përrrenje malorë. Sikur kanë sjellë me vete sulmet e përditshme, vrullin, përpjekjet, shqetësimet e punës, netët pa gjumë kur mendonin për flamurin ose ... vijën e kufirit. Po, vijën e kufirit. Jeta jonë është «punë dhe mbrojtje»! Parulla jonë është: «Në një dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën!».

Ata duken si një stinë pranvere, të fortë, të çelur në ftyra, të rrahur në një muaj e gjysmë punë.

— Po si kalove, mor Kaçi?

— Hata! E morën flamurin! — thotë Kastrioti, që i thërrasin shkurt Kaçi, pa e hequr çantën e aksionistik nga supi.

— S'të pyeta për flamurin, por për shëndetin.

Nejse, rëndësi ka flamuri. Hë, e morët dome-thënë!... Ja dhe xha Vangjeli, po vjen me nxitim.


— Mirë se ardhët, bij! — Ai i takon të gjithë me radhë, i njeh ata. Lejen e zakonshme atje e kaloi, me punë, midis vullnetarëve, në ndërtimin e rrugës së Malësisë të Madhe.

Kur kishte ikur e kishin përcjellë me një dashuri të pakufi.

— Të merrni flamurin! — u kishte thënë.

— Pa flamurin mos hajdeni! — këtë porosi kam...

Dhe ja, u takuan sërish, fitimtarë. Mbi kryet e tyre flamuri rreh palët.



Çadrat e vullnetarëve në mes të bjeshkëve

Nga bisedat e shumta munda tē kap këto fragmente:

«Ditët e para tē punës s'arrinim dot normën. Ladheshim, duart na dhimbnin e prapë s'arrinim rezultat. S'ishim tē qetë. Ç'të bënim? Një ditë po rrija mbi një shkëmb dhe shikoja pejsazhin e gjelbër, reliefin e thyer tē maleve. Era sikur më futej në shpirt e më gjallëronte, më freskonte mendimet.

Erdhi Asqeriu me Mirën. Do tē bëjmë mbledhjen e organizatës.

Atë natë qëndruam gjatë. Na vinte turp. Çdo ditë viniin letra nga prindërit, megjithëse s'kishim shumë që ishim larguar:

«Si vete puna...? A keni bërë ndonjë copë rrugë...? O burra! — Filan minator 200 përqind, po ju?... Filan vagonist kaq përqind... Sa «S» ke marrë?...

Këto letra sikur binin me vete kritikën e etërve. Ne s'na mbante dheu.

Në mbledhje, e para u ngrit Atemja. — E po çfarë, shokë, kështu do tē vazhdojmë? Jemi dhe bij minatorësh... Prindërit presin shumë nga ne... Le tē punojmë «një për tē gjithë e tē gjithë për një» — buçiti papritur zëri i saj. U ngritet dhe tē tjerë.

Unë rrija dhe dëgjoja. Ditët e para s'kisha punuar dhe aq mirë. Më vriste ndërgjegjja. Më dukej sikur shokët flisnin për mua, megjithëse emrin s'ma zunë në gojë, sikur më kritikonin ashpër. Trupi sikur më mori flakë. Jam dhe i gjatë. Të paktën tē isha i shkurtër, s'do tē bija në sy. Po

ke parë ti, një e dy, e shokët thoshnin: — Ja zgallua, rri! — Kurse unë sapo ulesha.

Sos kishte dhe ndonjë vrimë të futesha...

— Posi! — thashë në fund të mbledhjes, paditur as vetë se si më shpëtoi kjo fjalë. Unë mendova se fola sa për vete, por fjala vajti dhe në veshet e të tjerëve.

Shokët sikur u drodhën nga gjëmimi i zërit tim.

— Çfarë, posi?...

— Ja, duhet të marrim flamurin!

Të nesërmen parulla e punës ishte: një për të gjithë e të gjithë për një! Punuan me vrull. S'e ipnim veten. Malet sikur na shikonin ne me kryet ende të zbardhur nga dëbora, mbështjellë me re të hirta. Shkëmbinjtë dukeshin të patundur, sikur na tallnin. Por jo. Ne duhej të hapnim rrugë midis atyre shkëmbinjve. Forca sikur na buronte çdo çast. Ku e gjenim atë forcë?... Kapnim qysqi, vare, baromina me një lehtësi të çuditshme. Punonim jo me duar, jo me forcën e trupit, por me forcën e shpirtit tonë. Kjo qenka më e fortë se çdo forcë! Pak më tej punonte Kujtimi. Jepte e merrte me një copë shkëmb. — Prit! — i thashë. Kjo punë do burra, jo shaka. Dhe ngrita grushat lart, nxora gjoksin për të treguar fuqinë time prej «Herkuli»... Ai qeshi. U tall me mua një copë herë. Filluan. Guri lëvizi. U rrukullis dhe në buzë të greminës ngeci. Vajta dhe më gjithë forcën e krahëve e shtyta. Ai ra, por dhe pak më mori me vete...

Shokët më kapën vetëtimthi.

— Ç'bën?! — më thanë të trembur.

Fryma sikur u kishte ikur... I pashë në sy. Zemra më rrihte fort. Ata sikur dridheshin. Ishin më të trondititur se unë. U skuqa. U turpërova me «forcën» time.

— Jo, mor, thashë, — desha të shikoja se ku do të binte shkëmbi... Është thellë! — shtova mbas pak.

Atë ditë vajtëm 204 përqind. Dhe kështu vazhdoi çdo ditë.

Unë s'imburresha më me «forcën» time. Punoja në heshtje dhe mundohesha të mos bija në sy. Por jam i gjatë.

Ata më thërrisin shpesh. Ej, zgallo, jepi!... Dhe hapëm gjithë atë rrugë!...

Parulla jonë «Një për të gjithë, e të gjithë për një!» na ishte ngulur në mendje... E çuditshme kjo parullë!...

... U sëmura. Më dërguan në Shkodër. Por mua më dukej vetja mirë. Çdo çast më vriste, më torturonte qetësia. Hsj dreq, o punë!...

— S'kam ardhur për të ndenjur shtrirë — i thashë një ditë doktorit — Dua të iki, nxirimëni!...

Ai më ledhatoi flokët.

— Qetësohu, vogëlush! — më tha me një zë të butë, 'atëror.

— O, më quan dhe vogëlush, pa le! Shokët punojnë, unë rri!...

Më vinte inat me veten. Po si dreqin u sëmura?! Qenkam dhe vogëlush!

Çdo mëngjes më kujtoheshin fjalët e xha Va-

ngjelit që na i kishte thënë një mbrëmje në kapanon:

«Bijtë e mi... koha rrjedh, rrjedh si ai lumi. Nxiton i krah saj që të mos u lërë prapa...».

I lutesha doktorit çdo ditë. Nxirrmëni! — i thosha.

— Duro, nesër...

Po këto «nesëre» u bënë shumë. Kaluan 13 ditë. Më nxuarën. Më prenë biletë për në shtëpi. U habita.

— Pse?!

— Clodhu! — më tha një burrë i gjatë me syze. Më nisën. I zbrita autobuzit në mes të rrugës.

— Mirë u pafshim! — i thashë shoferit që kishte porosi të veçantë për mua. I hipë një makinë që shkonte për në Lepushë. Shoferi i autobuzit u çorodit. Unë qeshja. I tunda dorën në shenjë lamtumire.

— Ku do të vesh? — më tha.

— Tek shokët.

Dhe u ëktheva. S'kishte se si. Rruga do mbaruar... Punova dhe ja, jam si kokrra e mollës. M'u hap oreksi. Shtova 3 kile!...

Sa histori të tillë ka! Çdo vullnetar ka jetën e vet të veçantë, e pashtëputur kjo ngajeta e përgjithshme. Ai ruan mbresa dhe kujtime që koha s'do t'i shlyejë dot.

Dallandyshja, Vasili, Mira, Kujtimi...

Sa gjëra të çuditshme mund të tregojnë ata...! Jeta jonë është luftë, aksion i vazhdueshëm...

← Rinia jonë s'është rini e qejfeve, e rehatisë. Rinia jonë është rinia e punës, e përpjek-

jeve të përditshme, e aksioneve, e përleshjeve me vështirësitë e panumërtë. Rinia janë është rinia e librit, e kazmës dhe e pushkës, është rinia e mendimit të pastër revolucionar...»

Këto fjalë tha drejtori i shkollës, Hamdiu. Vullnetarë e prindër, minatorë të serës janë mbledhur në sallën e kinemasë. Dëgjojnë. Stuhia e duartrokitjeve shpërthen. Brohoritje. Muret sikur tunden.

— Ju, prindër, bëtë revolucionin nën udhëheqjen e partisë dhe të shokut Enver.

Ju na e çliruat Shqipërinë. Ju na edukuat me frymën e luftës partizane, na ushqyet me dashurinë për partinë. Ju na thatë sa e shtrenjtë është liria, sa i shtrenjtë është vatani. Ju na treguat për dëshmorët e luftës, shokët tuaj!... Ne do të ecim në gjurmat tuaja, nën flamurin e madh të partisë mëmë.

Do të mësojmë, do të punojmë, do të ndërtojmë! Do të hamë dhe barot me grushta, por s'do të jepemi!...

Shqipëria është jona. Ne jemi të Shqipërisë, të partisë!

Kështu përshëndeti vullnetarja Ateme. Këto janë fjalët e shoqeve dhe shokëve të saj, ky është betimi solemn i rinisë sonë. Emocionet i kanë mbërthyer të gjithë.

Shkëputet dhe ndonjë lot... Njerëzit dëgjojnë. Zemrat sikur u ngrihen peshë. Në sallë sikur fryn fllad aksioni, fllad rinie. Duket sikur u ripërtërinë rrështat partizane...

U ngrit xha Vangjeli. Shtabi i sektorit i kishte dhënë atij tri «S».

Kokat e njerëzve u drëjtuam nga ai. Të gjithë e dinë se xha Vangjeli mori pjesë në aksion së bashku me të rinjtë.

Eshtë i thinjur, plak, por tërë gjallëri dhe energji.

— Bijtë e mi — nisi të flasë ai ngadalë, me një zë që dridhej lehtë nga emocioni.

— Ju jeni të lumtur, shumë të lumtur! Na pyesni ne, baballarët tuaj, se si ka qenë rinia jonë,jeta jonë. Partia na pruri gjithë këto të mira...

Të mos e harrojmë të kaluarën! Të mos harrojmë luftën e partizanëve trima. Të mbajmë lart amanetin e dëshmorëve tanë që Shqipërinë ta bëjmë të fortë, të begatshme.

Këto fjalë të thëna thjesht e pleqërisht bien thellë zemrave tonë, na emocionojnë.

Të gjithë u ngritën në këmbë. Shpërtheu kjo brohoritje:

«Parti, Enver, jemi gati kurdoherë!» sintezë e revolucionit tonë socialist. Vullnetarët marrin këngën e tyre të dashur:

Erdh Enveri kah Malësia...

Melodia e ngrohtë e kësaj kënge gurgullon që nga thellësia e zemrave të të rinxve.

Atë natë qytati s'kishte qetësi.

Njerëzit venin e vinin. Një bukurie rrallë mbulonte qytetin. Atij sikur i qeshte nuri. Vullne-

tarët ishin kthyer fitimtarë. E kishin marrë flamurin!

Çdo minitor belbëzonte ngrohtë:  
— Ju lumtë!

*Marrë nga «Zëri i Rinisë»  
11 shkator 1968*

## **QESH MALESIA, QESH MALESORI!**

### **1. Pak histori**

Mars 1967. Kelmendit i lindi një vajzë. E përshëndetën këtë lindje, ashtu si është zakoni i këtyre anëve, me krisma, krisma që çajnë lugina e shpate, të cilat u përhapën pyjeve e kodrave, duke lajmëruar mbarë botën se malësisë i lindi një vajzë, se lindi bija e pesëvjeçarit, rruga e Malësisë së Madhe. Ishte kjo bijë e pesëvjeçarit si një arter i fortë jetëdhënës për malësinë. Rritej ky arter jo me vite, jo me muaj, por me ditë.

Fillim marsi ishte atëhere, kur në shtigjet e malësisë ëjehoi për herë të parë kënga vullnetare.

Disa qindra ishin ata që u përleshën të parët me shkrepat e Kelmendit. Iшин nga rrrethe të ndryshme të atdheut, të rinj e të reja punëtorë e fshatarë, bij të revolucionit. Ndërgjegjja e tyre revolucionare kalitej në përleshje dhëmb për dhëmb me shkëmbin, shiun apo erën.

Qetësia u prish në malësi. Gurgullimës monotone të përrrenjve ju shtua melodja e këngës rino-re, zërat gazmore të vullnetarëve, goditjet e kazma-

ve, barominave, lopatave, oshëtima e minave. Ikën të parët, por erdhën mijëra të tjera. Erdhën nxënesit, erdhën studentët, erdhën ushtarët. Më mirë të pyesim kush nuk erdhi. Të gjithë erdhën, Erdhën nga Korça e Tirana, Durrësi e Vlora, Lushnja e Berati, nga e gjithë Shqipëria. I njëjti vrull e optimizëm i karakterizonte të gjithë. Rruga zgjatej, zgjatja e saj shpejtonte lulëzimin e malësisë, vdekjen e prapambetjes. Makina trokiste në dyert e malësisë, me tingullin kumbues të burisë përshtëndeti ajo në fillim Grabonin, pastaj Tamarën, Selcën... e shpejt Vermoshin.

Qesh malësia. Rruga solli dritën, drita mposhti errësirën. Këto ja dhuroi partia malësisë.

## 2. Qytezat vullnetare

Lindën ato, njëra mbas tjetrës. Ndoshta jetuan pak kohë, por secila shkrojti brenda kësaj kohe në almanak historinë e saj, një histori pune, djerse, gëzimi. Në malësi çdo fshat, çdo kodër, çdo gur ka një histori, por historia e qytezave vullnetare ka diçka të veçantë, ajo ka bukurinë dhe romantikën e vet, romantikën e njeriut tonë të ri. Në atë lëndinë të vogël buzë Cemit kaltërosh, që taniduket si e shkretë, muaj të tërë rrahu me forcë një zemër e madhe, zemra vullnetare. Grabon quhet ky vend. Për muaj me radhë emrin Grabon e dëgjoi i madh e i vogël.

Rruga kalon mbi urën e Tamarës. Në almanak u shkruajt dhe historia e re e urës, se ura ka dhe

historinë e saj të vjetër. Historia e re është më e madhërishme se e vjetra.

Dikur, sipas legjendës, dasmorët e ndërtuan këtë urë që të kalonte nusja, sepse sipas zakonit nuk duhej që t'i lageshin këmbët. Kështu thotë legjenda. Po le të shikojmë legjendën e re, legjendën e kohës sonë. Mbi atë urë, supat e shokëve ju bënë urë shoqes së sëmurë rëndë, ju bënë urë në emër të jetës. Një lapidar shtrihet ndanë rrugës. Aty është vrarë Nora, kreshnikja e Malësisë. Era e ftohtë, shiu, bora, breshëri e dielli përkëdhelin çdo stinë lapidarit. I përulen këta trimërisë në shenjë nderimi. Aty brigadat vullnetare të Universitetit u kacafytën për dy muaj me shkëmbin, duke realizuar normën 133 përqind. Natë. Një krismë e thatë çau ajrin. Alarm. Diku në sektor ka rënë zjarr. Lodhja e ditës e dëshira për të fjetur u imposhtën nga dashuria për pronën sociale. Të gjithë rrëmbyen kazma, lopata e çfarë të gjenin dhe u sulën tek vendi i zjarrit. Dhe historia vazhdon. Ajo do të përfundojë më 16 tetor në Vermoshin e largët.

### 3. Vazhdimësi vullnetarësh

Shqipëria socialiste është kthyer e gjitha në një kantier ndërtimi. Kudo në hekurudhën Rrogosjinë-Fier, në Vaun e Dejës, në rrugën e Malësisë së Madhe apo në kooperativat malore, orteku i vulltarëve vërshon i pandalshëm, duke rrëmbyer e flakur tej me forcë çdo zakon prapanik, çdo mbeturinë të mykur, gjithshka që ka të bëjë me pra-

pambetjen. E ky ortek vullnetarësh, nuk do të ndalet asnjëherë. E tillë është koha në të cilën jetojmë, kohë heroike, që lind heronj që bëjnë mrekullira.

- Hej! A kemi për të ecur akoma?
- Ku do të shkoni? Në Vermosh?
- Kemi dhe pak!
- Nga jeni ju?
- Nga Tirana.
- Nga Durrësi, Lushnja, Vlora etj.

Qindra ikin, qindra vijnë. Turnet ndërrohen, rruga i afrohet finishit. Rinia është gurre e pashtershme për aksionin.

#### 4. Vullnetarët ushtarakë

Minaaa! Pastaj një e shtënë pushke. Sinjali u dha. S'kalon shumë kohë dhe gjëmime të fuqishme tundin luginën. Në këtë pjesë të rrugës punojnë vullnetarët ushtarakë. Janë këta efektivë të reparteve të ndryshme, të shkollës «Skënderbej» dhe kursantët e repartit «N». E kanë treguar ata veten e tyre sa e sa herë në stërvitje, po e tregojnë edhe një herë në aksion, në rrugën e Malësisë së Madhe, në përlleshje dhëmb për dhëmb me shkëmbin. Makina ndalon para një grumbulli të madh shkëmbinjsh të thërmuar e dheu.

Kur e shikon nga karroceria e makinës, grumbulli të tremb, të duket si një përbindsh që do të imposhtë muskujt e bronctë të vullnetarëve ushtarakë. Por jo, syri gabon. Vullnetarët sulen si skifterë mbi grumbull. Kënga e rregullt e kazmave dhe

lopatave dëgjohet gjer larg. Aty ku pak më parë mbizotëronte dheu, rruga shtron pamjen e saj të plotë.

## 5. Kthesat tona

Kështu i quajtën kursantët e repartit «N»... kthesat që ju besuan për t'i zgjeruar. Janë që të gjithë djem të rinj. Sapo kanë dalë nga bangat e Universitetit. Së shpejti, mbasi të kryejnë detyrën ushtarake, ata do të ecin me hapat e tyre në jetë.

Kur i njoftuan se do të shkonin në rrugën e Malësisë së Madhe për të punuar, të gjithë u gjuzan. Shumë prej tyre kishin punuar dhe vitin e kaluar në këtë rrugë, e njihnin malësinë me natyrën e saj burrërore, e prapë gëzoheshin.

Gëzoheshin me të drejtë. Do të kalonin në rrugën e hapur më parë nga ata vetë. Gëzohej Zekua, Xhela, Zijai, Haxhiu, Mitati, Bashkimi, etj. Të gjithë gëzoheshin. Malësia i ftonte në gjirin e saj.

Puna me kthesat është e vështirë. Ajo kërkon durim, forcë e zgjuarësi. Një pakujdesi e vogël mund të shkaktojë më vonë katastrofë automobilistike, prandaj kursantët punojnë me shumë kujdes. Kthesa e dytë është shumë e ngushtë, prandaj togës së parë që punon aty i del si detyrë të ndërtojë një mur të jashtëm rrethues.

Ditët kalojnë dhe muri fillon të marrë formën e tij. Në fund kursantët filluan mbushjen.

Gati për ditë në malësi bie shi, por ky nuk i pengon të rintjtë të punojnë me forca të shumëfishuara. Aksioni është një shkollë e madhe edu-

kimi për kursantët. Në punë e nëpërmjet vështirësive ata rrisin ndërgjegjen revolucionare.

— Hej, shofer, kalo pa frikë, kthesën merre me herë të parë — thotë Fatmiri.

Shoferi i gazit e merr kthesën menjëherë. Ai kalon pa droje në kthesën e sapondërtuar. Ai ka besim të madh tek vullnetarët.

Këta të rinj, që e kanë treguar sa e sa herë veten nëpër aksione, po e tregojnë edhe këtë herë.

## 6. Një marshim

— Do të shkojmë në Vermosh! Të gjithë i gëzoi ky lajm. Secili nga kursantët kishte shumë dëshirë të shikonte pikën më veriore të atdheut tonë. Disa çaste para nisjes ndodhi diçka që ua shtoi humorin kursantëve.

Guzhinieri mundohej t'i mbushte mendjen një shoku, që i dhimbte ca këmba, ta zëvendësonte në guzhinë.

Bernard, ty të dhemb këmba, mos shko, rruga është e gjatë dhe e lodhshme.

— E pastaj, çfarë?!

— Si çfarë?! Ti nuk mund të ecësh. Më mirë qëndro në guzhinë.

Marshimi ishte me të vërtetë i vështirë, por kurkush nuk trembej nga kjo. Ky ishte për ta një marshim i vërtetë ushtarak. Do të ndiqej ky itilherar: Selbë-Javor-Leshnicë-Bashkim - Vermosh-Budaç-Prodolec-Grabor e Selcë.

Gjithsej rrëth 40 km. Kur dolën në majë të kodrës, poshtë shtrihej një pamja e mrekullueshme.

— Ja Vermoshi! — tha komandanti.

Poshtë, në lugine, shtëpitë si kutiza të bardha shtriheshin pranë njëra-tjetrës. Gjelberim dhe bardhësi, dy ngjyrat që karakterizonin këtë fshat kufitar.

Filloi zbritja. Edhe kjo kishte vështirësitë e saj. Përsëri kolona e gjatë e uniformave jeshile gjarpëronte shpatit. Mbas disa minutash kolona hyri në fshat.

Vermoshi, ky fshat i bukur dhe pjellor, ka hyrë në vitin e dytë të jetës kolektive. I gjetëm kooperativistët në valën e punës, valë që përfshiu dhe kursantët e repartit «N»... Ata, pa marrë para-sysh lodhjen e marshimit, filluan të ndihmojnë kooperativistët në vjeljen e kumbullave. Në Vermosh ato piqen me vonesë, për shkak të klimës.

Pastaj marshimi vazhdoi më tutje. Në qendër të fshatit kursantët ndaluan para shkollës.

Njeri prej vullnetarëve para pësë vjetësh ka qenë arësimtar në këtë fshat. Tani ai vë re shumë ndryshime. Ka ndryshuar fshati, kanë ndryshuar edhe njerëzit. Ish-nxënësit e tij tashmë janë rritur.

Ja një prej tyre. Ai takohet me mësuesin. I tregon atij se tashmë ai është mësues në fshat. Sytë u shkëlqejnë të dyve nga gjëzimi. Pranë shkollës ngrihen krenarë tre lapidarë. Trupat e tre martirëve shtriheshin në ato varre. Ata flenë të qetë, se ëndërrat e tyre po bëhen realitet. Vermoshi po lulëzon nga dita në ditë. Në Vermosh do të vijë rruga automobilistike, në Vermosh do të vijë drita elektrike, drita që ja dhuroi partia.

...Mbas pushimit filloi përsëri marshimi.

Kthimi u bë nëpër një rrugë tjetër. Disa herë qëlloi që kolona të kalonte dhe në rrugën automobilistike, të kalonte në monumentin e madh të vruillit rinor.

Në afërsi të Budaçit marshimi ndërpritet.  
— Minaaa...

Oshëtijnë luginat me gjëmime të mbytura. Shkëmbi i madh i Budaçit kalon çaste agonie. Mbi copat e thërmuara vërsulen vullnetarët. Edhe kjo pjesë e vështirë së shpejti do të përfundohet.

Kolona hyjnë në sektorin e Prodolecit. Diku në qendër të sektorit dëgjohet një fizarmonikë. Vullnetarët lushnjarë kanë mbasdite tematike. Më tutje një grup lexon gazeten. Secili merret me diçka. Ky është një pushim aktiv i vullntarëve.

Marshimi i kursantëve po i afrohej fundit.

## 7. Të gjitha forcat për 16 tetorin

16 tetori po afron. Është dita e jubileut të 60-të të ditëlindjes së shokut Enver. Në këtë ditë të gjuar në fushat e Myzeqesë fishkëllima e trenit do të çajë hapësirat duke lajmëruar se lokomotiva e parë hyri në hambarin myzëqar.

Më 16 tetor nga Hani i Hotit deri në Vermoshin e largët nuk do të ndihet më kumbimi i ziles së mushkave.

Qesh malësia, qesh malësori. Ditë të lumtura erdhën për malësinë.

...Një vrull i paparë revolucionar i ka përfshirë vullnetarët e turnit të fundit.

Në Vermosh punojnë vullnetarët e Tiranës.

Ja vajzat e artistikes «Migjeni», vajzat duararta, ato që nxjerrin nga duart e tyre mrekullira. Tani ato shtérngojnë fort kazmat e varetë.

Më tutje punojnë të rejat e Kombinatit të Tekstileve «Stalin», të rejat që endin lumturinë me duart e tyre; tani ato endin lumturinë e mälësisë.

Gjithshka për 16 tetorin! Kjo është parulla e vullnetarëve. Këtë zotim i dhanë shokut Enver vullnetarët kur shkoi në Gradishtë. E fjalën e dhënë ata do ta bëjnë realitet. Ata patjetër do ta dorëzojnë rrugën më 16 tetor.

*Marrë nga «Zëri i Rinisë»  
25 shtator 1968*

## KELMENDI NË FESTË

Dikur, jo shumë kohë më parë, të udhëtoje nga Shkodra për në Vermosh, ose të zbrisje nga Vermoshi në qytet, të duheshin të paktën dy ditë.

— Po sot?... Shkon brenda ditës!

Unë sot po kaloj në rrugën e ndërtuar nga rinia.

Gëzimi që ndjej është i madh. S'është vetëm rruga, e maqinës që më gëzon kaq shumë.

Ja!... Shikoj si ndrisin shtëpitë e malësorëve nga drita elektrike. Pas pak kohe do të ndriçojë i gjithë Kelmendi.

Në çdo fshat të Kelmendit, shikon fëmijët malësorë që nisen drejt shkollës. Disa zbresin tatëpjetë, të tjerët ngjiten si alpinistë të vegjël, asnjë s'mbetet pa shkollë.

Ja, edhe dy shkolla të reja 8-vjeçare u hapën sivjet në Lepushë e Brojë! Të gjithë i ndjekin rregullisht. Ky është një gëzim i madh, ky është një kujdes atëror i partisë për malësorët.

## Me vullnetarët në rrugën e malësisë

Kohë e keqe. Shi. Të ftohtë. Bie buria e zgjimit. Të gjithë ngrihen. Lahen në ujin e ftohtë të këtyre bjeshkëve. Hanië mëngjezin. Rrjeshtohen!... Nisen drejt punës me kazma e lopata në dorë dhe kënga ushton drejt majave më të larta. E këto maja, si radiostacione të fuqishme, përhapin gëzueshëm rezultatet e punës së vullnetarëve. E malësori i vogël, me zërin e çiftelisë, lajmëron. Kelmendi në festë!...

Të gjithë shpërndahej, puna fillon. Të ftohtit e shiu s'kanë q'na bëjnë. Ne jemi vullnetarë, s'duam t'u dimë vështirësive. Zotimi ynë duhet të realizohet. Maqina në Vermosh duhet të shkojë para afatit.

— Hej, çuna!... Përpara!... Kujdes shkëmbi! Kujdes, o Zef!... sigurohu...!

Puna vazhdon me vrull revolucionar. Pushoni! — u dëgjua zëri i një vullnetareje. — Le të kalojë ky xhaxhua.

Binte shi. Me një çadër në dorë po kalonte një plak. Pa u afruar tek shkëmbi u ndal. Vështroi disa herë.

Sytë i shndritën nga lotët, ai buzëqeshi. Ne u çuditëm, ju afruam dhe e pyetëm:

— Ju them të drejtën, kurrë nuk e besoja që rruga të kalonte kaq shpejt në Vermosh — tha ai, dhe shtoi: Mos ma vini re se nga gëzimi të dalkan edhe lotët më shpejt.

— Shikojeni atë vend aty afër, jo shumë larg jush! Orteku i borës më rrëmbeu atje djalin dhe nusen e djalit. E, sa kemi vuajtur këtyre anëve!

Kur sëmurej njeriu, duhej të udhëtonim ditë e natë për ta dërguar në spital. Të rrojë partia e shoku Enver, e ju, o djem e vajza të mia, që na sollët rrugën e maqinës e bashkë me të dritën elektrike, dritën e partisë në këto vende të largëta!

Ai heshti dhe u largua. Puna filloi më me entuziazëm e me vrull revolucionar.

### Minatori alpinist

E cili nuk e njeh ushtar Zefin?

Atë e njohin me qindra të rinj e të reja vullnetare, që kanë punuar e punojnë në rrugën e Malësisë së Madhe. Të gjithë e duan dhe e rapspekojnë. Ai është i thjeshtë, i dashur me shokët; punëtor, guximtar. Zefi është minator e kohët e fundit alpinist i mirë.

Edhe pak metra na ndamin që të përfundonte rruga dhe maqina të shkonte në Vermosh.

Jo më shumë se edhe dy ditë, sipas zotimit, rrotat e maqinës do të përshkonin luginën e Vermoshit. E kjo do të qe fitorja më e madhe. Se cili bisedonte, mendonte për të nesërmen, që ishte shpallur ditë sulmi. E këto fjalë i ranë në vesh edhe Zefit, minatorit të palodhur të rrugës së malësisë.

Ai mendonte i qetë se si të vepron. Shkëmbi është i vështirë. Duhej të hapeshin vrima për të bërë plasje, që shkëmbi të hidhej në erë sa më parë. Ja, edhe kjo do të bëhet.

Po si do të ndizen minat? këtë pyetje e bënta

secili. Të gjithë ishim grumbulluar pranë shkëmbit ku do të punonim. Po Zefi?... Ku është?...

E ndjenim mungesën e tij. Ndoshata do të kishte shkuar të bënte plasje me ndonjë brigadë tjetër!.

— Ja, po vjen!

Fytyra i buzëqeshte... Të gjithë e vërenim. Në dorë mbante një litar dhe në krah kishte hedhur çantën e shpinës. Ne u çuditëm kur e pamë me litar në dorë. «Edhe shkëmbin do ta hedhim, e nesër maqina mund të kalojë». Kjo qe fjala e tij e parë e atij mëngjezi të tetorit.

U ngjit. Siguroi litarin dhe zbriti që të sigronte shokët.

U ngjitëm njëri pas tjetrit dhe vazhduam punën.

Mbasi i luhëzoi se ku do të hapnin vrimat, ose më mirë të themi kanalin në shkëmb, zbriti duke u thënë: kujdes, se mos bini poshtë!

Poshtë po bisedonte me komandantin se si do të ndizte minat.

— Është vështirë të ndezësh minat, o Zef, — u dëgjua zëri i komandantit. — Jo, shoku komandan, — tha Zefi — edhe këtë gjë e kam menduar...

— U bë gati për mina — thanë shokët, që po punonin sipër shkëmbit.

— Zbrisni, po me kujdes — tha Zefi. Ata zbritën e vendin e tyre e zunë dy minatorët Zefi dhe Samiu.

Ne shikonim nga poshtë. Sipër, mbi shpinë të shkëmbit, ata vazhdonin punën.

— Mi-nat!... u dëgjua zëri i tyre. U dha sinjali.

Në këtë kohë Zefi po pregetitej të ndizte

minat dhe të shikonte vendin se nga do të zbris-te më lehtë.

Ne u larguam, por mendjen e kishim te minatorët.

Prisnim me padurim. Minat u ndezën.

Zefi po zbriste me litar duke thirrur me të madhe: Mi-naat...!

Ai nuk e humbiste vemendjen edhe pse vetë ndoshta ishte në rrezik. Ai mendonte për shokët se mos ishin afër e u ndodhë ndonjë gjë.

Zbriti me guximin më të madh, sikur të ishte alpinist i regjur.

Minat filluan të shpërthejnë.

Ne numëruam: një... dy... gjashtë... Po një? Për disa sekonda s'po përbaheshin. Dhe ja,... shtatë!...

— Të lumtë, o Zef, sa bukur i paske ndezur!

Mbas dhjetë minutave u nisëm drejt shkëmbit.

— Ja Zefi... thirrëm të gjithë. Ai ishte af-ruar aty me një barominë të gjatë në dorë dhe po bënte kontrollin.

Pamë Zefin e djersitur dhe shkëmbin e mundur.

Ai buzëqeshte. Kishte të drejtë. Të gjithë e përqafuam dhe e falënderuam.

## Nesër maqina e parë përshkon luginën e Vermoshit

Ruga është mbushur me vullnetarë. Kënga e tyre përhapet në luginën e Vermoshit. Lajmëron diçka... Çfarë?!... Nesër vuilnetarë dhe malësorë do të përhëndesin makinën e parë. Ç'realitet i bukur i ditëve tonë!

Entuziazëm, gjëzim, e çfarë nuk shprehin këta vullnetarë, këta ndërtonjës të rinj të kësaj vepre të madhe, të cilën do ta dorëzojnë nesër, në përvjetorin e 60-të të ditëlindjes së udhëheqësit të partisë dhe të popullit tonë, shokut Enver Hoxha!

*Marrë nga «Zëri i rinitë»*

*12 tetor 1968*

## **NGA FJALA E SHOKUT KADRI HAZBIU, MBAJTUR ME RASTIN E INAUGURIMIT TE RRUGES SE MALESISE SE MADHE**

Sot, këtu, në zëmrën e malësive tona kresh-nike të skajit më verior të atdheut tonë, tha shoku Kadri Azbiu, ne inaugurojmë dy vepra, dy monumente madhështore të ndërtimit e të zhvillimit tonë socialist — rrugën e Malësisë së Madhe dhe elektrifikimin e krejt zonës së Kelmendit e të Dukagjinit.

Është under e gjëzim i madh për mua që, në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, e posaçërisht në emër të udhëheqësit të dashur të partisë e të popullit, komandantit tonë suprem, shokut Enver Hoxha, të përshëndes dhe të uroj, me këtë rast, vullnetarët e vullnetaret e rinisë sonë heroike, ushtarakët e lavdishëm, punëtorët, teknikët e inxhinjerët me mendje e duar të arta, ngado e kudo që janë, malësoret e malësorët sy-patrembur e të palodhur të Kelmendit e të Dukagjinit, klasën punëtore e fshatarësinë punonjëse, organet e partisë e të pushtetit të rrëthit të Shkodrës,

si dhe repartet ushtarake të këtij garnizoni, për këtë sukses, për këtë fitore historike.

E gjithë partia, i gjithë populli ynë, nga të katër anët e atdheut, ju përshëndetin juve, shokë dhe shoqe, në mënyrë të veçantë për këtë sukses, sepse ju i dhuroni të përfunduara veprat tuaja atdheut në një datë historike — në jubileun e 60-vjetorit të themeluesit të partisë sonë të lavdishme, shokut Enver Hoxha.

Atdheu ynë, Shqipëria socialiste, stoliset e zbulurohet përditë me vepra, secila më e bukur e më madhështore se tjetra, pjesë këto të pandara të zhvillimit tonë të vrullshëm. Arqitektët dhe zbatuesit e këtij zhvillimi janë partia dhe vetë populli ynë, sepse nuk ka asnjë rast që në këto vepra të mos jenë mendja, forca organizuese e frysmezuese e partisë dhe dora, vrulli e dinamizmi i papërmabjatur i popullit tonë, i rinisë sonë.

Për këtë arësyesh bashkë me ju, ndërtuesit, me malësorët e malësoret e këtyre zonave, së bashku me gjithë popullin e Shkodrës, gjëzohet sot, me rastin e inaugurimit të këtyre veprave, gjithë Shqipëria, gjithë populli, dhe ju urojnë t'i gjëzoni për jetë të jetës.

Ndërtimi i rrugës së Malësisë së Madhe dhe elektrifikimi i Kelmendit e i Dukagjinit janë pjesë përbërëse e programit madhështor që ka partia për ndërtimin socialist të vendit. Ato shprehin, në mënyrë të veçantë, kujdesin e partisë e të shokut Enver për zhvillimin e mëtejshëm e me shpejtësi të këtyre malësive dhe në përgjithësi të zonave të thella malore. Dhe këtë kujdes të

veçantë malësitë e zonat e thella e meritojnë jo vetëm sepse ato kanë qenë pérherë baza të pakapshme të qëndresës shqiptare dhe besnikë e luftarake të pathyeshme të çështjes së partisë e të atdheut tonë socialist, por edhe sepse partia jonë, që udhëheq me largpamje ndërtimin e socializmit në Shqipëri, e çon zhvillimin tonë të gjithanshëm drejt ngushtimit e pastaj likuidimit të ndryshimeve midis fshatit e qytetit. Dhe ky proces është bërë e do të bëhet jo duke ndalur në vend ritmet e zhvillimit të qytetit, por duke i harmonizuar ato me fshatin e duke siguruar për to një shpejtësi sa më të madhe pérparimi.

Për këtë arësy, shokë e shoqe, populli ynë, me të drejtë, kudo, si në fshat e në qytet, si në mal e në fushë, punon e lufton me vendosmëri pér zbatimin e vijës e të programit të partisë, dhe çdo vepër të re ai e quan vepër të partisë.. .

... Dje, i përcjellë me brohoritje të fuqishme, që delnin nga gjoksi i mijëra bashkëatdhetarëve tanë, cau fushat nëpër trase treni i parë Rrogogzhinë-Fier. Sot ne jemi mbledhur këtu pér të inauguruar mbarimin e dy veprave të tjera: rrugën automobilistike të Malësisë së Madhe dhe elektrifikimin e të gjithë kësaj krahine.

Për ndërtimin e rrugës së Malësisë së Madhe, me gjatësi 65 km, janë shpenzuar gjithsejt 13 milion lekë dhe është kryer një punë mjaft voluminoze: u gërmuan 520 mijë metro kub dhé e shkëmb, u ngritën mijëra metro kub muraturë guri e betoni, u vendosën 100 mijë metro katrore shtresë rruge, kallldrëm e çakëll, u ndërtuan 50 ura dhe u përfunduan plotësisht, me vepra arti e mure mbrojtëse, mbi 30 km. rrugë.

Për kryerjen e këtyre punimeve, në terren tepër të vështirë, mijëra të rinjve vullnetarë, teknikëve, punëtorëve e inxhinierëve u është dashur të kalojnë, gjatë dy vjetve, vështirësi e pengesa të panumërtë, të derdhin djersë dhe të tregojnë gumin e shkathësi, si në beteja të vërteta, për të çarë me gjoks përpara drejt majave të Vermoshit.

Dhe vështirësitë u kaluan. Natyra e ashpër e këtyre maleve u mposht përpara vullnetit të çelniktë të njeriut tonë të ri. Porosia e partisë për t'i sjellë rrugën Malësisë u plotësua me ndër.

Faqebardhë dolët ju edhe në një front tjetër, në frontin e elektrifikimit.

Një vit më parë, duke qenë midis jush, udhëheqësi ynë i dashur, shoku Enver Hoxha, porositi që, bashkë me ndërtimin e rrugës automobilistike, në shenjë kujtimi të aktit heroik të çikës së Dukagjinit, komunistes 15-vjeçare Shkurte Pal Vatës, t'i jepet dritë elektrike, benda viti 1968, gjithë Malësisë së Dukagjinit e të Kelmendit.

Dhe ju, sipas traditës së malësorit, fjalën e partisë nuk e bëtë dysh. Të mobilizuar si një trup i vetëm, me besim e vullnet të çelniktë, duke patur, si kurdoherë, ndihmën dhe përkrahjen e gjithanshmë të partisë e të pushtetit, të rinisë e të ushtrisë, dhe në mënyrë të veçantë të klassës punëtore, kryet brenda zotimit të marrë elekrifikimin e plotë të këtyre viseve.

Ky aksion i madh u krye me punë të madhe: u ngritën e u trasportuan në skaje të largëta materiale e maqineri të shumta, u ndërtuan në kushte të vështira atmosferike e reliivi 4 hidrocentrale

e 2 centrale «Diezel», u shtruan 440 km. linja elektrike të tensionit të lartë e të ulët, u ndërtuan 41 kabina transformatorësh dhe u bënë instalime elektrike në më shumë se 2.200 shtëpi.

Në kryerjen e këtyre punimeve është dashur të kapërcehen vështirësi të panumërtë. Kështu, p.sh., malësorët trima të Toplanës, duke kaluar lumin Drin, në ditët e ftohta të dimrit, transportuan me krahë, nga Cukali në Toplanë, me dhjetëra kuintalë tel elektrik; me dhjetëra kooperativistë transportuan mbi shpinë në rrugë të vështira për 12 orë rresht pajisjet e motorit «Diezel». Në kondita shumë të vështira, në luftë të vazhdueshme me tufanin, dëborën e ashpërsinë e alpeve, punuan për të sjellë në këto anë dritën elektrike edhe malësorët e zonës së Shalës, të Shoshit e të Kelmendit, si dhe pilotët tanë sypatrembur, që transportuan me helikpoterë maqineritë e hidrocentralit të Vuklit, duke kapërcyer me vështirësi, por me sukses, çdo normë fluturimi...

... Në vargun e masave të shumta që kanë marrë e do të vazhdojnë të marrin partia e qeveria për lulëzimin e malësisë, dy veprat që ne po inaugurojmë sot kanë vlerë të gjithanshme e të pallogaritshme, si në kuadrin lokal ashtu edhe atë kombëtar.

Drita elektrike dhe rruga automobilistike do të sjellin begatinë, zhvillimin dhe përparimin më të shpejtë e të gjithanshëm edhe në këto zona të thella e të thepisura të atdheut tonë, dikur të izoluara e të vëtmuara, ku bajraktarët e kanunet, kleri e regjimet antipopulllore mbillnin vetëm përçarje, vuajtje, padituri e mjerime.

Ruga dhe fijet e telit elektrik do t'i lidhin e do t'i bashkojnë edhe më fort truallin dhe zemrën e këtyre malësive kreshnike me zemrën e gjithë atdheut tonë socialist dhe, si artere të tija, ato do të çojnë më fuqishëm në vatrat dhe në zemrat e malësorëve dritën, zërin dhe mësimet e partisë e të shokut Enver.

Ndërtimi i këtyre dy veprave nuk është vetëm një ndërmarrje me karakter thjesht ekonomik, por një aksion i madh politik, një shkollë për kalitjen e gjithanshme revolucionare. Këtu u shfaq edhe një herë me forcë e në mënyrë të shkëlqyer ndjekja e solidaritetit e klasës punëtore, ushtrisë dhe rinisë sonë të mrekullueshme në ndihmë të fshatarësise, për lulëzimin e malësisë.

Është detyrë e lartë, shokë të rinisë, që ta ruani, ta zhvilloni më tej e ta përhapni kudo këtë eksperiencë të vyer që fituat këtu, duke u hedhur me hov akoma më të madh në aksione të reja.

Krahas gjëzimit të ligjshëm për atë qka u arrit, u duhet, shokë e shoqe të malësisë, të shihni gjithmonë përpara, për të krijuar me forcat tuaja vepra akoma më të bukura; ta shfrytëzoni rrugën automobilistike dhe energjinë elektrike sa më gjerë, për t'u rrëmbyer pyjeve, bjeshkëve e nëntokës së këtyre maleve pasuritë e vyera për dobinë tuaj e të mbarë atdheut....

...Inaugurimin e këtyre dy veprave, që do të hyjnë në historinë e zhvillimit të Malësisë së Madhe si dy aksione të rëndësishme, ne po e festojmë me madhështi e gjëzim në një kohë kur gjendja e brendshme në mbarë vendin tonë është e mrekullueshme e shumë e fortë, karakteristika

themelore e së cilës është uniteti i çelniktë partipull, e shprehur kjo në besimin e patundur përtë çarë gjithmonë përpara, për triumfin përfundimtar të revolucionit tonë socialist.

Sukeset që ka arritur populli ynë gjatë viteve të pushtetit popullor janë të mëdha e të pakrahasueshme në të gjitha fushat.

Sot në Shqipërinë tonë socialiste, kudo e nga gjithsecili, punohet e luftohet me një vrull të pararë revolucionar, përtë vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 5-të të partisë dhe mësimet e udhëheqësit tonë të dashur shokut Enver Hoxha.

Mobilizimi i gjithanshëm i masave punonjëse të qytetit e të fshatit për realizimin me sukses e para afatit të planit të katërt pesëvjeçar në të gjitha fushat, dhe sidomos suksesi që po arrin fshatarësia jonë për prodhimin e bukës në vend, lufta për shkallimin e elementeve të burokratizmit dhe revolucionarizmin e jetës së vendit, ashtu siç përcaktoi edhe një herë partia në plenumin e gjashtë të Komitetit të saj Qendror, masat e marrura për emancipimin e plotë të gruas, lufta kundër paragjykimeve fetare e zakoneve prapanike e feudo-borgjeze, masat e fundit për revolucionarizmin e mëtejshëm të shkollës, dhënja e një kuptimi më të drejtë raportit midis interesit personal e atij të përgjithshëm, etj., tregojnë se revolucioni ynë ecën pa ndërprerje përpara...

...Disfatë të pakapërcyeshme, tha ai, pësoi revizionizmi modern. Agresioni dhe invazioni fašist i Çekoslovaçisë i çori, një herë e përgjithmonë, maskën demagogjisë për gjoja unitet midis

vendeve dhe partive revizioniste. Shkopi i dirigjentit u zëvendësua me bajonetën e ushtarit. U vërtetua kështu ajo që ka paralajmëruar me kohë Partia e Punës e Shqipërisë, se në kampin revizionist mbisundon vullneti i carëve të rinj të Ruseisë, presioni, shantazhi dhe diktati i politikës shoviniste të shtetit të madh....

...Në këto ditë gjëzimi që rrjedh nga inaugurimi i këtyre dy veprave të rëndësishme të ndërtimit tonë socialist, ne theksojmë edhe një herë se populli ynë, pa ju trembur askujt, kompakt si kurrë ndonjëherë dhe i edukuar me shpirt të lartë revolucionar, së bashku me forcat e tij të armatatosura, të pajisura e të modernizuara më së miri, nën udhëheqjen e partisë sonë heroike me shokun Enver Hoxha në krye, është i gatshëm t'i japë grushte vdekjeje kujtdo që do të guxojë të prekë sado pak pavarësinë dhe interesat e tij, ashtu sikurse është i gatshëm për mbrojtjen e marksizëmleninizmit e të revolucionit, duke kryer, si kurdoherë, me ndër detyrën e tij internacionliste.

Është detyrë e të gjithëve, shokë e shoqe, të vëmë tërë forcat për realizimin e tejkalimin e planit të shtetit e të rritim prodhimin, si element i domosdoshëm për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit, të thellojmë më tej vijën e masave dhë të ngremë në një shkallë më të lartë inisiativat e reja të masave, që kanë të bëjnë me thellimin e revolucionit ideologjik dhe atij tekniko-shkencor; të vëmë në jetë detyrat dhe porositë e plenumit të gjashtë të Komitetit Qendror të Partisë, si kusht i domosdoshëm për realizimin

me sukses të detyrave të Kongresit të 5-të të partisë për të ecur gjithmonë të sigurt përpara, për ta mbajtur kurdoherë të pastër, të shpalosur e për ta ngritur lart e më lart flamurin e marksizëmleninizmit në vendin tonë socialist.

*Marrë nga «Zëri i rinisë»*

*16 tetor 1968*

---

## PËRMBAJTJA

	Faqe-
Një sihariq i ri .....	3
Bjeshkëve ku do të kalojë rruga. Vath Koreshi .....	8
Mbi kreshta malesh një këngë, një krismë, një rrugë. Loni Papa .....	13
Drejt bjeshkëve të Malësisë së Madhe (Marrë nga gazeta «Bashkimi») .....	18
Gjithmonë kështu na ardhët pranvera! Luçije Doçi..	22
Arter dritëdhënës në alpet tonë. Zija Behri.....	30
Melodi e re në bjeshkët e vjetra. Luçije Doçi.....	38
Punë heroike. Ramazan Hushi .....	44
Në thellësi të bjeshkëvet. Agim Cerga .....	51
Historia e një qytete vullnetarësh. Agim Cerga.....	58
Me vullnetarët dhe malësorët. Gani Kurti.....	63
Fletë të shkëputura. Loni Papa .....	67
Rrugë dhe dritë në malësi. Jonuz Dini.....	74
Kështu lindi një legjendë. Koço Kosta .....	79
Drejt majave të Vermoshit Nexhat Gjuzi.....	87
Mësimet e partisë dhe tuajat, shoku Enver, do të na prijnë kurdoherë në jetë si flamur.....	93
Punë të madhe ka ba partia. Fataq Malo.....	98
Në frontin më të vështirë. Ilia Vasili.....	109
Dëgjoni kumbimin e minave. Fataq Malo.....	120
Shkëmbi u mposht, flamuri u fitua. Refat Resuli....	131
Midis njerëzve të xhadesë. Pertef Isufaj.....	136
U kthyen vullnetarët. Fiqri Alia.....	141
Qesh malësia, qesh malësori. Kolë Sokoli, Kujtim Gjonaj .....	151
Kelmendi në festë. Gani Kurti .....	160
Fjala e shokut Kadri Hazbiu, mbajtur me rastin e inaugurimit të rrugës së Malësisë së Madhe,.....	166